REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

departamenti dap Administratës Publike

RAPORT

MONITORIMI PËR PERIUDHËN

JANAR - QERSHOR 2026

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2025-2030

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve.....3

PJESA I - INFORMACION PËRMBLEDHËS

1.1 Përmbledhje ekzekutive.....5

1.2 Metodologjia e monitorimit.....17

1.3 Konsultimi publik.....22

PJESA II - PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2025-2030 DHE I PLANIT TË VEPRIMIT 2025-2027

2.1 Reforma të implementuara me sukses.....25

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e Integrimit Europian.....37

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit.....42

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit.....43

PJESA III - PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKË, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE MASAT

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës……..44

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit..……164

3.3 Konkluzione dhe rekomandime...……169

PJESA IV: RISQET DHE HAPAT PËR TË ADRESUAR

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit e performancës……172

4.2 Hapat e rradhës.……176

ANEKS 1 - Raporti i Planit të Veprimit të Monitorimit

ANEKS 2 - Pasaporta e Indikatorëve

ANEKS 3 - Matrica e riskut

LISTA E SHKURTIMEVE

ADB	-	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AEE	-	Agjencia e Eficencës së Energjisë
AKEM	-	Agjencia Kombëtare e Ekonomisë Qarkulluese
AKR	-	Agjenda Kombëtare e Reformave
AKSHI	-	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMSHC	-	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	-	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	-	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	-	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	-	Bashkimi Evropian
BNJ	-	Burimet Njerëzore
DAP	-	Departamenti i Administratës Publike
DPIE	-	Departamenti i Politikave për Integrimin Evropian
DPP	-	Dokumenti i Politikave Prioritare
GMIP	-	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
IPA	-	Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit
KDIMDP	-	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KE	-	Komisioni Evropian
KM	-	Këshillit të Ministrave
KPS	-	Komiteti i Planifikimit Strategjik
LDI	-	Ligji për të drejtën e informimit
MAPA	-	Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
MBNJ	-	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MD	-	Ministria e Drejtësisë
MEI	-	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MF	-	Ministria e Financave
MF	-	Ministria e Financave
MTKS	-	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve
MIE	-	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
ML	-	Ministri Linje
MSA	-	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSHMS	-	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

MEPJ	-	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
MM	-	Ministria e Mbrojtjes
MTM	-	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (aktualisht Ministria e Mjedisit)
MSHKN	-	Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator
MSHMP	-	Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
MSHPV	-	Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor
MTM	-	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJVQV	-	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	-	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	-	Organizata të Shoqërive Civile
OZHQ	-	Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm
PBA	-	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKABE	-	Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian
PKIE	-	Programi Kombëtar i Integrimit Evropian
PPAP	-	Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve
PRE	-	Programi i Reformës Ekonomike
QBZ	-	Qendra e Botimeve Zyrtare
QSH	-	Qeveria e Shqipërisë
RAP	-	Reforma e Administratës Publike
RIA	-	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR)
RQP	-	Regjistri Qendror i Personelit
SASPAC	-	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SIMBNJ	-	Sistemi i Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFSH	-	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar
SIPI/IPSIS	-	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
SKZHIE	-	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SNRAP	-	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike
SPI	-	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SQDNE	-	Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
TI	-	Teknologjia e Informacionit
TND	-	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
VNR	-	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (RIA)
VNT	-	Vlerësim i Nevojave për Trajnim

PJESA I – INFORMACION PËRMBLEDHËS

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025-2030 (SNRAP) përbën dokumentin kryesor strategjik të Qeverisë Shqiptare për thellimin dhe konsolidimin e reformës në administratën publike, në funksion të përmbushjes së kriterit politik dhe avancimit të procesit të integrimit evropian.

Vlerësimi pozitiv i Raportit të Vlerësimit të Piketave të Ndërmjetme (IBAR) në maj 2026 shënoi kalimin e Shqipërisë në fazën e përmbushjes së kritereve përmbyllëse të Grupkapitullit "Themeloret". Reforma në Administratën Publike është pjesë e këtij grupkapitulli dhe ka rëndësi horizontale për negociatat: aftësia e administratës për të zbatuar reformat dhe legjislacionin e BE-së ndikon në ecurinë e të gjithë kapitujve. Në këtë kontekst, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025-2030 përbën kuadrin kryesor të politikave për forcimin e kapaciteteve administrative dhe ndjekjen e angazhimeve të reformës gjatë procesit të anëtarësimit.

Strategjia shërben si një kornizë udhëheqëse për zbatimin e reformave deri në vitin 2030 dhe mbështetet nga Plani i Veprimit 2025-2027 dhe Pasaporta e Treguesve, të cilat garantojnë një qasje të matshme dhe të monitorueshme të progresit. Ajo është plotësisht e linjëzuar me dokumentet kryesore strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë agjendën e integrimit evropian, Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030 dhe Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

E bazuar në një analizë të thelluar të arritjeve dhe sfidave të deritanishme, si dhe në rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, SNRAP 2025-2030 përcakton një kuadër të qartë politikash dhe masash për përmirësimin e koordinimit të politikave, forcimin e shërbimit civil, digjitalizimin e shërbimeve publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe promovimin e një administrate të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Ky dokument strategjik dhe Plani i Veprimit në zbatim të tij, parashikojnë politika, objektiva dhe masa që duhet të realizohen në përmbushjen e vizionit strategjik. Afatet e realizimit të tyre dhe kostot përkatëse, janë të detajuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike. SNRAP duke qenë një strategji ndërsektoriale, bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave.

Raporti 6-mujor i monitorimit për periudhën janar-qershor 2026 mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 përbën raportin e dytë monitorues në kuadër të këtij cikli, pas raportit vjetor për vitin 2025. Në procesin e përgatitjes së raportit kanë kontribuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2025-2027, duke ofruar informacion mbi ecurinë e zbatimit gjatë periudhës së raportimit.

Raporti paraqet ecurinë e zbatimit të Strategjisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, duke evidentuar progresin e arritur, masat e ndërmarra dhe sfidat e identifikuara gjatë procesit të zbatimit. Në këtë kuadër, raporti shërben gjithashtu si instrument për vlerësimin e ecurisë së reformës në administratën publike në raport me prioritetet e integrimit evropian, rekomandimet e Komisionit Evropian dhe objektivat përkatëse të Agjendës 2030, si dhe për përcaktimin e fushave që kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje të mëtejshme gjatë periudhës në vijim.

Ky raport paraqet gjithashtu një përmbledhje të progresit të evidentuar për secilin objektiv specifik, si dhe për çdo masë dhe aktivitet të planifikuar për zbatim gjatë periudhës së raportimit. Ecuria e zbatimit vlerësohet në bazë të treguesve përkatës të performancës, duke pasqyruar nivelin e realizimit të tyre mbi baza gjashtëmujore.

Në përfundim, raporti ofron një analizë të progresit të arritur, të sfidave dhe faktorëve që kanë ndikuar në ecurinë e zbatimit, si dhe evidenton rekomandimet përkatëse për adresimin e tyre dhe për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit gjatë periudhës në vijim.

Qëllimet e politikës të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 janë të natyrës afatgjatë dhe synohet të realizohen përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2025-2027. Dokumenti strategjik përcakton gjithsej pesë qëllime politike, të cilat paraqiten si më poshtë:

Qëllimi i Politikës I	-	Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
Qëllimi i Politikës II	-	Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
Qëllimi i Politikës III	-	Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi;
Qëllimi i Politikës IV	-	Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës;
Qëllimi i Politikës V	-	Administrata e gjelbër.

Në zbatim të Qëllimeve të Politikave janë parashikuar gjithsej 17 objektiva specifikë, si më poshtë:

- 3 (tre) Objektivë Specifikë për Qëllimin e Politikës I;
- 4 (katër) Objektivë Specifikë për Qëllimin e Politikës II;
- 2 (dy) Objektivë Specifikë për Qëllimin e Politikës III;
- 4 (katër) Objektivë Specifikë për Qëllimin e Politikës IV;
- 4 (katër) Objektivë Specifikë për Qëllimin e Politikës V.

Në zbatim të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave Specifikë (OS) të përcaktuar në Planin e Veprimit 2025-2027, janë parashikuar gjithsej 80 masa dhe 204 aktivitete, për zbatimin e të cilave janë përcaktuar 22 institucione përgjegjëse dhe kontribuuese. Zbatimi i këtyre masave dhe aktiviteteve kërkon koordinim dhe bashkëpunim ndërinstitucional, me synim mbështetjen e procesit të konsolidimit dhe forcimit të administratës publike.

Raporti i monitorimit për periudhën janar-qershor 2026 pasqyron ecurinë e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027. Analiza e progresit është realizuar në nivel të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave Specifikë, bazuar në statusin e arritjes së treguesve përkatës të performancës, gjithsej 40 tregues, si dhe në ecurinë e zbatimit të reformave kyçe në fushën e administratës publike.

Në këtë kuadër, raporti synon të evidentojë nivelin e progresit të arritur gjatë periudhës së raportimit, fushat ku zbatimi është në përputhje me planifikimin, si dhe çështjet dhe sfidat që kërkojnë vëmendje të mëtejshme për garantimin e realizimit të objektivave të përcaktuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i Objektivave Specifikë, si dhe numri i masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027, sipas secilit Qëllim të Politikës.

QËLLIMI I POLITIKAVE	OBJEKTIVI SPECIFIK (OS)	MASA & AKTIVITETE
Qëllimi i Politikës I	3 (tre) OS	• 19 masa • 56 aktivitete
Qëllimi i Politikës II	4 (katër) OS	• 27 masa • 70 aktivitete
Qëllimi i Politikës III	2 (dy) OS	• 8 masa • 12 aktivitete
Qëllimi i Politikës IV	4 (katër) OS	• 16 masa • 35 aktivitete
Qëllimi i Politikës V	4 (katër) OS	• 10 masa • 31 aktivitete
Totali	**17 (shtatëmbëdhjetë) OS**	• **80 masa** • **204 aktivitete**

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, MAPA, DAP dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij dokumenti kanë vijuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 punën për realizimin e objektivave të përcaktuara në fushën e reformës në administratën publike. Veprimtaria gjatë kësaj periudhe është orientuar drejt konsolidimit të një administrate publike moderne, inovative dhe të motivuar, në funksion të përmbushjes së kërkesave

të procesit të integrimit evropian, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit, si dhe forcimit të besimit të publikut në institucionet shtetërore.

Për periudhën janar-qershor 2026 janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 22 tregues performance[1] të shpërndarë përkatësisht në:

- 9 tregues për Qëllimin e Politikës I;
- 5 tregues për Qëllimin e Politikës II;
- 4 tregues për Qëllimin e Politikës IV;
- 4 tregues për Qëllimin e Politikës V.

Qëllimi i Politikës 3 nuk ka tregues performance të matshëm për këtë periudhë raportimi.

Në vijim paraqitet shkalla e realizimit të objektivave të Strategjisë, bazuar në nivelin e arritjes së treguesve përkatës të performancës:[2]

Qëllimi i Politikës	Objektivi Specifik (OS)	Shkalla e realizimit të OS sipas treguesve të performancës.[3]
Qëllimi i Politikës I	Objektivi Specifik 1.3	80%
	Objektivi Specifik 1.3	61%
	Objektivi Specifik 1.3	98%
Qëllimi i Politikës II	Objektivi Specifik 2.1	50%
	Objektivi Specifik 2.2	96%
	Objektivi Specifik 2.3	94%
	Objektivi Specifik 2.4	Nuk matet.[4]
Qëllimi i Politikës III	Objektivi Specifik 3.1	Nuk matet.
	Objektivi Specifik 3.2	Nuk matet.
Qëllimi i Politikës	Objektivi Specifik 4.1	Nuk matet.

[1] Për 18 (tetëmbëdhjetë) tregues performance nuk është e mundur matja për këtë raport monitorimi, pasi janë jashtë periudhës së raportimit ose frekuenaca e matjes së tyre është me periodicitet vjetor.

[2] Mbështetur në matjen e vlerave të synuara për treguesit e performancës, sipas Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

[3] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

[4] Treguesit e performancës për OS 2.4, OS 3.1, OS 3.2 dhe OS 4.1 nuk janë të matshme për këtë periudhë raportimi.

IV	Objektivi Specifik 4.2	81%
	Objektivi Specifik 4.3	100%
	Objektivi Specifik 4.4	63%
Qëllimi i Politikës V	Objektivi Specifik 5.1	0%
	Objektivi Specifik 5.2	0%
	Objektivi Specifik 5.3	0%
	Objektivi Specifik 5.4	100%

Bazuar në analizën e kryer, progresi i arritur për secilin prej Qëllimeve të Politikës, në funksion të nivelit të arritjes së "treguesve të performancës" gjatë periudhës janar-qershor 2026, paraqitet si më poshtë:[5]

Qëllimi i Politikës (QP)	**Shkalla e realizimit të QP sipas treguesve të performancës.**
Qëllimi i Politikës I - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	80%
Qëllimi i Politikës II - Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	80%
Qëllimi i Politikës III - Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi	E pamatshme për këtë periudhë raportimi.
Qëllimi i Politikës IV - Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës	81%
Qëllimi i Politikës V - Administrata e gjelbër	25%

Për periudhën janar-qershor 2026, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të 57 masave dhe 95 aktiviteteve, të cilat paraqiten në vijim:

- 13 masa dhe 26 aktivitete për Qëllimin e Politikës I;
- 17 masa dhe 29 aktivitete për Qëllimin e Politikës II;
- 7 masa dhe 9 aktivitete për Qëllimin e Politikës III;


[5] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{OS 1 NR} + \text{OS 2 NR}}{\text{2 OS}}$ x 100%.

- 13 masa dhe 22 aktivitete për Qëllimin e Politikës IV;
- 7 masa dhe 9 aktivitete për Qëllimin e Politikës V.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2025-2027 të SNRAP, nga 57 masat dhe 95 aktivitetet e monitoruara, rezulton se:

- 24 masa dhe 47 aktivitete janë zbatuar plotësisht;
- 19 masa dhe 18 aktivitete janë zbatuar pjesërisht;
- 14 masa dhe 30 aktivitete nuk janë zbatuar.

Grafiku i mëposhtëm tregon realizueshmërinë e masave dhe aktiviteteve për periudhën janar-qershor 2026:



Në tabelën e mëposhtme paraqitet shkalla e realizimit të Objektivave Specifikë të Strategjisë, bazuar në nivelin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve përkatëse gjatë periudhës janar-qershor 2026:

Qëllimi i Politikës	Objektivi Specifik (OS)	Përqindja e realizimit të OS sipas masave.[6]	Shkalla e realizimit sipas masave (referuar 4 intervaleve të sistemit të përformacës).
Qëllimi i Politikës I	Objektivi Specifik 1.1	75%	Mirë
	Objektivi Specifik 1.2	80%	Mirë
	Objektivi Specifik 1.3	86%	Shumë mirë
Qëllimi i Politikës II	Objektivi Specifik 2.1	18%	Dobët
	Objektivi Specifik 2.2	40%	Mjaftueshëm
	Objektivi Specifik 2.3	58%	Mirë
	Objektivi Specifik 2.4	71%	Mirë
Qëllimi i Politikës III	Objektivi Specifik 3.1	87%	Shumë mirë
	Objektivi Specifik 3.2	53%	Mirë
Qëllimi i Politikës IV	Objektivi Specifik 4.1	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 4.2	50%	Mjaftueshëm
	Objektivi Specifik 4.3	67%	Mirë
	Objektivi Specifik 4.4	70%	Mirë
Qëllimi i Politikës V	Objektivi Specifik 5.1	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 5.2	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 5.3	50%	Mjaftueshëm
	Objektivi Specifik 5.4	50%	Mjaftueshëm

[6] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%.

Bazuar në analizën e kryer, progresi i arritur për secilin prej Qëllimeve të Politikës, sipas nivelit të realizimit të masave gjatë periudhës janar-qershor 2026, paraqitet si më poshtë:[7]

Qëllimi i Politikës (QP)	Përqindja e realizimit të QP sipas masave	Shkalla e realizimit të QP sipas masave.
Qëllimi i Politikës I - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	80%	Mirë
Qëllimi i Politikës II - Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	47%	Mjaftueshëm
Qëllimi i Politikës III - Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi	70%	Mirë
Qëllimi i Politikës IV - Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës	47%	Mjaftueshëm
Qëllimi i Politikës V - Administrata e gjelbër	25%	Dobët

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 dhe Planit të Veprimit 2025-2027, është shoqëruar me një sërë zhvillimesh dhe arritjesh në fushat prioritare të reformës. Ndër reformat dhe rezultatet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe, veçojmë si më poshtë:

Qëllimi i Politikës I – Arritjet kryesore për periudhën janar-qershor 2026

Gjatë vitit 2026, zbatimi i Qëllimit të Politikës I "Zhvillimi dhe koordinimi i politikave" shënoi nivel të lartë realizimi të masave dhe aktiviteteve të planifikuara, duke forcuar më tej programimin ligjor dhe cilësinë e politikëbërjes. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, veçojmë:

- ✓ Mbështetje e institucioneve nga SASPAC për hartimin e dokumenteve strategjike sipas metodologjisë IPSIS.
- ✓ Miratimi i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP) 2027-2029, me VKM nr. 145, datë 11.03.2026 "*Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2027–2029*".

[7] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{OS 1 NR + OS 2 NR}}{\text{2 OS}}$ x 100%.

- ✓ Miratimi i udhërrëfyesit për "Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030", me VKM nr. 381, datë 28.05.2026 "*Për miratimin e Udhërrëfyesit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2026-2030*".

- ✓ Funksionimi i GMIP-ve dhe ekipeve të tyre tematike në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 01.08.2023 "*Për miratimin e masave për zbatimin e qasjes sektoriale/ndërsektoriale dhe krijimin dhe riorganizimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial*".

- ✓ Miratimi i Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative dhe Institucionale për vitin 2026, i cili mbulon 33 kapitujt e negociatave dhe 3 kriteret.

- ✓ Miratimi i "*Raportit kombëtar i veprimtarisë së GNPIE dhe vlerësimit të indeksit të kapaciteteve të integrimit evropian*" për periudhën janar-prill 2026, më datë 28 maj 2026.

- ✓ Forcimi i koordinimit ndërinstitucional gjatë përgatitjes së PPAP-së për vitin 2026, për identifikimin në kohë të projektakteve që i nënshtrohen RIA dhe përgatitjen e raporteve përkatëse.

- ✓ Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese për nëpunësit publikë, për forcimin e kapaciteteve në hartimin e politikave të bazuara në evidencë dhe përmirësimin e cilësisë së raporteve RIA.

- ✓ Integrimi i procesit të konsultimit publik me procesin e RIA, për rritjen e transparencës, cilësisë së analizave dhe përfshirjes së aktorëve të interesit.

- ✓ Përmirësimi i transparencës përmes publikimit të raporteve RIA në REKNJP dhe konsultimit publik. Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë miratuar dhe konsultuar 41 akte të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014, ku 39 prej tyre janë konsultuar nëpërmjet RENJKP.

- ✓ Publikimi i 98% të draft-raporteve RIA në RENJKP përpara finalizimit të tyre, gjatë periudhës janar-23 korrik 2026.

- ✓ Rritja e transparencës së akteve normative përmes botimit të 137 numrave të Fletoreve Zyrtare, me gjithsej 1,896 akte, në format të printuar dhe elektronik.

Qëllimi i Politikës II - Arritjet kryesore për periudhën janar–qershor 2026

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Qëllimit të Politikës II "Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore" shënoi progres në realizimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, duke kontribuar në modernizimin dhe profesionalizimin e shërbimit civil, me fokus

në forcimin e meritokracisë, integritetit dhe zhvillimit profesional të nëpunësve publikë. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, përmendim këto arritje kryesore:

- ✓ Vijimi i procesit të rishikimit të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, përmes konsultimeve me Komisionin Evropian dhe ekspertët e OECD/SIGMA.
- ✓ Shpallja e 449 pozicioneve dhe emërimi në 233 pozicione vakante gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i bankës elektronike të pyetjeve për përmirësimin e cilësisë dhe standardizimit të proceseve të rekrutimit.
- ✓ Organizimi i edicionit të tretë të Javës së Administratës Publike 2026, më 29 qershor - 3 korrik, me aktivitete të fokusuara në zhvillimin e talenteve, lidershipin, integritetin, përmirësimin e shërbimeve publike dhe përgatitjen për anëtarësimin në BE.
- ✓ Zhvillimi i Konferencës së Nivelit të Lartë për Reformën në Administratën Publike, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së, projektin "EU4GoodGovernance" dhe Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, me fokus në menaxhimin e performancës, sistemet e vlerësimit, mekanizmat e motivimit dhe shpërblimit, si dhe delegimin e përgjegjësive.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve institucionale në fushën e etikës dhe integritetit përmes trajnimit dhe certifikimit të 289 nëpunësve civilë, me fokus në zbatimin e standardeve të etikës, parandalimin e konfliktit të interesit dhe forcimin e mekanizmave të raportimit dhe trajtimit të shkeljeve të etikës.
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për palët e treta, përmes hartimit të kurrikulës "*Hartimi i Planit të Biznesit*" dhe zhvillimit të trajnimeve nga ASPA, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë certifikuar 360 pjesëmarrës.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar të ASPA-s, përmes shkëmbimit të përvojave, transferimit të praktikave të mira dhe forcimit të kapaciteteve të administratës publike, në bashkëpunim me partnerë si EIPA, ReSPA, Këshilli i Evropës, EUSFAM dhe rrjeti NISPAcee.
- ✓ Rishikimi dhe përshtatja e kurrikulave sipas programit të ri të miratuar, përfshirë miratimin nga Këshilli Drejtues të programit të rishikuar "*Prezantimi me Administratën Publike*".
- ✓ Përmirësimi i funksionaliteteve të Regjistrit Qendror të Personelit, përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme për rritjen e performancës, sigurisë dhe eficiencës së sistemit.
- ✓ Zhvillimi dhe automatizimi i funksionaliteteve të HRMIS, duke përmirësuar raportimin, sigurinë dhe menaxhimin e të dhënave, si dhe duke mundësuar gjenerimin e automatizuar të listëpagesave për muajt prill-qershor, në bashkëpunim me ministritë. Përsa i përket implementimit në institucionet e qeverisjes qendrore, në kuadër të procesit të integrimit

HRMIS-SIFQ, testimet për institucionet e planifikuara, konkretisht 13 institucione (12 ministri dhe Kryeministria), kanë përfunduar me sukses për 11 prej tyre.

- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave në Regjistrin Qendror të Personelit. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, janë trajnuar 62 pjesëmarrës.

Qëllimi i Politikës III – Arritjet kryesore për periudhën janar–qershor 2026

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Qëllimit të Politikës III "Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi" shënoi progres në realizimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, me fokus në digjitalizimin e shërbimeve publike, modernizimin e infrastrukturës teknologjike, rritjen e ndërveprimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e përvojës së përdoruesit. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, përmendim këto arritje kryesore:

- ✓ Lançimi i platformës së përditësuar e-Albania 2.0, më 18 maj 2026, me infrastrukturë të modernizuar, menaxhim të autorizimeve për bizneset dhe optimizim të procesit të autentikimit.

- ✓ Përmirësimi i aksesueshmërisë së e-Albania 2.0, përmes integrimit të standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë dhe funksionaliteteve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara dhe përdoruesit me nevoja të veçanta.

- ✓ Rritja e transparencës, gjurmueshmërisë dhe standardizimit të proceseve administrative, përmes përdorimit të sistemeve të integruara digjitale dhe përmirësimit të monitorimit të shërbimeve.

- ✓ Vijimi i rikonceptimit të shërbimeve sipas modelit "life events" dhe zhvillimi i mekanizmit të feedback-ut për vlerësimin në kohë reale të shërbimeve, duke synuar ofrimin e shërbimeve publike më të integruara dhe të orientuara drejt nevojave të qytetarëve dhe bizneseve.

- ✓ Përmirësimi i aksesueshmërisë së shërbimeve elektronike, përfshirë grupet vulnerabël, përmes integrimit të funksionaliteteve si: lexuesi i ekranit, ndryshimi i kontrastit dhe personalizimi i ndërfaqes.

Qëllimi i Politikës IV – Arritjet kryesore për periudhën janar–qershor 2026

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Qëllimit të Politikës IV "Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës" shënoi nivel të mirë realizimi të masave dhe aktiviteteve të planifikuara, me progres në forcimin e strukturave institucionale, rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së administratës publike. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, përmendim këto arritje kryesore:

- ✓ Miratimi nga Kuvendi, më 2 korrik 2026, i ndryshimeve në ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", me synim forcimin e organizimit, funksionimit dhe llogaridhënies së administratës, si dhe përmirësimin e arkitekturës institucionale, qartësimin e përgjegjësive dhe rritjen e eficiencës së sistemit administrativ.

- ✓ Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe monitorimit institucional, përmes monitorimit në kohë reale të 1,252,612 aplikimeve në sistemin SQDNE gjatë periudhës janar–qershor 2026, si dhe zhvillimit të takimeve periodike me institucionet shërbimofruese për ndjekjen e performancës dhe trajtimin e aplikimeve.

- ✓ Forcimi i transparencës proaktive dhe mbikëqyrjes së të drejtës së informimit, përmes miratimit të "*Planit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes*" për vitin 2026. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 20 hetimeve administrative, nga të cilat 12 autoritete publike përmbushën detyrimin për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës.

- ✓ Vijimi i zhvillimit dhe përditësimit të platformës "Transparent Albania", përmes përditësimit mujor dhe vizualizimit të të dhënave mbi të ardhurat, shpenzimet buxhetore dhe projektet e financuara, duke rritur transparencën dhe aksesin në informacionin financiar publik.

- ✓ Avancimi i procesit të bashkëkrijimit të Planit Kombëtar të Veprimit të OGP 2026-2030, përmes konsultimeve institucionale, dialogut me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve, në përputhje me parimet e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies.

- ✓ Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, përmes përdorimit të instrumenteve parlamentare, përfshirë interpelancat, mocionet me debat, pyetjet me shkrim dhe seancat dëgjimore me përfaqësues të ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura.

- ✓ Rikonfigurimi dhe zgjerimi i softuerit të Platformës Ndërinstitucionale, përmes shtimit të rubrikave dhe informacionit të ri, zgjerimit të institucioneve kontribuese dhe përmirësimit të dizajnit, aksesueshmërisë për publikun dhe monitorimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.

- ✓ Progresi në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, me mbylljen provizore të 3 kapitujve: Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi", Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura" dhe Kapitulli 30 "Marrëdhëniet me Jashtë".

- ✓ Forcimi i transparencës dhe pavarësisë institucionale të Avokatit të Popullit, përmes ndryshimeve ligjore që mundësuan publikimin e menjëhershëm të Raportit Vjetor 2025 dhe rritjen e aksesit të publikut dhe medias në informacion mbi të drejtat e njeriut.

Qëllimi i Politikës V – Arritjet kryesore për periudhën janar-qershor 2026

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Qëllimit të Politikës V "Administrata e Gjelbër" është fokusuar kryesisht në vijimin e proceseve përgatitore dhe planifikuese, duke hedhur hapat fillestarë për zbatimin e masave për përdorimin efektiv të burimeve natyrore. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, përmendim këto arritje kryesore:

- ✓ Rritja e numrit të procedurave të prokurimit publik ku aplikohen kriteret e gjelbra, duke kontribuar në integrimin e kritereve mjedisore në prokurimet publike. Në rritjen e numrit të procedurave ka ndikuar edhe nxjerrja e akteve nënligjore në formën e udhërrëfyesve, ku përmendim ndër të tjera Udhërrëfyesin "*Mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në procedurat e prokurimit publik*", duke mbështetur rritjen e përdorimit të kritereve të gjelbra në procedurat e prokurimit publik.

- ✓ Zhvillimi i aktiviteteve të shumta ndërgjegjësuese dhe informuese në institucione arsimore, universitete, biznese dhe sipërmarrje të mëdha dhe të vogla. Këto aktivitete kanë synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit, ripërdorimin e materialeve dhe mbështetjen e praktikave të ekonomisë qarkulluese në sektorin publik dhe privat. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), institucion në varësi të Ministrisë së Mjedisit, gjatë periudhës janar-qershor 2026, ka realizuar gjithsej 396 aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese.

Gjatë kësaj periudhe, progresi i evidentuar dëshmon për konsolidimin e mëtejshëm të mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë, si dhe për avancimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027. Në të njëjtën kohë, procesi i zbatimit ka evidentuar një sërë sfidash që kërkojnë vëmendje dhe adresim të vazhdueshëm, me qëllim garantimin e ritmit të planifikuar të reformës dhe përmbushjen në kohë të objektivave të përcaktuara.

Ndër sfidat kryesore të evidentuara përfshihen nevoja për forcimin e koordinimit ndërinstitucional, përmirësimin e planifikimit dhe ndjekjes së masave dhe aktiviteteve, përshpejtimin e zbatimit të masave me ecuri të vonuar, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 31.07.2025 "*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve*", procesi i monitorimit të zbatimit të SNRAP 2025-2030,

udhëhiqet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, me ndjekjen dhe përgatitjen teknike të Departamentit të Administratës Publike.

Ky raport monitorimi mbulon periudhën janar-qershor 2026 dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratës Publike 2025-2030.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për monitorimin e zbatimit në nivel teknik të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025-2030, ka kryer koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me "Pikat e Kontaktit" të përcaktuara nga secili institucion përgjegjës për zbatimin e SNRAP 2025-2030, duke vijuar më pas me hartimin e raportit të monitorimit. Përpunimi statistikor i të dhënave është kryer nga DAP, nëpërmjet analizimit të përgjigjeve sipas raporteve të marra nga institucionet zbatuese. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ dhe statistikor, ku është raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo mase dhe aktiviteti, buxhetin e caktuar, problematikat e hasura, treguesit e performancës dhe vlerësimin e progresit të Strategjisë në përgjithësi.

Në përputhje me procedurat për raportimin dhe monitorimin e Strategjisë, në zbatim të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020 "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)*", procesi i përgatitjes së Raportit të Monitorimit ka ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Shqyrtimi i paketës metodologjike dhe formateve për raportim në përputhje me standardet e sistemit IPSIS.
- Dërgimi tek të gjithë institucionet përgjegjës për zbatimin e SNRAP 2025-2030 i paketës metodologjike dhe formateve për raportim në përputhje me standardet e sistemit IPSIS.
- Shqyrtimi i raportimeve të marra nga të gjithë institucionet raportuese nga Njësia përgjegjëse për koordinimin e raportit. Në rastet kur nga raportet kanë lindur çështje për sqarim/diskutim, janë kërkuar informacione/sqarime shtesë nga institucionet raportuese si dhe takime të dedikuara.
- Pas marrjes së kontributeve, hartimi dhe kryerja e të gjitha analizave të nevojshme për hartimin e raportit për zbatimin e Strategjisë. Paketa e plotë përfshin materialet e mëposhtme:
  - Raportin e progresit për zbatimin e Strategjisë në përputhje me standardet e sistemit IPSIS.
  - Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën raportuese në përputhje me standardet e sistemit.
  - Pasaportën e Treguesve në përputhje me standardet e sistemit për periudhën raportuese.

- Dërgimi i draft-paketës së plotë të monitorimit për konsultim nga intitucionet përgjegjëse për zbatimin e SNRAP 2025-2030.
- Dërgimi i draft-paketës së plotë të monitorimit për vlerësim pranë SASPAC.
- Procesi i konsultimit të raportit dhe njoftimet respektive në përputhje me procedurat për organizimin e mbledhjes së mekanizmit në zbatim Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 01.08.2023 "*Për miratimin e masave për zbatimin e qasjes sektoriale/ndërsektoriale dhe krijimin dhe riorganizimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial*".
- Shqyrtim i raportit në mbledhjen e Ekipit Tematik "*Mirëqeverisja*", në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave "*Demokracia, Shteti i së Drejtës dhe Mirëqeverisja*", nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.
- Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit.
- Publikimi i raportit të monitorimit të miratuar.

Për sa më sipër, secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifikë dhe masash të realizuar (mbi bazë aktivitetesh të kryera), buxhetin e parashikuar për vitin raportues, buxhetin e alokuar/përdorur për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi.

Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "*Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)*" dhe manualeve të IPSIS, si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 01.08.2023 "*Për miratimin e masave për zbatimin e qasjes sektoriale/ndërsektoriale dhe krijimin dhe riorganizimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial*".

Sa më sipër, në kuadër të hartimit të raportit të monitorimit për periudhën janar-qershor 2026 janë analizuar të dhënat si më poshtë:

- Zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre kundrejt kryerjes së aktiviteteve që lidhen me to;
- Arritja e vlerës së synuar për vitin 2026 e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar;
- Niveli i realizimit/zbatimit të qëllimeve të politikës dhe objektivave specifikë nëpërmjet llogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës.

Zbatueshmëria e masave dhe aktivitete të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- ***I zbatuar*:** Institucionet kanë raportuar statusin "*I zbatuar*" për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur plotësisht.

- ***Pjesërisht i zbatuar/Në proces*:** Institucionet kanë raportuar statusin "*Pjesërisht i zbatuar*" për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- ***I pazbatuar*:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese, si dhe ato masa/aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

Gjithashtu janë klasifikuar me *"Jashtë periudhës së raportimit"* masat, aktivitetet dhe treguesit e performancës të cilët nuk janë objekt monitorimi ose që është i pamundur raportimi i progresit për periudhën janar-qershor 2026.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifikë sipas shkallës së realizimit të masave është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR} = \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{Numri i masave për OS}} \text{ x } 100\%$$

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifikë sipas arritjes së vlerës sw synuar të treguesit të perfomancës është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR} = \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{Numri i TP për OS}} \text{ x } 100\%$$

Në këto formula "NR" është niveli i realizimit, TP - treguesi i performancës, dhe OS është objektivi specifik.

Përllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë.[8]

Kategoria	**Niveli i Tolerancës**	**Pikët (110)**
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

[8] Vlerësim i bërë në përputhje me Guidën Metodologjike "Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për Agjendën e Mirëqeverisjes".

Në këtë raport monitorimi është përfshirë vlerësimi dhe identifikimi i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Refomës në Administratën Publike 2025-2030.

Vlerësimi i riskut është bërë në përputhje me "matricën e riskut" sipas tabelës së mëposhtme:[9]

Mundësia				
	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8
	E ulët	1	4	7
		E ulët	E mesme	E lartë
		Ndikimi		

[9] Përmbledhje e vlerësimit të riskut:
1 Mundësi e ulët/ Ndikim i ulët;
2 Mundësi e ulët/ Ndikim i mesëm;
3 Mundësi e ulët/ Ndikim i lartë;
4 Mundësi e mesme/Ndikim i ulët;
5 Mundësi e mesme/ Ndikim i mesëm;
6 Mundësi e mesme/ Ndikim i lartë;
7 Mundësi e lartë/ Ndikim i ulët;
8 Mundësi e lartë/ Ndikim i mesëm;
9 Mundësi e lartë/ Ndikim i lartë.

1.3 Konsultimi publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft-raportit të monitorimit për periudhën janar-qershor 2026, Departamenti i Administratës Publike e dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese/zbatuese të SNRAP 2025-2030 nëpërmjet pikave të kontaktit, si dhe organizatave të shoqërisë civile.

Gjithashtu, drafti i paketës së plotë të raportit të monitorimit të SNRAP për periudhën janar-qershor 2026 është dërguar për vlerësim paraprak edhe pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në rolin e "vlerësuesit" të raportit të monitorimit dhe si njësia përgjegjëse për koordinimin qendror të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave.

Në përfundim të procesit konsultues, Departamenti i Administratës Publike ka bërë reflektimin e komenteve/sugjerimeve mbi draft-raportin e monitorimit dhe vijoi me prezantimin e gjetjeve të raportit në mbledhjen e Ekipit Tematik "*Mirëqeverisja*", në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave "*Demokracia, Shteti i së Drejtës dhe Mirëqeverisja*", më datë 24 shtator 2026, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të SNRAP 2025-2030, përfaqësues nga shoqëria civile, ekspertë të pavarur dhe akademikë, pjesë e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Reformën në Administratën Publike.

Përpos diskutimeve në mbledhje, përfaqësuesve iu la kohë shtesë për përcjelljen e komenteve me shkrim. Paketa finale e "Raportit të Monitorimit të SNRAP 2025-2030 për periudhën janar-qershor 2026" u paraqit zyrtarisht për miratim pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Në përfundim të këtij procesi, raporti i miratuar i monitorimit për periudhën janar-qershor 2026 është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Departamenti të Administratës Publike: www.dap.gov.al.

PJESA II – PROGRESI I SNRAP 2025-2030 DHE I PLANIT TË VEPRIMIT 2025-2027

Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 është konsolidimi i një administrate publike profesionale, efikase, inovative dhe të motivuar, e cila vepron në përputhje me standardet evropiane dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe disponon kapacitetet dhe instrumentet e nevojshme për përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Misioni i Strategjisë është avancimi i Reformës në Administratën Publike drejt përvetësimit dhe zbatimit gradual të standardeve evropiane në funksionimin e institucioneve publike. Përmbushja e këtij misioni mbështetet në zbatimin e një tërësie masash dhe aktivitetesh, të strukturuara në kuadër të 5 (pesë) Qëllimeve të Politikës dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) Objektivave Specifikë, përkatësisht si më poshtë:

"Zhvillimi dhe koordinimi i politikave" përbën shtyllën e I-rë të SNRAP 2025-2030 (Qëllimi i Politikës I), i cili synohet të arrihet përmes objektivave specifikë të mëposhtëm:

- Objektivi Specifik 1.1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave.

- Objektivi Specifik 1.2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit.

- Objektivi Specifik 1.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

"Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore" përbën shtyllën e II-të të SNRAP 2025-2030 (Qëllimi i Politikës II), i cili synohet të arrihet përmes objektivave specifikë të mëposhtëm:

- Objektivi Specifik 2.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.

- Objektivi Specifik 2.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.

- Objektivi Specifik 2.3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integrimit evropian të Shqipërisë.

- Objektivi Specifik 2.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ.

"Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi" përbën shtyllën e III-të të SNRAP 2025-2030 (Qëllimi i Politikës III), i cili synohet të arrihet përmes objektivave specifikë të mëposhtëm:

- Objektivi Specifik 3.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe duke efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.

- Objektivi Specifik 3.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale.

"Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës" përbën shtyllën e IV-ërt të SNRAP 2025-2030 (Qëllimi i Politikës IV), i cili synohet të arrihet përmes objektivave specifikë të mëposhtëm:

- Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase.

- Objektivi Specifik 4.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.

- Objektivi Specifik 4.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.

- Objektivi Specifik 4.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike në mënyrë proaktive nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë.

"Administrata e gjelbër" përbën shtyllën e V-të të SNRAP 2025-2030 (Qëllimi i Politikës V), i cili synohet të arrihet përmes objektivave specifikë të mëposhtëm:

- Objektivi Specifik 5.1: Rritja e angazhimit të administratës publike mbi dimensionin e gjelbër të veprimtarisë institucionale.

- Objektivi Specifik 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për implementimin e nismave të gjelbra në administratën publike.

- Objektivi Specifik 5.3: Transformimi i kapitalit njerëzor të sektorit publik për tranzicionin ekologjik.

- Objektivi Specifik 5.4: Përshpejtimi i prokurimit të gjelbër publik dhe zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2025-2027, në procesin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara janë përfshirë gjithsej 22 institucione, si më poshtë vijon:

- **Institucione të qeverisjes qendrore dhe varësitë e tyre**, ku përmendim: Ministritë e Linjës; Departamenti i Administratës Publike; Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; Agjencia e Prokurimit Publik; Agjencia për Efiçencën e Energjisë; Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; Qendra e Botimeve Zyrtare.

- **Institucione të pavarura**, ku përfshihen: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; Avokati i Popullit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.1 Reforma të implementuara me sukses

Qëllimet e Politikës dhe Objektivat Specifikë të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 realizohen nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2025-2027, për të cilat janë ngarkuar institucione përgjegjëse dhe kontribuese.

Zbatimi i objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 realizohet nëpërmjet Planit të Veprimit 2025-2027, në të cilin janë parashikuar gjithsej 80 masa dhe 204 aktivitete, të shpërndara sipas Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave Specifikë, si më poshtë:

- 19 masa dhe 56 aktivitete për Qëllimin e Politikës I;
- 27 masa dhe 70 aktivitete për Qëllimin e Politikës II;
- 8 masa dhe 12 aktivitete për Qëllimin e Politikës III;
- 16 masa dhe 35 aktivitete për Qëllimin e Politikës IV;
- 10 masa dhe 31 aktivitete për Qëllimin e Politikës V.

Gjatë periudhës raportuese 1 janar - 30 qershor 2026, janë monitoruar në total **57 masa** e **95 aktivitete**, përkatësisht si vijon:

- 13 masa dhe 26 aktivitete për Qëllimin e Politikës I;
- 17 masa dhe 29 aktivitete për Qëllimin e Politikës II;

- 7 masa dhe 9 aktivitete për Qëllimin e Politikës III;
- 13 masa dhe 22 aktivitete për Qëllimin e Politikës IV;
- 7 masa dhe 9 aktivitete për Qëllimin e Politikës V.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shkalla e zbatimit të masave dhe aktiviteteve për secilin Qëllim të Politikës të SNRAP 2025-2030, për periudhën janar - qershor 2026.

Qëllimet e Politikës	**Masat dhe Aktivitetet**	**Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve të SNRAP për periudhën janar-qershor 2026**			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M1 të 2026	**Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[10]**	**Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[11]**	**Masa dhe aktivitete të pazbatuara[12]**
Qëllimi i Politikës I	Masa	13	8	5	0
	Aktivitete	26	17	4	5
Qëllimi i Politikës II	Masa	17	6	6	5
	Aktivitete	29	12	6	11
Qëllimi i Politikës III	Masa	7	4	2	1
	Aktivitete	9	6	2	1
Qëllimi i Politikës IV	Masa	13	5	5	3
	Aktivitete	22	10	6	6
Qëllimi i Politikës V	Masa	7	1	1	5
	Aktivitete	9	2	0	7
Total	**Masa**	**57**	**24**	**19**	**14**
	Aktivitete	**95**	**47**	**18**	**30**

[10] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[11] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[12] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.

Referuar tabelës së mësipërme, nga 57 masat dhe 95 aktivitetet e parashikuara për zbatim gjatë periudhës janar-qershor 2026, statusi i zbatimit të tyre, për të 5 (pesë) "Qëllimet e Politikës", paraqitet si më poshtë:


- 24 masa e 47 aktivitete të zbatuara plotësisht;
- 19 masa e 18 aktivitete pjesërisht të zbatuara ose janë ende në proces zbatimi;
- 14 masa e 30 aktivitete të pazbatuara.


Përsa më sipër, nga 24 masa e 47 aktivitete të realizuara plotësisht për periudhën janar-qershor 2026, konkretisht 8 masa e 17 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës I, 6 masa e 12 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës II, si dhe 4 masa dhe 6 aktivite përkasin Qëllimit të Politikës III, 5 masa dhe 10 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës IV, 1 masa dhe 2 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës V.

Nga 19 masa e 18 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi për periudhën janar-qershor 2026, konkretisht 5 masa dhe 4 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës I, 6 masë dhe 6 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës II, 2 masa dhe 2 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës III, 5 masa dhe 6 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës IV, 1 masë dhe 0 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës V.

Nga 14 masa e 30 aktivitete të pazbatuara për periudhën janar-qershor 2026, konkretisht 0 masa dhe 5 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës I, 5 masa e 11 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës II, 1 masë dhe 1 aktivitet i përkasin Qëllimit të Politikës III, 3 masa e 6 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës IV, 5 masa dhe 7 aktivitete i përkasin Qëllimit të Politikës V.

Nga analiza e mësipërme rezulton se, për periudhën janar-qershor 2026, rreth 42% e masave janë zbatuar plotësisht, 33% janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 25% nuk janë zbatuar. Për sa i përket aktiviteteve, rreth 49.5% janë zbatuar plotësisht, 19% janë zbatuar pjesërisht, ndërsa rreth 31.5% nuk janë zbatuar, sikurse pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm.





Në tabelat e mëposhtme paraqitet shkalla e realizimit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave Specifikë të SNRAP 2025-2030, bazuar në nivelin e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027, për periudhën janar-qershor 2026.

Përllogaritja e shkallës së realizimit të secilit Objektiv Specifik, është kryer në bazë të nivelit të zbatimit të masave përkatëse, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR} = \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{Numri i masave për OS}} \text{ x } 100\%$$

Sa më sipër me (NR) është shënuar niveli i realizmit të Objektivit Specifik.

Qëllimi i Politikës I	Përqindja e realizimit të OS sipas masave[13]	Shkalla e realizimit sipas masave
Objektivi Specifik 1.1	75%	Mirë
Objektivi Specifik 1.2	80%	Mirë
Objektivi Specifik 1.3	86%	Shumë Mirë
Realizueshmëria e Qëllimit të Politikës I	**80%**	**Mirë**

[13] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%

Qëllimi i Politikës II	Përqindja e realizimit të OS sipas masave	Shkalla e realizimit sipas masave
Objektivi Specifik 2.1	18%	Dobët
Objektivi Specifik 2.2	40%	Mjaftueshëm
Objektivi Specifik 2.3	58%	Mirë
Objektivi Specifik 2.4	71%	Mirë
Realizueshmëria e Qëllimit të Politikës II	**47%**	**Mjaftueshëm**

Qëllimi i politikës III	Përqindja e realizimit të OS sipas masave	Shkalla e realizimit sipas masave
Objektivi Specifik 3.1	87%	Shumë Mirë
Objektivi Specifik 3.2	53%	Mirë
Realizueshmëria e Qëllimit të Politikës III	**70%**	**Mirë**

Qëllimi i Politikës IV	Përqindja e realizimit të OS sipas masave	Shkalla e realizimit sipas masave
Objektivi Specifik 4.1	0%	Dobët
Objektivi Specifik 4.2	50%	Mjaftueshëm
Objektivi Specifik 4.3	67%	Mirë
Objektivi Specifik 4.4	70%	Mirë
Realizueshmëria e Qëllimit të Politikës IV	**47%**	**Mjaftueshëm**

Qëllimi i Politikës V	Përqindja e realizimit të OS sipas masave	Shkalla e realizimit sipas masave
Objektivi Specifik 5.1	0%	Dobët
Objektivi Specifik 5.2	0%	Dobët
Objektivi Specifik 5.3	50%	Mjaftueshëm
Objektivi Specifik 5.4	50%	Mjaftueshëm
Realizueshmëria e Qëllimit të Politikës V	**25%**	**Dobët**

Bazuar në nivelin e realizimit të 17 Objektivave Specifikë, vërehet një ecuri pozitive në zbatimin e disa prej tyre gjatë periudhës janar-qershor 2026, veçanërisht në objektivat e renditur më poshtë:

- Objektivat Specifikë 1.1, 1.2, 1.3 në Qëllimin e Politikës I;
- Objektivat Specifikë 2.3 dhe 2.4 në Qëllimin e Politikës II;
- Objektivat Specifikë 3.1 dhe 3.2 në Qëllimin e Politikës III;
- Objektivat Specifikë 4.2, 4.3 dhe 4.4 në Qëllimin e Politikës IV;
- Objektivat Specifikë 5.3 dhe OS 5.4 në Qëllimin e Politikës IV.

Ndërkohë, bazuar në të dhënat e monitorimit, konstatohet një shkallë më e ulët realizimi për disa prej Objektivëve Specifikë, të cilët paraqiten si më poshtë:

- Objektivat Specifikë 2.1 dhe 2.2 në Qëllimin e Politikës II;
- Objektivi Specifik 4.1 në Qëllimin e Politikës V;
- Objektivat Specifikë 5.1 dhe 5.2 në Qëllimin e Politikës V.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave, pra duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të qëllimeve të politikës, e cila është pjestuar me numrin total të QP, kemi përllogaritur realizimin "Qëllimit Strategjik" ndërinstitucional për Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për periudhën janar-qershor 2026. Realizmi i "*Qëllimit strategjik*" referuar zbatueshmërisë së masave, për këtë periudhën monitorimi është 54 %, sikurse pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Qëllimi i Politikës I	80%	Mirë
Qëllimi i Politikës II	47%	Mjaftueshëm
Qëllimi i Politikës III	70%	Mirë

Qëllimi i Politikës IV	47%	Mjaftueshëm
Qëllimi i Politikës V	25%	Dobët
Qëllimi Strategjik sipas masave	**54%**	**Mirë**

Për sa më sipër, Qëllimi i Politikës I ka arritur progresin më të lartë përkatësisht një realizueshmëri prej 80%, ndërsa Qëllimi i Politikës V ka realizueshmërinë më të ulët me 25%.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025–2030 dhe Planit të Veprimit 2025-2027 është shoqëruar me një sërë zhvillimesh dhe arritjesh në fushat prioritare të reformës. Ndër reformat dhe rezultatet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe, veçojmë si më poshtë:

- Në mars të këtij viti u miratua Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) me VKM nr. 145, datë 11.03.2026 "*Për miratimin e Dokumentin e Politikave Prioritare 2027-2029*", i cili përbën një instrument kyç të procesit të planifikimit të integruar. DPP synon të sigurojë orientimin e vendimmarrjes strategjike dhe shpërndarjen efektive të burimeve publike në përputhje me prioritetet kombëtare dhe zhvillimet e reja, duke forcuar ndërlidhjen ndërmjet prioriteteve strategjike dhe burimeve financiare të disponueshme.

- Në maj të këtij viti u miratua "*Udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm 2026-2030*". Procesi i hartimit dhe koordinimit të dokumentit është udhëhequr nga SASPAC, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe partnerët ndërkombëtarë. Udhërrëfyesi, i cili përbën një instrument të rëndësishëm për drejtimin dhe koordinimin e përpjekjeve kombëtare në funksion të përmbushjes së Agjendës 2030, është miratuar me VKM nr. 381, datë 28.05.2026 "*Për miratimin e Udhërrëfyesit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2026-2030*".

- Në kuadër të procesit të integrimit evropian, është intensifikuar cikli vendimmarrës duke u orientuar drejt zbatimit të angazhimeve dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2026, përmes aktivizimit të strukturave ekzistuese të qeverisjes së procesit. Në këtë kuadër, Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) mbeten boshti themelor për koordinimin teknik dhe politik të negociatave. Gjatë kësaj periudhe, 36 GNPIE-të kanë zhvilluar gjithsej 86 takime, me pjesëmarrjen aktive të 2203 anëtarëve.

- Gjithashtu, është konsoliduar më tej mekanizmi i qeverisjes së integrimit evropian, me fokus të shtuar në forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve negociuese. Një zhvillim i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ishte miratimi i Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e

Kapaciteteve Administrative dhe Institucionale për vitin 2026, i cili mbulon 33 kapitujt e negociatave dhe 3 kriteret, si dhe përmban në total 487 masa administrative dhe institucionale.

- Në datë 28 maj 2026 është zhvilluar mbledhja e Rrjetit IE, në të cilin u aprovua "*Raporti Kombëtar i Veprimtarisë GNPIE dhe Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integrimit Evropian*" për periudhën janar-prill 2026. Gjatë këtyre katër muajve, mekanizmi i qeverisjes së integrimit evropian shënoi një fazë të re operacionalizimi, duke u konsoliduar si një pikë kthese në kalimin nga koordinimi i gjerë institucional drejt menaxhimit të fokusuar në rezultatet negociuese. Më konkretisht, gjatë periudhës raportuese u zhvilluan 5 takime të Grupit Negociator, 9 takime të Rrjetit të Integrimit Evropian dhe 86 mbledhje të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), me pjesëmarrjen e mbi 2203 anëtarëve.

- Në kuadër të hartimit të politikave të mbështetura në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, që garanton përputhje me *acquis*-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë miratuar dhe konsultuar 41 akte të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014. Ndërkohë, ka vijuar koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të procesit të konsultimit publik nga ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të Kryeministrit. Për 41 aktet e miratuara dhe të konsultuara gjatë periudhës janar-23 korrik 2026 janë përgatitur raportet individuale të konsultimit publik, të cilat pas shqyrtimit dhe konfirmimit nga struktura përgjegjëse, janë publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik.

- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit, puna për rishikimin e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, vijoi nëpërmjet konsultimeve të mëtejshme me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Departamenti i Administratës Publike kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me Komisionin Evropian dhe ekspertët e OECD/SIGMA, për të diskutuar dhe adresuar komentet dhe sugjerimet e tyre. Në fund të muajit mars, në Tiranë, u zhvillua një takim i dedikuar, me pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Departamentit të Administratës Publike, përfaqësuesve të lartë të OECD/SIGMA dhe ekspertit të angazhuar në hartimin e projektligjit, me qëllim diskutimin e çështjeve teknike të mbetura.

- Me qëllim konsolidimin e praktikave të rregullta promovuese të kapitalit njerëzor, më 29 qershor-3 korrik 2026 u organizua edicioni i tretë i Javës së Administratës Publike 2026, nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike. Gjatë kësaj jave u zhvillua një program i larmishëm aktivitetesh kushtuar administratës publike 2030, me fokus zhvillimin e talenteve, forcimin e lidershipit, integritetin, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe

përgatitjen e institucioneve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, i cili u konkretizua përmes këtyre aktiviteteve: Karriera ime: Administrata zgjedhje e parë, më datë 29 qershor 2026; Ti je Aset: Nga formimi në ekselencë, më datë 30 qershor 2026; Përvoja që frymëzon: Vitet që ndërtuan administratën publike, më datë 2 korrik 2026; Formëso të ardhmen evropiane të Shqipërisë: Karrierë me impakt në shërbimin publik, më datë 3 korrik 2026; Kampionati i volejbollit: Kampionati i administratës, më datë 29 qershor - 3 korrik 2026.

- Në kuadër të Reformës së Administratës Publike, MAPA dhe DAP ka zhvilluar dhe mbështetur aktivitete të fokusuara në rritjen e performancës, forcimin e integritetit dhe konsolidimin e standardeve profesionale në shërbimin civil. Në mars të këtij viti u zhvillua Konferenca e Nivelit të Lartë për Reformën në Administratën Publike, në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian, projektin "EU4GoodGovernance" dhe Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Gjatë konferencës, diskutimet u përqëndruan te përmirësimi i menaxhimit të performancës, sistemet e vlerësimit, mekanizmat e motivimit dhe shpërblimit, si dhe delegimi i përgjegjësive.

- Gjatë periudhës janar-qershor 2026, DAP dhe ASPA kanë vijuar punën për forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të administratës publike, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Planin Vjetor të Trajnimeve. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar një sërë programesh dhe modulesh trajnimi në fusha të ndryshme, duke mbuluar kompetenca dhe tema prioritare për administratën publike, ndër të cilat antikorrupsioni, auditimi dhe kontrolli financiar, drejtësia gjinore dhe mosdiskriminimi, e drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale, etika dhe integriteti, menaxhimi i burimeve njerëzore, lidershipi, planifikimi dhe menaxhimi financiar, prokurimi publik, planifikimi dhe aplikimi për fondet e BE-së, qeverisja për integrimin evropian, si dhe të drejtat themelore dhe mbrojtja nga diskriminimi.

  Në funksion të përshtatjes së moduleve të trajnimeve me nevojat e administratës dhe zhvillimet e reja profesionale, gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe kurrikula të reja dhe janë zhvilluar tematika me rëndësi për forcimin e kompetencave menaxheriale, teknike dhe profesionale. Ndër to veçohen kurrikula "Hartimi i Planit të Biznesit", e hartuar nga ASPA në përgjigje të nevojave të grupit të synuar, si dhe tematika të tilla si: "Procedurat e reja të menaxhimit të investimeve", "Menaxhimi i burimeve njerëzore", "Auditimi i performancës", "AI në menaxhim", "Menaxhimi i projektit" dhe "Koncesionet dhe PPP". Këto zhvillime synojnë të pasurojnë kurrikulat e formimit profesional dhe të forcojnë kapacitetet e administratës publike për përmbushjen efektive të funksioneve dhe përgjegjësive institucionale.

- Shkolla Shqiptare e Administratës Publik ka vijuar forcimin e bashkëpunimit institucional me partnerë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, me synim shkëmbimin e eksperiencave, transferimin e praktikave më të mira dhe rritjen e kapaciteteve të

administratës publike. Në nivel rajonal dhe evropian, ASPA bashkëpunon ngushtë me ReSPA dhe EIPA, duke marrë pjesë në iniciativa të përbashkëta, programe zhvillimi profesional dhe aktivitete për forcimin e administratës publike.

Gjithashtu, ASPA ka në fuqi marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe dhe partnerësh strategjikë, ndër të cilët: Lech Kaczyński National School of Public Administration, Institut National du Service Public – Francë, The Italian National School of Administration, Ludovika University of Public Service, Agjencia Universitare e Frankofonisë, Instituti i Kosovës për Administratën Publike, UNDP, si dhe me institucione kombëtare. Këto partneritete mbështesin zhvillimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit, shkëmbimin e ekspertizës, si dhe zbatimin e iniciativave të përbashkëta në funksion të modernizimit të administratës publike dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

- Në kuadër të hartimit të kurrikulave me interes për palët e treta, është hartuar kurrikula "*Hartimi i Planit të Biznesit*", e cila është konceptuar për t'iu përgjigjur nevojave të këtij grupi të synuar. ASPA ofron një gamë të gjerë programesh trajnimi me interes edhe për palët e treta, ndër të cilat tematikat më të kërkuara janë: Antikorrupsioni, Auditimi, Vlerësimi dhe Kontrolli Financiar, Drejtësia Gjinore dhe Mosdiskriminimi, E Drejta e Informimit dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale, Etika dhe Integriteti në Administratën Publike, si dhe tema të tjera të përfshira në Planin Vjetor të Trajnimeve të ASPA-s. Këto programe janë të hapura për të gjitha grupet e interesit që kanë nevojë për zhvillim profesional në këto fusha. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, ASPA ka zhvilluar një sërë trajnimesh për të tretët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë këtyre trajnimeve janë certifikuar 360 pjesëmarrës.

- Gjithashtu, ASPA ka rishikuar dhe përshtatur kurrikulat sipas programit të ri të miratuar. Këshilli Drejtues ka miratuar programin e rishikuar "*Prezantimi me Administratën Publike*". Ky program trajnimi është hartuar mbi bazën e analizës së kryer në kuadër të projektit EU4Good Governance - "Onboarding and Induction Training in the Albanian Civil Service", me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe SIGMA-s, si dhe në konsultim me trajnerë dhe ekspertë të fushës. Programi synon zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për integrimin profesional të nëpunësve civilë, duke mbështetur ushtrimin e detyrës në përputhje me parimet e profesionalizmit, etikës dhe shërbimit ndaj qytetarit.

- Sistemi HRMIS është plotësisht funksional për procesin e gjenerimit të automatizuar të listëpagesave. Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha ministritë, me qëllim finalizimin me sukses të procesit të llogaritjes së pagave për muajt prill, maj dhe qershor. Ky proces ka mundësuar vijimin me gjenerimin dhe testimin e dërgimit elektronik të urdhër-shpenzimeve pranë sistemit të Thesarit, duke kontribuar në përmbylljen e procesit të ekzekutimit të pagave. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, është finalizuar me sukses procesi i llogaritjes së pagave për pothuajse të gjitha ministritë

(11/13), ndërsa për një pjesë të tyre është realizuar edhe dërgimi elektronik i urdhër-shpenzimeve pranë sistemit të Thesarit (3/13).

- Njëkohësisht ka vijuar puna për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve që përdorin HRMIS. Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë zhvilluar 3 kurse online për modulin "*Administrimi dhe Menaxhimi i të Dhënave në Regjistrin Qendror të Personelit*" ku janë trajnuar 62 pjesëmarrës.

- Më 18 maj 2026 u lançua platforma e përditësuar e-Albania 2.0, një hap i ri në transformimin e metejshem digjital të shërbimeve publike online në Shqipëri. Platforma e re sjell një eksperiencë më efikase, më të shpejtë dhe më të aksesueshme për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe per personat me aftesi te kufizuara, duke vendosur standarde të reja në ofrimin e shërbimeve elektronike. Risitë e e-Albania 2.0 janë: Infrastrukturë tërësisht e modernizuar; Aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara; Menaxhim i autorizimeve për delegimin e përkohshëm të përdorimit të shërbimeve publike online për bizneset; Optimizim i procesit të autentikimit.

- Më datë 2 korrik 2026, Kuvendi miratoi ligjin "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*"". Ndryshimet synojnë të forcojnë organizimin, funksionimin dhe llogaridhënien e administratës shtetërore. Kuadri ligjor i rishikuar parashikon, ndër të tjera, masa për përmirësimin e arkitekturës institucionale të administratës shtetërore, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe forcimin e eficiencës dhe koherencës së sistemit administrativ. Ndryshimet kryesore të ligjit përfshijnë: 1) Krijimin e sistemit efektiv të mbikëqyrjes/llogaridhënies për institucionet e varësisë; 2) Mirëpërcaktimin e tipologjisë institucionale; 3) Riorganizimin e qendrës së qeverisë duke e lehtësuar atë nga institucionet që nuk mbështesin drejtpërdrejt ushtrimin e funksioneve kushtetuese të Kryeministrit; 4) Kufizimin e shkëputjes së strukturave të vogla të brendshme ministrore (drejtori/drejtori të përgjithshme) dhe të organizimit të tyre si institucione varësie më vete; 5) Mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi ndryshimet institucionale; 6) Transferimin e vendimmarrjes në nivel drejtorie të përgjithshme/departamenti, shoqëruar me rritjen e përgjegjësisë menaxheriale dhe lehtësimin e barrës së shtuar mbi pozicionet e ministrit apo sekretarit të përgjithshëm.

- Administrata publike ka përparuar në lidhje me krijimin e mekanizmave të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve për performancën dhe vendimmarrjen e tyre. Monitorimi i plotë dhe i vazhdueshëm i Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) ka mundësuar ndjekjen në kohë reale të trajtimit të aplikimeve dhe respektimin e afateve ligjore, duke rritur transparencën dhe përgjegjësinë institucionale. Për periudhën janar-qershor 2026, është ndërmarrë dhe zbatuar një paketë të plotë masash dhe aktivitetesh me qëllim forcimin e monitorimit të aplikimeve hyrëse të institucioneve publike, rritjen e transparencës, si dhe garantimin e respektimit të afateve ligjore të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në kuadër të forcimit

të monitorimit, është realizuar ndjekja në kohë reale e aplikimeve përmes sistemit SQDNE, duke mundësuar evidentimin e aplikimeve në proces, të përfunduara brenda afateve ligjore, si dhe të atyre të vonuara apo të pa trajtuara. Ky proces ka shërbyer si bazë për identifikimin e problematikave konkrete dhe për ndërhyrjen në kohë pranë institucioneve përgjegjëse. Paralelisht, janë përpunuar dhe analizuar në mënyrë periodike të dhëna statistikore mbi performancën e institucioneve publike në trajtimin e aplikimeve. Për periudhën 1 janar-30 qershor 2026, në sistemin e monitorimit SQDNE janë monitoruar gjithsej 1.252.612 aplikime të ardhura.

- Në kuadër të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, gjatë periudhës janar-qershor 2026, Zyra e Komisionerit miratoi "*Planin e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes për Transparencën Proaktive për vitin 2026*". Gjatë periudhës së raportimit u zhvilluan 20 hetime administrative pranë autoriteteve publike, prej të cilave 8 në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 12 në institucionet e administratës qendrore dhe institucionet e varësisë, me fokus publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës.

  Gjatë kësaj periudhe, "*Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit*" u instalua në 20 autoritete të reja publike, duke e çuar në 292 numrin total të institucioneve që përdorin sistemin. Instalimi u shoqërua me trajnimin e koordinatorëve për përdorimin e sistemit dhe zbatimin e detyrimeve ligjore.

- Për sa i përket integrimit të kritereve mjedisore në mënyrë të qendrueshme në prokurimet publike konstatohet se ka ardhur në rritje numri i procedurave ku përdoren kriteret e gjelbra nga ana e Autoriteteve Kontraktore. Në rritjen e numrit të procedurave ka ndikuar edhe nxjerrja e akteve nënligjore në formën e udhërrëfyesve, ku përmendim ndër të tjera Udhërrëfyesin "*Mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në procedurat e prokurimit publik*".

- Në lidhje me rritjen e kapaciteteve profesionale për "Administratën e Gjelbër" në kuadër të projektit "*EU for Circular Economy and Livable Cities Albania*", ASPA në bashkëpunim me GIZ, ka hartuar kurrikulat "*Menaxhimi i integruar i mbetjeve*" dhe "*Ekonomia qarkulluese*", të cilat shërbejnë si bazë për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe sesioneve informuese në këto fusha. Në vijim të hartimit të tyre, janë zhvilluar trajnime pilot për testimin dhe validimin e kurrikulave, si dhe janë organizuar workshop-e tematike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2.2 Impakti i implementimit të Strategjisë në përputhje me axhendën e Integrimit Europian

Reforma në Administratën Publike (RAP) përbën një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare në funksion të përmbushjes së objektivit për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe të zhvillimit të një administrate publike profesionale, efikase, transparente dhe të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët dhe biznesin.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash në fushën e administratës publike, të cilat janë planifikuar, zbatuar dhe monitoruar në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike. Ecuria e këtyre reformave është vlerësuar edhe në kuadër të monitorimeve të OECD/SIGMA, përmes të cilave është evidentuar progresi i Shqipërisë në një sërë fushash të administratës publike. Sipas vlerësimeve të paraqitura në raportet e viteve 2021 dhe 2024, Shqipëria ka shfaqur performancë të mirë në disa indikatorë, duke u renditur ndër vendet me rezultatet më të larta në rajon.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025-2030, përbën kornizën strategjike për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e reformës në administratën publike gjatë periudhës deri në vitin 2030. SNRAP 2025-2030 orienton veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse dhe kontribuese në drejtim të përmbushjes së objektivave të reformës dhe forcimit të kapaciteteve administrative, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian.

Reforma në Administratën Publike përbën një komponent të rëndësishëm të procesit të integrimit evropian dhe, në kuadër të metodologjisë së rishikuar të zgjerimit, është pjesë e Grupkapitujve "Themeloret". Në këtë kontekst, progresi në reformën e administratës publike lidhet drejtpërdrejt me forcimin e kapaciteteve të administratës shtetërore, mirëfunksionimin e institucioneve dhe aftësinë për të përmbushur në mënyrë efektive angazhimet që burojnë nga procesi i negociatave dhe përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, parashikimet e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike janë harmonizuar me vizionin dhe prioritetet e agjendës kombëtare të integrimit evropian dhe, në mënyrë të veçantë, me angazhimet e përcaktuara në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030. Udhërrëfyesi, i miratuar nga Qeveria Shqiptare në dhjetor 2023, përcakton drejtimet dhe masat prioritare për avancimin e reformës në administratën publike, në funksion të përmbushjes së angazhimeve të procesit të integrimit evropian dhe mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Udhërrëfyesi shërben si një dokument referues për përmirësimin e performancës së administratës publike, rritjen e cilësisë dhe standardizimin e shërbimeve publike, si dhe forcimin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë institucionale.[14]

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030, si dhe me strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale që lidhen me kornizën e qeverisjes së mirë. Në përputhje me

[14] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, miratuar me VKM nr. 737, datë 13.12.2023.

prioritetet e përcaktuara në SKZHIE 2022-2030, reforma në administratën publike synon të adresojë nevojat e qytetarëve dhe të biznesit përmes ndërtimit dhe konsolidimit të një administrate publike të përgjegjshme, transparente, profesionale dhe efikase.

Në këtë kuadër, forcimi i kapaciteteve administrative dhe përmirësimi i performancës institucionale synojnë të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, përmirësimin e marrëdhënieve të administratës me qytetarët dhe biznesin, si dhe në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025-2030 është në përputhje me Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Zbatimi i masave dhe angazhimeve të përcaktuara në Strategji kontribuon në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht përmes forcimit të besimit të publikut në institucionet dhe sistemin demokratik, përmirësimit të performancës së administratës publike, si dhe rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse.

Në këtë kuadër, Reforma në Administratën Publike kontribuon në avancimin e Agjendës 2030 përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike, si dhe përmes promovimit të parimeve të qeverisjes së mirë në nivel qendror dhe vendor.

Për të mbështetur zbatimin e prioriteteve të përcaktuara në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, Strategjia shoqërohet me Planin e Veprimit dhe Pasaportën e Treguesve. Këto instrumente operacionalizojnë objektivat e Strategjisë, duke përcaktuar masat, aktivitetet, përgjegjësitë dhe treguesit përkatës për monitorimin e progresit gjatë periudhës së zbatimit. Njëkohësisht, ato krijojnë bazën për vijimin e procesit të planifikimit dhe për hartimin e planeve të veprimit për periudhat pasuese, duke mundësuar përshtatjen e ndërhyrjeve dhe prioriteteve me zhvillimet dhe nevojat e identifikuara gjatë zbatimit të Strategjisë.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025-2030 gjatë periudhës janar-qershor 2026 ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të procesit të integrimit evropian, duke mbështetur përafrimin gradual të administratës publike shqiptare me parimet dhe standardet evropiane të administratës publike, veçanërisht në drejtim të profesionalizmit, efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, digjitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve të orientuara ndaj qytetarit.

Në kuadër të agjendës së integrimit evropian, zbatimi i reformave **në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave** gjatë periudhës janar-qershor 2026, masat e zbatuara kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale për hartimin, koordinimin dhe vlerësimin e politikave publike, në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane. Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, mbështetja teknike nga SASPAC dhe funksionimi i Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) kanë mbështetur një qasje më të strukturuar dhe të koordinuar në procesin e politikëbërjes.

Një komponent i rëndësishëm i këtij procesi lidhet me forcimin e përdorimit të instrumenteve të politikëbërjes të bazuar në evidenca. Në këtë drejtim, përdorimi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) është konsoliduar më tej në procesin e hartimit të legjislacionit. Gjatë periudhës raportuese, 100% e projektligjeve të miratuara në Këshillin e Ministrave, të cilat plotësonin kriteret për t'u shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, janë shoqëruar me raportin përkatës RIA. Ky rezultat përbën një tregues të rëndësishëm të forcimit të cilësisë së procesit politikëbërës dhe të përdorimit sistematik të analizës së ndikimit në mbështetje të vendimmarrjes.

Në të njëjtën kohë, publikimi i draft-raporteve RIA në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), përpara finalizimit të tyre, ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe në zgjerimin e mundësive për përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin politikëbërës. Kjo praktikë forcon konsultimin publik në faza më të hershme të hartimit të politikave dhe legjislacionit, duke krijuar mundësi për përfshirjen e komenteve dhe evidencave të jashtme në procesin vendimmarrës.

Gjithashtu, masat për forcimin e kapaciteteve në fushën e integrimit evropian, përmes planeve, kurrikulave dhe trajnimeve të specializuara për nëpunësit e angazhuar në proces, kanë mbështetur rritjen e kapaciteteve administrative për përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga procesi i negociatave. Në tërësi, këto reforma kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së politikëbërjes, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe rritjen e aftësisë së administratës publike për të përgatitur, zbatuar dhe monitoruar politika në përputhje me kërkesat e integrimit evropian dhe standardet e acquis të Bashkimit Evropian.

Në fushën e shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, gjatë periudhës janar-qershor 2026 është evidentuar progres në forcimin e profesionalizmit, transparencës dhe kapaciteteve institucionale të administratës publike. Zhvillimet e kësaj periudhe janë orientuar drejt përmirësimit të kuadrit rregullator, forcimit të kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale, si dhe zgjerimit të mundësive për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të nëpunësve publikë. Këto ndërhyrje synojnë konsolidimin e një shërbimi civil të bazuar në meritë, profesionalizëm dhe integritet, në përputhje me parimet dhe standardet evropiane të administratës publike.

Në këtë kuadër, ka vijuar procesi i rishikimit të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, përmes konsultimeve të mëtejshme me partnerët ndërkombëtarë. Gjatë periudhës raportuese, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Departamenti i Administratës Publike kanë vijuar komunikimin me Komisionin Evropian dhe ekspertët e OECD/SIGMA, me qëllim shqyrtimin dhe adresimin e komenteve dhe sugjerimeve lidhur me projektligjin.

Paralelisht, forcimi i kapaciteteve profesionale dhe menaxheriale ka vijuar të mbështetet përmes programeve të zhvillimit profesional të administratës publike. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ka vijuar bashkëpunimin me partnerë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve publikë. Në nivel rajonal dhe evropian, bashkëpunimi me ReSPA dhe

EIPA ka mbështetur pjesëmarrjen në iniciativa të përbashkëta, programe të zhvillimit profesional dhe aktivitete të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve të administratës publike. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe dhe partnerë strategjikë krijojnë një bazë të qëndrueshme për shkëmbimin e njohurive dhe transferimin e praktikave të mira.

Në tërësi, këto zhvillime kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe menaxheriale të administratës publike, në përmirësimin e mekanizmave të shërbimit civil dhe në krijimin e kushteve për një administratë më profesionale, të qëndrueshme dhe të orientuar drejt performancës. Përparimi në këtë fushë është veçanërisht i rëndësishëm në kuadër të procesit të integrimit evropian, pasi kapacitetet e mjaftueshme administrative dhe një shërbim civil profesional përbëjnë elemente thelbësore për zbatimin efektiv të *acquis* të Bashkimit Evropian dhe për përmbushjen e angazhimeve të procesit të negociatave.

Në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe digjitalizimit të shërbimeve publike është evidentuar progres i rëndësishëm gjatë periudhës janar-qershor 2026, i orientuar drejt forcimit të infrastrukturës digjitale, rritjes së ndërveprueshmërisë ndërmjet sistemeve dhe përmirësimit të aksesit dhe cilësisë së shërbimeve publike online. Këto zhvillime kontribuojnë në transformimin digjital të administratës publike dhe në krijimin e një modeli më të integruar, efikas dhe të orientuar drejt nevojave të qytetarëve dhe bizneseve.

Një nga zhvillimet kryesore të kësaj periudhe ishte lançimi, më 18 maj 2026, i platformës së përditësuar "e-Albania 2.0", e cila përfaqëson një hap të mëtejshëm në modernizimin e ofrimit të shërbimeve publike online. Platforma e re përfshin një infrastrukturë të modernizuar dhe përmirësime në funksionalitetet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve, duke synuar një përvojë më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët dhe bizneset.

Në perspektivën e integrimit evropian, këto zhvillime mbështesin përafrimin gradual me standardet dhe praktikat evropiane në fushën e qeverisjes digjitale, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe aksesueshmërisë së shërbimeve publike.

Në fushën e organizimit, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes së administratës publike, gjatë periudhës janar-qershor 2026 është evidentuar progres në forcimin e mekanizmave institucionalë të përgjegjshmërisë, transparencës dhe monitorimit të veprimtarisë administrative.

Një zhvillim i rëndësishëm në këtë drejtim është miratimi, më 2 korrik 2026, nga Kuvendi i ligjit "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2012, 'Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore'*". Ndryshimet e miratuara synojnë përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe forcimin e efikasitetit dhe koherencës së sistemit administrativ.

Administrata publike ka përparuar në lidhje me krijimin e mekanizmave të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve për performancën dhe vendimmarrjen e tyre. Monitorimi i plotë dhe i vazhdueshëm i Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me

Nënshkrim Elektronik (SQDNE) ka mundësuar ndjekjen në kohë reale të trajtimit të aplikimeve dhe respektimin e afateve ligjore, duke rritur transparencën dhe përgjegjësinë institucionale.

Në perspektivën e integrimit evropian, këto zhvillime kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të administratës për të funksionuar mbi bazën e parimeve të transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit. Përmirësimi i organizimit institucional dhe i mekanizmave të mbikëqyrjes mbështet konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe të përgjegjshme, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe kërkesat e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Forcimi i këtyre mekanizmave merr rëndësi të veçantë në kontekstin e progresit të Shqipërisë në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Progresi i arritur në këtë proces ka mbështetur intensifikimin e negociatave gjatë vitit 2026, ndërsa deri në periudhën raportuese janë mbyllur provizorisht tre kapituj negociatash: Kapitulli 25 "*Shkenca dhe Kërkimi*", Kapitulli 26 "*Arsimi dhe Kultura*" dhe Kapitulli 30 "*Marrëdhëniet me Jashtë*".

Në fushën e administratës së gjelbër, gjatë periudhës janar-qershor 2026 është vijuar me integrimin gradual të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në funksionimin e administratës publike, veçanërisht përmes forcimit të prokurimit publik të gjelbër dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit të mbetjeve.

Në drejtim të integrimit të kritereve mjedisore në procedurat e prokurimit publik, është evidentuar rritje e numrit të procedurave në të cilat Autoritetet Kontraktore kanë përdorur kritere të gjelbra. Ky zhvillim është mbështetur edhe nga hartimi dhe miratimi i udhëzuesve dhe akteve nënligjore përkatëse, ndër të cilat Udhërrëfyesi "*Mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në procedurat e prokurimit publik*". Përdorimi më i gjerë i kritereve mjedisore në prokurimet publike përbën një hap të rëndësishëm drejt integrimit të konsideratave të qëndrueshmërisë në proceset e shpenzimeve publike dhe nxitjes së praktikave më të përgjegjshme mjedisore nga institucionet publike.

Paralelisht, forcimi i kapaciteteve profesionale për administratën e gjelbër është mbështetur në kuadër të projektit "EU for Circular Economy and Livable Cities Albania". Në këtë kuadër, ASPA, në bashkëpunim me GIZ, ka hartuar kurrikulat "*Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve*" dhe "*Ekonomia Qarkulluese*", të cilat krijojnë bazën për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe aktiviteteve informuese për nëpunësit publikë dhe aktorët e tjerë relevantë. Në vijim të hartimit të kurrikulave, janë zhvilluar trajnime pilot për testimin dhe validimin e tyre, si dhe workshop-e tematike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Këto ndërhyrje kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve institucionale për integrimin e parimeve të "ekonomisë qarkulluese", "menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve" dhe "praktikave mjedisore" në veprimtarinë e administratës publike. Në perspektivën e integrimit evropian, forcimi i administratës së gjelbër mbështet përafrimin gradual me politikat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Në tërësi, zbatimi i Strategjisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka kontribuar në forcimin gradual të kapaciteteve institucionale dhe administrative të nevojshme për avancimin e procesit të integrimit evropian. Ndërhyrjet e ndërmarra në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, digjitalizimit të administratës, organizimit dhe llogaridhënies institucionale, si dhe administratës së gjelbër, kanë mbështetur konsolidimin e një administrate më profesionale, efikase, digjitale, transparente dhe të përgjegjshme.

Këto zhvillime kanë ndikuar jo vetëm në përmirësimin e mekanizmave dhe kapaciteteve të brendshme të administratës publike, por edhe në rritjen e aftësisë së institucioneve për të hartuar dhe zbatuar politika, për të përmbushur angazhimet që burojnë nga procesi i negociatave dhe për të ofruar shërbime publike më cilësore dhe më të aksesueshme për qytetarët dhe biznesin.

Në këtë perspektivë, SNRAP 2025-2030 vijon të përmbushë rolin e saj si një instrument horizontal dhe mbështetës i agjendës së integrimit evropian, duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve administrative të qëndrueshme dhe në përafrimin gradual të funksionimit të administratës publike me standardet dhe praktikat e Bashkimit Evropian.

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Gjatë vitit 2025 dhe periudhës janar-qershor 2026, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike ka shënuar progres të rëndësishëm. Megjithatë, mbeten disa komponentë që kërkojnë vëmendje dhe adresim të mëtejshëm, me qëllim sigurimin e vijueshmërisë dhe rritjen e efektivitetit të reformës në periudhën në vijim.

Një ndër prioritetet kryesore lidhet me forcimin e koordinimit ndërinstitucional, me synim përmbylljen e masave të mbetura pjesërisht të zbatuara dhe, veçanërisht, adresimin e masave me nivel të ulët zbatimi gjatë kësaj periudhe, në përputhje me afatet e planifikuara. Në këtë drejtim, nevojitet një angazhim më i strukturuar dhe i qëndrueshëm nga institucionet përgjegjëse, për të garantuar vijimësinë e zbatimit dhe për të shmangur fragmentimin e ndërhyrjeve.

Në të njëjtën kohë, nevojitet marrja e masave në kohë për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të parashikuara për vitin 2026, duke siguruar një qasje më proaktive dhe të koordinuar përgjatë gjithë ciklit të politikëbërjes dhe zbatimit. Në këtë drejtim, kërkohet forcimi i mekanizmave të bashkërendimit dhe qartësimi i mëtejshëm i ndarjes së përgjegjësive ndërmjet institucioneve përkatëse.

Gjithashtu, mbetet e rëndësishme konsolidimi i mëtejshëm i sistemeve të monitorimit dhe raportimit, me synim sigurimin e një pasqyre më të plotë, të integruar dhe të krahasueshme mbi progresin e zbatimit të strategjisë, si dhe forcimin e vendimmarrjes të bazuar në evidencë.

Në tërësi, adresimi i këtyre komponentëve do të kontribuojë në rritjen e koherencës, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së zbatimit të SNRAP, duke krijuar një bazë më të qëndrueshme për realizimin e objektivave strategjikë në vitet në vijim.

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Procesi i financimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025–2030 (SNRAP) mbështetet në kontributin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2025-2027. Kuadri financiar i Strategjisë dhe Planit të Veprimit merr në konsideratë burimet e brendshme financiare të institucioneve që mbulohet përmes buxhetit të shtetit, si dhe financimin e siguruar apo të planifikuar nga partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët. Në këtë kuadër, procesi i financimit synon të evidentojë jo vetëm burimet financiare të disponueshme për zbatimin e aktiviteteve, por edhe nevojat dhe boshllëqet eventuale financiare që mund të kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme nga institucionet përgjegjëse.

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, institucionet përgjegjëse janë udhëzuar për të identifikuar dhe përllogaritur kostot financiare të aktiviteteve të planifikuara, duke marrë në konsideratë burimet e tyre të brendshme, përfshirë fondet e parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), kostot me karakter administrativ dhe ato të lidhura me investimet, si dhe projektet dhe programet e mbështetura nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo qasje synon të sigurojë që aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit të kenë një bazë të identifikueshme financimi dhe të garantohet, në masën e mundshme, qëndrueshmëria financiare e zbatimit të tyre.

Financimi i Planit të Veprimit mbështetet kryesisht në dy burime: buxhetin e shtetit dhe asistencën financiare të partnerëve ndërkombëtarë dhe donatorëve. Për aktivitetet që financohen nga buxheti i shtetit, financimi realizohet nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetet e institucioneve përgjegjëse, ndërsa për aktivitetet e mbështetura nga donatorët, financimi lidhet me projektet dhe programet përkatëse të asistencës.

Për periudhën janar-qershor 2026, vlerësimi i ekzekutimit financiar të Planit të Veprimit mbetet paraprak, duke qenë se pjesa më e madhe e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për këtë periudhë janë ende në proces zbatimi. Për këtë arsye, në këtë raport gjashtëmujor nuk paraqiten të dhëna të detajuara mbi nivelin e ekzekutimit të buxhetit. Nga informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse rezulton se pjesa më e madhe e aktiviteteve parashikohet të mbulohet nga kostot administrative, të financuara kryesisht nga buxheti i shtetit, në kuadër të buxheteve dhe PBA-ve përkatëse të institucioneve zbatuese.

Për sa më sipër, një analizë e plotë e financimit dhe e nivelit të ekzekutimit të buxhetit, sipas aktiviteteve të Planit të Veprimit 2025-2027 dhe burimeve të financimit, do të paraqitet në Raportin Vjetor të Monitorimit për vitin 2026. Raporti vjetor do të mundësojë një vlerësim më të plotë të marrëdhënies ndërmjet fondeve të planifikuara dhe atyre të përdorura, si dhe të burimeve të financimit të përdorura për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të SNRAP 2025-2030.

PJESA III – PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKË, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT

Në këtë kapitull do të analizohet progresi i arritur në drejtim të secilit qëllim politik, objektivi specifik dhe mase të Strategjisë, bazuar në ecurinë e treguesve përkatës të performancës dhe progresin e përgjithshëm në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara. Analiza do të evidentojë nivelin e progresit dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, si dhe çështjet që kërkojnë vijimësi ose ndërhyrje të mëtejshme për të siguruar përmbushjen e objektivave të përcaktuar për periudhën 2025-2027.

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës

Në përputhje me dokumentin strategjik të SNRAP 2025-2030, janë zbatuar masa dhe aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027, për periudhën janar-qershor 2026.

QËLLIMI I POLITIKËS I - ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

Qëllimi i Politikës I, synon të sigurojë që zhvillimi dhe koordinimi i politikave, si dhe hartimi, monitorimi dhe vlerësimi i legjislacionit të jenë të rregulluar qartë dhe të lidhur ngushtë me prioritetet e qeverisë dhe planifikimin buxhetor, duke rritur kështu efikasitetin e politikave transparente dhe gjithëpërfshirëse. Kjo shtyllë mbulon komponentët e planifikimit dhe koordinimit të politikave në nivel kombëtar, koordinimit efikas të procesit të integrimit evropian dhe hartimit të një legjislacioni gjithëpërfshirës, bazuar në të dhëna.


Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë realizuar masat dhe aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M e I-rë të 2026	**Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[15]**	**Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[16]**	**Masa dhe aktivitete të pazbatuara[17]**
Qëllimi i Politikës I	Masa	13	8	5	0
	Aktivitete	26	17	4	5

[15] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[16] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[17] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.

Rezulton se, nga 13 masa dhe 26 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027 për Qëllimin e Politikës I "Zhvillimi dhe koordinimi i politikave", gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, janë zbatuar plotësisht 8 masa dhe 17 aktivitete, pjesërisht 5 masa dhe 4 aktivitete, ndërsa 5 aktivitete rezultojnë të pazbatuara. Në nivel masash, nuk rezulton asnjë masë e pazbatuar.

Ecuria e realizimit të masave dhe aktiviteteve të paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Qëllimi i Politikës I përfshin gjithsej 12 tregues performance, nga të cilët, referuar Aneksit 2 të SNRAP 2025-2030 "*Pasaporta e Treguesve të Performancës*", 9 tregues janë të matshëm për këtë periudhë monitorimi, duke pasur parasysh frekuencën vjetore të matjes së tyre.

Për treguesit e performancës të QPI I në tabelën e mëposhtme paraqitet realizueshmëria e tyre.

Qëllimi i Politikës I	Totali i Treguesve e performancës	Totali i Treguesve e Performancës të matur për periudhën janar-qershor 2026	Realizimi i Treguesve të Performancës		
			Vlera e synuar është realizuar plotësisht.[18]	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht.[19]	Vlera e synuar nuk është e realizuar.[20]
	12	9	5	4	0

[18] Që është realizuar në shkallën 100 për qind.
[19] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 99% për qind.
[20] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

Nga 9 treguesit e performancës të matur për periudhën e raportimit për Qëllimin e Politikës I "Zhvillimi dhe koordinimi i politikave", vlera e synuar është arritur plotësisht për 5 tregues, ndërsa për 4 tregues të tjerë është arritur pjesërisht.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar nivelin e progresit, në përqindje, për secilin objektiv specifik të Qëllimit të Politikës I, bazuar në ecurinë e treguesve të performancës dhe nivelin e realizimit të masave përkatëse.

Objektivi Specifik (OS)	Shkalla e realizimit të OS sipas masave.[21]	Shkalla realizimit sipas treguesve të performancës.[22]
OS 1.1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave	75%	80%
OS 1.2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit	80%	61%
OS 1.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare	86%	98%
Zbatueshmëria e Qëllimit të Politikës I	**80%**	**80%**

Nga analiza e mësipërme rezulton se niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës I, i vlerësuar mbi bazën e performancës së treguesve përkatës, është 80%.

Në vijim paraqitet analiza e masave të monitoruara gjatë periudhës raportuese, së bashku me ecurinë e treguesve të performancës përkatës, në funksion të vlerësimit të progresit në zbatimin e Objektivave Specifikë të Qëllimit të Politikës I.

[21] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%

[22] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$ x 100%

Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Objektivi Specifik 1.1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit, përmes një qasjeje të integruar të politikave

Objektivi Specifik 1.1, synon të adresojë të gjitha ato gjetje dhe rekomandime në lidhje me planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave në nivel kombëtar përmes një qasje të integruar dhe të bashkëpunimit efektiv ndërsektorial.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 1.1 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 2 (dy) masa dhe 3 (tre) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 1.1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave.	
Masa 1.1.2	Përmirësimi i Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar, me synim përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të politikave.
Aktiviteti 1.1.2.a	Rishikimi dhe forcimi i efektivitetit të Sistemit aktual të Planifikimit të Integruar (sistemit IT në mbështetje të tij) dhe hartimi i propozimeve për përmirësim.
Aktiviteti 1.1.2.b	Ofrimi i mbështetjes metodologjike në hartimin e dokumentave strategjike dhe Planeve të Veprimit sipas Metodologjisë dhe udhëzimeve të IPSIS.
Masa 1.1.3	Garantimi i shpërndarjes efektive të burimeve dhe vendimmarrjeve strategjike, në përputhje të plotë me zhvillimet shoqërore.
Aktiviteti 1.1.3.a	Hartimi, miratimi, rishikimi periodik i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP) dhe Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 1.1. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Koordinimi i politikave dhe prioriteteve zhvillohet përmes një cikli të rregullt dhe të vazhdueshëm planifikimi, raportimi dhe vendimmarrjeje, të mbështetur në funksionimin e Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS) dhe të mekanizmit të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP). Aktiviteti i GMIP-ve raportohet në KPS, i cili udhëheq procesin e përgjithshëm të zbatimit të reformave dhe miraton programet buxhetore. Në cilësinë e sekretariatit teknik të KPS-së, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)

mbështet përgatitjen e materialeve për vendimmarrje dhe ndjek zbatimin e vendimeve të marra, duke kontribuar në sigurimin e koherencës dhe mbështetjes së vendimmarrjes në evidenca.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, SASPAC është fokusuar në riorganizimin dhe përmirësimin e funksionimit të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP/IPMG), të cilat përbëjnë mekanizmin kryesor për koordinimin e politikave në nivel administrativ. GMIP-të dhe ekipet e tyre tematike kanë vijuar funksionimin në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 01.08.2023 "*Për miratimin e masave për zbatimin e qasjes sektoriale/ndërsektoriale dhe krijimin dhe riorganizimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial*". Gjatë periudhës raportuese, aktiviteti i ekipeve tematike është konkretizuar, ndër të tjera, nëpërmjet:

- **Mbledhjes së datës 28.01.2026** të ekipit tematik "Antikorrupsioni", pjesë e GMIP-së "Demokracia, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë", ku u diskutua dhe u miratua Raporti i Monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2025, lidhur me zbatimin e masave të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Planit të saj të Veprimit;
- **Mbledhjes së datës 13.02.2026**, të udhëhequr nga MSHMS nëpërmjet grupit teknik ndërinstitucional të punës, ku u diskutua puna për përgatitjen e Raportit të Monitorimit për periudhën 2024–2025 të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025;
- **Mbledhjes së datës 03.06.2026** të ekipit tematik të "Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur", ku u prezantua dhe u diskutua konsolidimi i draft-Raportit të Monitorimit për zbatimin e "Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026", për periudhën janar-dhjetor 2025. Gjithashtu, në këtë mbledhje u prezantua fillimi i procesit për hartimin e "Strategjisë së re për të Mitur 2027-2030".

Këto struktura shërbejnë si platforma institucionale për bashkërendimin e politikave sektoriale dhe ndërsektoriale, duke synuar sigurimin e një procesi të hartimit të politikave koherent, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt rezultateve.

Megjithatë, përvoja e funksionimit të GMIP-ve dhe ekipeve tematike gjatë zbatimit të kuadrit aktual rregullator ka evidentuar nevojën për përditësimin e tij, me qëllim përshtatjen e mekanizmit me ndryshimet institucionale dhe organizative, përfshirë strukturën dhe fushat e përgjegjësisë së ministrive, si dhe me prioritetet e përditësuara të qeverisë. Konfigurimi aktual i GMIP-ve nuk reflekton plotësisht këto ndryshime, duke ndikuar në efektivitetin e koordinimit ndërinstitucional dhe në funksionimin optimal të mekanizmit. Në këtë kuadër, procesi i përditësimit të Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 01.08.2023, përbën një hap të rëndësishëm për forcimin dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmit të GMIP-ve.

Në vijim të kësaj qasjeje, gjatë periudhës janar-qershor 2026, SASPAC, në bashkëpunim me projektin EUSFAM, ka vijuar punën për rivitalizimin dhe ripozicionimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), me synim forcimin e rolit të tyre si platforma qendrore për

koordinimin e politikave kombëtare, harmonizimin e mbështetjes së donatorëve dhe prioritizimin e asistencës së huaj në funksion të përmbushjes së prioriteteve të procesit të integrimit evropian. Procesi është zhvilluar në bashkëpunim me SIGMA/OECD dhe synon hartimin e një modeli të përmirësuar institucional të GMIP-ve. Në vijim të këtij procesi, në shtator 2026 është dakordësuar ndërmjet SASPAC dhe ekspertëve përcjellja për konsultim e paketës së finalizuar për GMIP-të e riformatuara.

Me synim ofrimin e mbështetjes metodologjike në hartimin e dokumenteve strategjike dhe Planeve të Veprimit, sipas Metodologjisë dhe udhëzimeve të IPSIS, gjatë gjithë periudhës janar–qershor 2026, SASPAC ka ofruar mbështetje metodologjike të vazhdueshme dhe opinione teknike për institucionet përgjegjëse, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së dokumenteve strategjike me kërkesat dhe standardet e metodologjisë IPSIS. Mbështetja e ofruar ka synuar forcimin e cilësisë së procesit të hartimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, duke siguruar një qasje të integruar dhe koherente me kuadrin strategjik kombëtar, si dhe me angazhimet ndërkombëtare, përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Në këtë kuadër, Agjencia ka ndjekur dhe mbështetur procesin e hartimit të dokumenteve strategjike përmes:

- Ndjekjes së procesit të koordinimit deri në miratimin nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) të vizionit dhe afateve për hartimin e dokumenteve strategjike;
- Pjesëmarrjes në grupet e punës, duke ofruar mbështetje metodologjike gjatë procesit të hartimit të dokumenteve strategjike;
- Shqyrtimit të drafteve të dokumenteve strategjike dhe dhënies së opinioneve teknike, përpara miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, në rastet kur kjo ka qenë e aplikueshme.

Procesi i hartimit të dokumenteve strategjike nis me diskutimet paraprake në mbledhjet e GMIP-ve dhe përfshirjen e dokumentit të propozuar nga institucioni përgjegjës në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) të vitit pasardhës. Në vijim, institucioni përgjegjës ngre grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e dokumentit, ku përfshihen edhe përfaqësues të Agjencisë, të cilët ofrojnë mbështetje metodologjike për garantimin e përputhshmërisë së dokumentit me formatin, kërkesat dhe standardet e IPSIS. Draftet e dokumenteve strategjike paraqiten për orientim dhe shqyrtim politik-strategjik në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS), përpara zhvillimit të procesit të konsultimit publik dhe miratimit përfundimtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbështetja e ofruar nga Agjencia gjatë këtij procesi fokusohet në:

- Garantimin e integrimit dhe koherencës së dokumenteve strategjike me ciklin e politikave publike, nga planifikimi dhe hartimi deri te zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kërkesat e IPSIS, përfshirë VKM nr. 290/2020, VKM nr. 642/2021, Urdhrin e Kryeministrit nr. 90/2023 dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 4/2022;
- Harmonizimin e objektivave, masave dhe rezultateve të synuara të dokumenteve strategjike me prioritetet kombëtare të përcaktuara në SKZHIE 2022-2030, angazhimet ndërkombëtare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), duke siguruar koherencën e politikave dhe orientimin e tyre drejt rezultateve të matshme.

Për sa më sipër, gjatë periudhës së monitorimit, SASPAC ka dhënë mbështetje metodologjike dhe opinione teknike për hartimin dhe/ose rishikimin e disa dokumenteve strategjike, ndër të cilat: "Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030"; "Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030"; "Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale të Shqipërisë 2025-2030"; dhe "Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030".

Gjithashtu, SASPAC ka marrë pjesë në grupet e punës për hartimin e "Strategjisë së Agjendës Digjitale 2027-2031"; "Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2027-2030"; si dhe "Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2026-2030". Këto angazhime kanë kontribuar në sigurimin e zbatimit të kërkesave metodologjike të IPSIS dhe në forcimin e koherencës së dokumenteve të reja strategjike me prioritetet kombëtare dhe ndërsektoriale.

Gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, është miratuar Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) dhe është vijuar me procesin e përditësimit të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP). Me VKM nr. 145, datë 11.03.2026, Këshilli i Ministrave miratoi "Dokumentin e Politikave Prioritare 2027-2029", i cili përbën një instrument kyç të procesit të planifikimit të integruar. DPP synon të sigurojë orientimin e vendimmarrjes strategjike dhe shpërndarjen efektive të burimeve publike në përputhje me prioritetet kombëtare dhe zhvillimet e reja, duke forcuar ndërlidhjen ndërmjet prioriteteve strategjike dhe burimeve financiare të disponueshme. Në këtë kuadër, NSPP, si pjesë integrale e DPP-së, përbën një instrument të rëndësishëm për orientimin e investimeve publike dhe sigurimin e koherencës ndërmjet prioriteteve strategjike dhe projekteve konkrete.

Në përputhje me ciklin e planifikimit, DPP miratohet gjatë katërmujorit të parë të vitit, ndërsa rishikimi i tij, veçanërisht për komponentin e NSPP-së, kryhet gjatë katërmujorit të dytë, me qëllim reflektimin e ndryshimeve dhe prioriteteve të reja.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në cilësinë e institucionit përgjegjës për programimin strategjik dhe koordinimin e ndihmës, në përputhje me VKM nr. 642, datë 29.10.2021, ka vijuar gjatë periudhës janar-qershor 2026 të ofrojë mbështetje teknike dhe metodologjike për institucionet përgjegjëse në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike. Mbështetja ka synuar garantimin e koherencës së këtyre dokumenteve me objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030, si dhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Një arritje e rëndësishme gjatë periudhës së raportimit është hartimi dhe miratimi i "*Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030*". Procesi i hartimit dhe koordinimit të dokumentit është udhëhequr nga SASPAC, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe partnerët ndërkombëtarë. Udhërrëfyesi, i cili përbën një instrument të rëndësishëm për drejtimin dhe koordinimin e përpjekjeve kombëtare në funksion të përmbushjes së Agjendës

2030, është miratuar me VKM nr. 381, datë 28.05.2026 "*Për miratimin e Udhërrëfyesit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2026–2030*".

Miratimi i këtij dokumenti përbën një rezultat konkret të procesit të koordinimit strategjik dhe krijon një kuadër të përditësuar për integrimin e OZHQ-ve në politikat dhe dokumentet strategjike kombëtare.

Objektivi Specifik 1.1 konsiderohet me progres të konsiderueshëm gjatë periudhës janar-qershor 2026. Progresi është evidentuar në vijimin e koordinimit ndërinstitucional përmes mekanizmit të GMIP-ve, ofrimin e mbështetjes metodologjike për hartimin e dokumenteve strategjike dhe garantimin e përputhshmërisë së tyre me standardet e IPSIS, prioritetet kombëtare të SKZHIE 2022-2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjithashtu, është realizuar hartimi dhe miratimi i "Dokumentit të Politikave Prioritare 2027-2029" dhe të Udhërrëfyesit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030. Njëkohësisht ka vijuar procesi i përditësimit të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Për këtë Objektivin Specifik 1.1 në "Pasaportën e Indikatorëve" është përcaktuar një tregues performance, konkretisht: "1.1.1 *Indeksi i përmirësimit të standardit të Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 1.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
1.1.1 Indeksi i përmirësimit të standardit të Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar.	75% dokumentave strategjike të zhvilluara në përputhje me metodologjinë dhe udhëzimet e IPSIS	100% e dokumentave strategjike të zhvilluara në përputhje me metodologjinë dhe udhëzimet e IPSIS	80%	80%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.1[23]				**80%**

[23] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$.

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.1 "*Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 80%.[24]

Treguesi "1.1.1 *Indeksi i përmirësimit të standardit të Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar*" synon që të gjithë dokumentat strategjike të miratuara nga Qeveria, duhet të plotësojnë kriteret dhe standartet e IPSIS. Në këtë kuadër SASPAC, para miratimit të draft-akteve nga Këshilli i Ministrave, duhet të japë një opinion mbi përmbushjen e kritereve të IPSIS për çdo dokument strategjik. Për këtë qëllim SASPAC, si autoritet teknik për udhëzimin e institucioneve publike për hartimin e dokumentave strategjikë do të kryejë një vlerësim mbi aktet e miratuara nga Qeveria, si dhe do të përgatisë një listë nëse përmbushin ose jo udhëzimet e IPSIS. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.1.1, për vitin 2026, është "100% e dokumentave strategjike të zhvilluara në përputhje me metodologjinë dhe udhëzimet e IPSIS".

Përsa më sipër, gjatë periudhës janar-qershor 2026, janë miratuar gjithsej 9 dokumente strategjike. Prej tyre, "*Dokumenti i Politikave Prioritare 2027-2029*", miratuar me VKM nr. 145, datë 11.03.2026, dhe "*Programi i Reformave Ekonomike 2026-2028*", miratuar me VKM nr. 30, datë 21.01.2026, për shkak të natyrës dhe përmbajtjes së tyre specifike, ndjekin një strukturë të ndryshme nga formati standard i IPSIS. Ndërkohë, 7 dokumentet e tjera strategjike të miratuara gjatë kësaj periudhe janë hartuar në përputhje të plotë me strukturën dhe kërkesat e metodologjisë IPSIS.

Në tërësi, edhe gjatë periudhës janar-qershor 2026, institucionet kanë vijuar të zbatojnë metodologjinë dhe udhëzimet e IPSIS në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike, duke reflektuar një nivel të lartë standardizimi të procesit të planifikimit strategjik. Në këtë kuadër, roli i SASPAC si autoritet teknik për vlerësimin e përputhshmërisë së dokumenteve strategjike me kërkesat e IPSIS është konsoliduar më tej, përmes shqyrtimit sistematik të dokumenteve dhe dhënies së opinioneve teknike përpara paraqitjes së tyre për miratim në Këshillin e Ministrave.

Megjithatë, funksionimi aktual i sistemit IPSIS paraqet disa sfida në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Për periudhën e raportimit, mbledhja e informacionit është realizuar në mënyrë manuale, ndërsa analiza është kryer rast pas rasti për dokumentet strategjike për të cilat është kërkuar opinion nga Agjencia. Për rrjedhojë, raportimi mbështetet në evidenca administrative të fragmentuara, duke kufizuar mundësinë për një analizë të plotë, të unifikuar dhe të standardizuar të të dhënave mbi përputhshmërinë e dokumenteve strategjike me kërkesat e IPSIS.

Në vijim, për përmirësimin e funksionalitetit të sistemit IPSIS dhe forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit, parashikohen këta hapa:

[24] Për detaje mbi metodologjine, burimin e te dhenave dhe mënyrën e llogaritje, referoju Aneksit 2, të Raportit të Monitorimit.

- Në bashkëpunim me Asistencën Teknike "EUSFAM", do të vijojë procesi i rivitalizimit dhe përmirësimit të sistemit IPSIS.
- Përfundimi i analizës për rishikimin e Urdhrit nr. 90/2023 për Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), si dhe vijimi me miratimin e urdhrit të ndryshuar.

Objektivi Specifik 1.2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit

Procesi i integrimit në Bashkimin Evropian është projekti madhor strategjik i shtetit shqiptar, i cili ofron udhërrëfyesin më të qartë për konsolidimin e institucioneve demokratike, garantimin e shtetit të së drejtës dhe avancimin e reformave themelore drejt përmbushjes së standardeve evropiane. Përmes këtij Objektivi Specifik është synuar përshpejtimi i procesit të përmbushjes së kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me Metodologjinë e re të Zgjerimit, përmes koordinimit efektiv të strukturave të përfshira në procesin e negociatave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 1.2 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 2 (dy) masa dhe 4 (katër) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 1.2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit.	
Masa 1.2.1	Kryerja dhe zbatimi efikas i procesit të planifikimit gjithëpërfshirës shumëvjeçar mbi integrimin evropian.
Aktiviteti 1.2.1.a	Miratimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian në baza periodike.
Aktiviteti 1.2.1.b	Miratimi i kuadrit rregullator për përgatitjen e versionit kombëtar të acquis-së së BE-së.
Masa 1.2.2	Përgatitja dhe zbatimi i programit për forcimin e kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian.
Aktiviteti 1.2.2.a	Hartimi dhe pilotimi i Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative.
Aktiviteti 1.2.2.b	Hartimi i planeve të ngritjes së kapaciteteve për të gjitha strukturat përkatëse.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 1.2. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, është intensifikuar cikli vendimmarrës duke u orientuar drejt zbatimit të angazhimeve dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2026, përmes aktivizimit të strukturave ekzistuese të qeverisjes së procesit. Në këtë kuadër, Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) mbeten boshti themelor për koordinimin teknik dhe politik të negociatave. Gjatë kësaj periudhe, 36 GNPIE-të kanë zhvilluar gjithsej 86 takime, me pjesëmarrjen aktive të 2203 anëtarëve.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 rezulton se Strukturat Negociuese, nën drejtimin e Sekretariatit të Integrimit Evropian në Kryeministri, kanë qënë produktive dhe kanë luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për arritjen e rezultateve të synuara lidhur me përgatitjet për procesin screening dhe hapjen e negociatave, si dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit dhe raportimit të MSA-së. Më specifikisht, janë zhvilluar 10 (dhjetë) takime të drejtorive/sekretariateve teknike të 36 GNPIE-ve (Rrjeti i Integrimit Evropian). Në këto takime janë trajtuar dhe konsultuar rreth 31 (tridhjetë e një) çështje/diskutime, lidhur me: që lidhen me prezantimin dhe miratimin e raporteve të performancës së Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) dhe të vlerësimit të kapaciteteve të integrimit evropian, planifikimin e masave për forcimin e kapaciteteve administrative, miratimin e Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për vitin 2026, prezantimin e programit të bashkërendimit ndërinstitucional Peer-to-Peer, përmirësimin e funksionimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), si dhe koordinimin e nismave për fuqizimin e dialogut me grupet e interesit dhe mbështetjen e procesit të integrimit evropian, etj.

Gjithashtu, është konsoliduar më tej mekanizmi i qeverisjes së integrimit evropian, me fokus të shtuar në forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve negociuese. Një zhvillim i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ishte miratimi i **Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative dhe Institucionale** për vitin 2026, i cili mbulon 33 kapitujt e negociatave dhe 3 kriteret. Ky Plan u miratua gjatë mbledhjes së Rrjetit për Integrimin Evropian (IE), më datë 2 mars 2026.

Plani Menaxherial i Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative dhe institucionale, për vitin 2026, për 33 kapitujt dhe 3 Kriteret, përmban në total 487 masa administrative dhe institucionale, specifikisht rreth 281 (57.70%) masa institucionale dhe 206 (42.30%) masa administrative të parashikuara për vitin 2026, si më poshtë:

Në lidhje me masat administrative:

- Volumin më të madh me rreth 16.02% të masave administrative planifikohen në GNPIE e Kapitullit 23 "*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*" me 33 masa administrative, GNPIE e Kapitullit 19 "*Politikat Sociale dhe të Punësimit*" me 32 (15.53%) masa administrative, GNPIE e "*Kriterit PAR*" me 23 (11.17%) masa administrative, GNPIE e Kapitulli 24 "*Drejtësia, Liria dhe Siguria*" me 15 (7.28%) masa administrative dhe GNPIE e Kapitullit

11 "*Bujqësia dhe Zhvillimi Rural*" me 14 (6.80%) masa administrative. Ndërsa pjesa tjetër kanë përqindje më të vogël.

- Nga totali i masave administrative, 37 masa (17.96%) lidhen me Piketat e Ndërmjetme dhe synojnë konsolidimin gradual të reformave në kuadër të procesit të integrimit evropian deri në vitin 2026 e më tej. Këto masa fokusohen kryesisht në forcimin e shtetit të së drejtës, luftën kundër korrupsionit, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të politikave publike. Ato përfshijnë gjithashtu përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional, forcimin e agjencive ligjzbatuese, rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit institucional, si dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet dhe acquis të BE-së në fusha si të drejtat e njeriut, drejtësia dhe siguria.
- Nga totali i masave administrative, 70 masa (33.98%) janë në zbatim të drejtpërdrejtë të rekomandimeve të Raportit të Progresit dhe fokusohen në forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, përmirësimin e politikëbërjes dhe procesit legjislativ, konsolidimin fiskal, si dhe avancimin e sistemeve statistikore dhe digjitale në përputhje me standardet e BE-së. Këto masa përfshijnë gjithashtu forcimin e sigurisë kibernetike, përmirësimin e cilësisë së të dhënave, rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative përmes trajnimeve dhe modernizimit institucional, me synim përmirësimin e koordinimit dhe performancës së administratës publike në procesin e integrimit evropian.
- Nga totali i masave administrative, 99 masa (48.06%) lidhen me zbatimin e Piketave Mbyllëse dhe fokusohen kryesisht në forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të institucioneve, përafrimin dhe zbatimin e acquis të BE-së, si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator në sektorë kyç si konkurrenca, tregu i brendshëm, bujqësia, siguria ushqimore, digjitalizimi, inovacioni dhe fondet e BE-së. Këto masa synojnë rritjen e efikasitetit institucional, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe avancimin e kapaciteteve për menaxhimin e politikave dhe programeve të integrimit evropian, përmes trajnimeve, ristrukturimeve institucionale dhe zhvillimit të sistemeve dhe platformave digjitale.

Në lidhje me masat institucionale:

- Nga totali i masave institucionale 281 (57.70%) janë masa në lidhen kryesisht me: ruajtjen dhe shtimin e burimeve të përshtatshme; infrastrukturës dhe niveleve të personelit; trajnime dhe përmirësimin e efikasitetit institucional; zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit; monitorimin dhe raportimin e rezultateve; forcimin e kapaciteteve të institucioneve për transparencë dhe llogaridhënie; përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial; përfshirjen e grupeve të interest; adresimin e aspekteve të barazisë gjinore dhe të mbrojtjes së të drejtave të pakicave; zhvillimin e kapaciteteve profesionale të personeli.
- Volumin më të madh me rreth 24.56% të masave institucionale planifikohen në GNPIE e Kapitullit 23 "*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*" me 69 masa institucionale, GNPIE

Kriteri "*Funksionimi i Institucioneve Demokratike*" me 22 (7.83%) masa institucionale, GNPIE e Kapitullit 24 "*Drejtësia, Liria dhe Siguria*" me 19 (6.76%) masa institucionale, GNPIE Kriteri "*Reforma në Administratën Publike*" me 18 (6.41%) masa institucionale dhe Kapitulli 19 "*Politikat Sociale dhe të Punësimit*" me 15 (5.34%) masa institucionale. Ndërsa, kapitujt e tjerë kanë përqindje më të vogël.

- Nga totali i masave institucionale, 105 masa (37.37%) janë të lidhura me zbatimin e drejtpërdrejtë të rekomandimeve të Raportit të Progresit dhe fokusohen në forcimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve demokratike, përmirësimin e kuadrit rregullator në përputhje me acquis të BE-së, si dhe rritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionale në funksion të procesit të integrimit evropian. Këto masa përfshijnë, ndër të tjera, përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike dhe financimit të OSHC-ve, forcimin e sistemit të konsultimit publik dhe Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, rritjen e kapaciteteve të administratës publike përmes trajnimeve të specializuara, si dhe avancimin e kuadrit ligjor në fusha si bujqësia, të drejtat e autorit dhe kontrolli i armëve të zjarrit.

Gjithashtu, ato përfshijnë masa për përmirësimin e sistemeve të hetimit dhe përdorimit të të dhënave shtetërore, forcimin e koordinimit ndërinstitucional në drejtësi dhe bashkëpunim gjyqësor, rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë publike, si dhe zhvillimin e sistemeve dixhitale dhe ndërvepruese si e-Visa, TIMS dhe e-Albania. Në të njëjtën kohë, këto masa adresojnë edhe modernizimin e politikave ekonomike dhe kërkimore, zhvillimin e infrastrukturës së transportit (TEN-T), si dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit, inspektimit dhe zbatimit të reformave në përputhje me standardet e BE-së.

Nga totali i masave institucionale 72 (25.62%) masa janë në zbatim të drejtëpërdrejtë të Piketave të Ndërmjetme që lidhen kryesisht me konsolidimin e reformës në drejtësi, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative të organeve të sistemit gjyqësor dhe të drejtësisë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatave dhe prokurorive, si dhe garantimin e pavarësisë dhe funksionimit efektiv të institucioneve të pavarura.

Nga totali i masave institucionale, 103 masa (36.65%) lidhen me "Piketat Mbyllëse" dhe fokusohen kryesisht në forcimin e shtetit të së drejtës, rritjen e kapaciteteve administrative dhe institucionale, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional, përafrimin e legjislacionit me acquis të BE-së, si dhe fuqizimin e strukturave zbatuese në fusha prioritare si konkurrenca, investimet, inovacioni, arsimi, bujqësia, shërbimet dixhitale dhe përfshirja e shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian.

Nga totali i masave institucionale 1 (0.36%) masa janë në lidhje me masa institucionale në zbatim të Incentivës "*Komitologjia*" që lidhen kryesisht me pjesëmarrje në organizata evropiane, si: Rritja e pjesëmarrjes direkte të ISHMT-së në organizatat evropiane të pronësisë intelektuale, për çështje që lidhen me zbatimin e të drejtave të PI-së, konkretisht në Observatorin e EUIPO-s dhe në platformën "*Intellectual Property Enforcement Portal (IPEP)*".

Monitorimi i Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative.

Në datë 28 maj 2026 është zhvilluar mbledhja e Rrjetit IE, në të cilin u aprovua Raporti Kombëtar i Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integrimit Evropian për 4-mujorin janar-prill 2026.Gjatë periudhës janar-prill 2026, mekanizmi i qeverisjes së integrimit evropian shënoi një fazë të re operacionalizimi, duke u konsoliduar si një pikë kthese në kalimin nga koordinimi i gjerë institucional drejt menaxhimit të fokusuar në rezultatet negociuese. Më konkretisht, gjatë periudhës raportuese u zhvilluan 5 takime të Grupit Negociator, 9 takime të Rrjetit të Integrimit Evropian dhe 86 mbledhje të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), me pjesëmarrjen e mbi 2203 anëtarëve.

Në 4-mujorin e parë të vitit 2026, Shqipëria ka vijuar të intensifikojë përpjekjet e saj në funksion të integrimit në Bashkimin Evropian (BE), përmes aktivizimit të strukturave ekzistuese të qeverisjes së procesit. Në këtë kuadër, Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) mbeten boshti themelor për koordinimin teknik dhe politik të negociatave.

Në vitin 2025, mekanizmi i integrimit evropian karakterizohet nga një bazë e konsoliduar funksionale, me 13 mbledhje të Grupit Negociator, 35 tematika strategjike, 287 takime GNPIE, 365 konkluzione teknike dhe 2,162 pjesëmarrës, duke reflektuar një model të koordinimit të gjerë dhe reagueshmëri të lartë institucionale (78.63%). Në këtë kuadër, 2025 përfaqëson një cikël ku sistemi optimizon koordinimin dhe prodhimin e vendimmarrjes, por ende me një hendek zbatimi prej 29.73%, duke treguar një distancë midis vendimmarrjes dhe implementimit. Në kontrast, 4-mujori i parë 2026 shfaq një rikonfigurim të qartë të kësaj balance, ku performanca e përgjithshme arrin në 69.57%, por me një përmirësim të ndjeshëm në rezultatet e zbatimit, ku indeksi i rezultateve rritet në 89.12% dhe hendeku i zbatimit reduktohet në 10.88%. Kjo zhvendosje tregon një progres strukturor: nga një sistem i orientuar drejt reagimit dhe koordinimit në 2025, drejt një sistemi të orientuar drejt ekzekutimit të masave dhe prodhimit të rezultateve në 4M 2026.

Në vitin 2025, struktura e vendimmarrjes ishte e shpërndarë në mënyrë të balancuar midis analizës, prioriteteve dhe pozicioneve negociuese, duke reflektuar një fazëndërtimi institucional të procesit. Në 4-mujorin e parë 2026, kjo strukturë riorientohet në mënyrë të qartë drejt fazës së avancuar të negociatave, ku 22.28% e aktivitetit lidhet me benchmark-et për mbylljen e kapitujve dhe 19.78% me përditësimin e prioriteteve të përafrimit. Ky ndryshim sinjalizon kalimin nga faza e “ndërtimit të arkitekturës negociuese" nëfazën e përgatitjes së drejtpërdrejtë për mbylljen e kapitujve dhe finalizimin e detyrimeve teknike.

Për periudhën janar-prill 2026, janë koordinuar rreth 145 konkluzione në 86 takime, duke reflektuar një intensifikim të ritmit të vendimmarrjes dhe një përqasje më funksionale ndaj prioriteteve të integrimit. Mekanizmi shënon një performancë të përgjithshme prej 69.57%, në terma të përqindjes së takimeve që kërkojnë vendimmarrje të ndjekshme. Indeksi i

Reagueshmërisë (IR) arrin në 59.31%, me mekanizmin e feedback-ut funksional në ndjekje të çështjeve prioritare dhe zbatimit të rekomandimeve të BE-së. Janë zhvilluar në total 86 takime teknike dhe koordinuese, me fokus të zgjeruar mbi Piketat/Benchmarks, përafrimin ligjor dhe përgatitjen për pozicionet negociuese.

Në aspektin e implementimit të masave të planifikuara, janë arritur 89.12% e masave të kërkuara gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2026. Ky është një tregues i rëndësishëm që sugjeron se, ndërsa janë bërë përparime të dukshme, ende ka nevojë për një përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur të gjitha objektivat e përcaktuara. Dallimi prej 10.88% tregon se ende ka një hendek midis planifikimit dhe realizimit të masave, që mund të lidhet me mungesën e burimeve mjaftueshme, vonesat në përgatitjen e dokumenteve, ose sfida të tjera që ndodhin gjatë procesit të implementimit.

Në zbatim të prioriteteve të "*Planit Kombëtar të kapaciteteve për integrimin evropian dhe anëtarësimin në BE 2026-2027*", Sekretariati i Integrimit Evropian pranë Kryeministrisë, në partneritet të ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), gjatë periudhës Janar-Prill 2026 ka zhvilluar programe të dedikuara trajnimi për strukturat e integrimit evropian. Ky bashkëpunim synon të rrisë kapacitetet administrative dhe teknike të anëtarëve të 36 Grupeve Ndërinstitucionale të Integrimit Evropian (GNPIE), duke garantuar zbatimin efektiv të Acquis të BE-së, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përshpejtimin e ritmit të negociatave drejt anëtarësimit në BE.

Paketa e trajnimeve është projektuar mbi analiza gjithëpërfshirëse për të forcuar njohuritë dhe kapacitetet, të lidhura drejtpërdrejt me nevojat dinamike të fazës së avancuar të negociatave. Tematikat janë strukturuar në harmoni me parimet e qeverisjes për Integrimin Evropian, duke adresuar jo vetëm harmonizimin e legjislacionit me Acquis të BE-së, por edhe aftësimin për analizën e impaktit, përgatitjen e pozicioneve negociuese, si dhe ndërveprimin ndërinstitucional për një dialog të qëndrueshëm dhe efektiv me aktorët e interesit. Ky modulim synon jo vetëm aftësimin teknik, por edhe ndërtimin e një narrative bashkëpunimi ndërinstitucional.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara për forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e integrimit evropian, janë ofruar katër module trajnimi, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 1,231 pjesëmarrës. Modulet e zhvilluara dhe numri i pjesëmarrësve për secilin prej tyre paraqiten si më poshtë:

- Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave - 15 pjesëmarrës;
- Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fonde - 345 pjesëmarrës;
- Përgatitja e planit të përkthimit të Acquis-it të BE-së, detyrimet ligjore dhe kërkesat e BE-së për përkthimin - 14 pjesëmarrës;
- Qeverisja për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE - 857 pjesëmarrës.

Në tërësi, zhvillimi i këtyre moduleve ka kontribuar në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike për përmbushjen e kërkesave dhe detyrimeve që lidhen me procesin e integrimit evropian.

Objektivi Specifik 1.2 konsiderohet në progres të mirë, bazuar në progresin e masave dhe aktiviteteve për periudhën janar-qershor 2026. Aktivitetet e mbetura për t'u realizuar, ndër të cilat finalizimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit me acquis-in e BE-së për periudhën 2026-2027, masat e të cilit janë strukturuar mbi bazën e planeve të punës dhe dokumenteve negociuese, si dhe finalizimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027, vijojnë të jenë në proces dhe parashikohet të përmbyllen në vijim. Përfundimi i këtyre proceseve do të kontribuojë në konsolidimin e mëtejshëm të mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe në sigurimin e një qasjeje më të integruar për përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Për këtë Objektivin Specifik 1.2, në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar dy tregues performance:

- 1.2.1 "*Niveli i zbatimit efikas të procesit të planifikimit gjithëpërfshirës për integrimin evropian*";
- 1.2.2 "*Indeksi i rritjes së kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve për Objektivin Specifik 1.2 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
1.2.1 Niveli i zbatimit efikas të procesit të planifikimit gjithëpërfshirës për integrimin evropian.	N/A	100%	60%	60%
1.2.2 Indeksi i rritjes së kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian.	100%	100%	61%	61%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.2[25]				**61%**

[25] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.2 "*Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 61%.[26]

Treguesi 1.2.1 "*Niveli i zbatimit efikas të procesit të planifikimit gjithëpërfshirës për integrimin evropian*", ka si qëllim të vlerësojë nivelin e realizimit të aktiviteteve të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Për çdo periudhë raportuese treguesi mat normën e realizueshmërisë të aktiviteteve të planifikuara në PKIE për vitin raportues, duke synuar që çdo vit të arrihet realizimi i plotë i PKIE. Për këtë qëllim, Departamenti i Politikave dhe Integrimit në BE pranë Kryeministrisë do të mbledhë dhe analizojnë të dhëna në lidhje me realizueshmërisë e PKIE. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.2.1, për vitin 2026, është 100%.

Gjatë vitit 2026, në kuadër të planifikimit të Agjendës Evropiane dhe bazuar në planet e punës së institucioneve, janë planifikuar gjithsej 521 akte. Për gjashtëmujorin e parë ishin planifikuar 158 akte, prej të cilave janë miratuar 82, ose 51,9% e planit të kësaj periudhe. Gjithashtu, janë miratuar para afatit 10 akte të planifikuara për tremujorin e tretë ose të katërt. Për rrjedhojë, gjatë gjashtëmujorit të parë janë miratuar gjithsej 92 akte, të cilat përbëjnë 17,7% të planit vjetor.

Treguesi 1.2.2 "*Indeksi i rritjes së kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian*", ka si qëllim të forcojë kapacitetet dhe aftësitë e strukturave negociuese për të përmbushur kërkesat e procesit të integrimit evropian. Për këtë qëllim, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), në bashkëpunim me strukturat për çështjet e integrimit evropian në Kryeministri do të hartojnë planet e ngritjes së kapaciteteve, bazuar në nevojat për trajnim për të gjitha strukturat përkatëse. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.2.2, për vitin 2026, është "100%".

Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar zhvillime të rëndësishme në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, të cilat janë shoqëruar me zhvillimin e aktiviteteve periodike trajnuese. Këto aktivitete kanë synuar rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të strukturave përgjegjëse, si dhe përmirësimin gradual të njohurive dhe aftësive të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian. Realizimi i treguesit 1.2.2 (Indeksi i rritjes së kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian) është në nivelin 61%, duke reflektuar një nivel mbi mesatare realizimi dhe progres të qëndrueshëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative dhe zhvillimit të aftësive për procesin e integrimit evropian. Ky rezultat i referohet periudhës së parë 4-mujore të vitit 2026 dhe, duke pasur parasysh vijimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit, pritet një rritje progresive e nivelit të realizimit deri në fund të vitit 2026.

[26] Për detaje të mëtejshme lidhur me metodologjinë e monitorimit, burimin e të dhënave dhe metodën e llogaritjes së treguesve, referoju Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale për integrimin evropian, gjatë periudhës në vijim parashikohet ndërmarrja e këtyre hapave:

- Vijimi i monitorimit periodik katërmujor të zbatimit të Planit Kombëtar të Kapaciteteve për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE 2026-2027.
- Rishikimi dhe përditësimi i paketës së "*Hartëzimit të kërkesave institucionale*" për aderimin dhe përfshirjen në "*Iniciativën e Komitologjisë*" së BE-së, proces i cili do të iniciohet gjatë katërmujorit III të vitit 2026.

Objektivi Specifik 1.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare

Ky Objektiv Specifik synon të garantojë një proces gjithëpërfshirës të hartimit të politikave dhe legjislacionit, duke përdorur metoda të bazuara në të dhëna, i cili garanton përputhshmëri me *acquis*-në dhe standardet evropiane. Masat e parashikuara për zbatimin e këtij Objektivi Specifik adresojnë përafrimin ligjor dhe metodologjik me acquis-në dhe standardet e BE-së, rritjen e kapaciteteve administrative për përgatitjen dhe monitorimin e raporteve RIA, si dhe përmirësimin e konsultimit publik si një proces efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 1.3 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 9 (dy) masa dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 1.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare.	
Masa 1.3.2	Përmirësimi i përputhshmërisë së politikave të propozuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve me politikat e përgjithshme dhe prioritetet qeveritare.
Aktiviteti 1.3.2.a	Zbatimi i një mekanizmi periodik monitorimi dhe raportimi, për të evidentuar aktet e miratuara brenda Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) dhe akteve të miratuara jashtë PPAP, si dhe analizimi i shkaqeve të mospërputhjeve.
Aktiviteti 1.3.2.c	Zbatimi i një procedure standarde për regjistrimin e akteve të PPAP që nuk arrijnë të realizohen brenda vitit kalendarik, si dhe raportimi periodik mbi arsyet e shtyrjes.
Masa 1.3.3	Mbështetja në praktika të mira ndërkombëtare dhe përafrimi efikas me acquis-në dhe standardet evropiane përgjatë përgatitjes së nismave të reja ligjore dhe politike.

Aktiviteti 1.3.3.a	Krijimi i një mekanizmi të monitorimit të rregullt për të vlerësuar trendin e referencave në raportet RIA dhe përputhjen e tyre me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.
Aktiviteti 1.3.3.b	Krijimi i një mekanizmi të monitorimit të rregullt për të vlerësuar trendin akteve që shoqërohen me tabelat e përputhshmërise dhe versionin e përkthyer të acquis-së që transpozohet.
Masa 1.3.4	Përmirësimi i cilësisë së kryerjes dhe monitorimit të procesit RIA, përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve në Kryeministri dhe institucionet përkatëse.
Aktiviteti 1.3.4.b	Hartimi i një plani trajnimesh për procesin RIA dhe organizimi i seancave periodike trajnuese për nëpunësit publikë të përfshirë në këtë proces.
Masa 1.3.5	Zgjerimi i procesit RIA tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit dhe plotësimit të kuadrit normativ, si dhe zbatimit të tij në praktikë.
Aktiviteti 1.3.5.f	Zbatimi i fazës pilot për përgatitjen e raporteve RIA mbi aktet e legjislacionit dytësor në ministritë e përzgjedhura.
Masa 1.3.6	Harmonizimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator me procesin e konsultimit publik.
Aktiviteti 1.3.6.b	Përfshirja në modulet e trajnimit, mbi procesin RIA, të seancave trajnuese për integrimin e rezultateve të procesit të konsultimit publik në raportet RIA.
Aktiviteti 1.3.6.c	Nxitja e publikimit të draft raporteve RIA në RENJKP me qëllim mbledhjen e kontributeve nga grupet e interesit për përmirësimin e saj.
Aktiviteti 1.3.6.d	Zbatimi i mekanizmave të koordinimit ndërmjet proceseve RIA dhe të Konsultimit Publik.
Masa 1.3.7	Përmirësimi cilësor dhe sasior i procesit të konsultimit publik, përmes rritjes së numrit të akteve që konsultohen, si dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proces.
Aktiviteti 1.3.7.a	"1. Përdorimi i RENJKP (Regjistrit Elektronik Kombëtar për Konsultimin Publik), duke respektuar afatet e publikimit. 2. Mirëplanifikimi i Planit Vjetor të Konsultimit Publik nga institucionet e qeverisjes qendrore në koordinim të ngushtë me strukturën përgjegjëse në Kryeministri. 3. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të procesit të konsultimit publik nga struktura përgjegjëse në KM, përmes përgatitjes së raporteve të rregullta të performancës, që identifikojnë dobësitë dhe sugjerojnë përmirësime. 4. Hartimi i raporteve të detajuara për çdo akt që i nënshtrohet procesit të konsultim publik, të cilat përfshijnë një përmbledhje të komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e marra nga qytetarët dhe palët e interesuara.

	5. Publikimi i raporteve në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik."
Aktiviteti 1.3.7.b	Organizimi i seancave trajnuese për zbatimin e procesit të konsultimit publik.
Masa 1.3.8	Zgjerimi i procesit të konsultimit publik tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik.
Aktiviteti 1.3.8.d	Përzgjedhja e 15 projektakteve, të legjislacionit dytësor, me interes publik dhe përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Konsultimit Publik.
Masa 1.3.9	Rritja e pjesëmarrjes qytetare në procesin e konsultimit publik.
Aktiviteti 1.3.9.a	Aplikimi i një sistemi njoftimi automatik për të informuar qytetarët dhe grupet e interesit për nismat e reja që publikohen për konsultim publik.
Aktiviteti 1.3.9.b	Përdorimi i metodave alternative (webinare, takime publike, anketa online) për të rritur pjesëmarrjen qytetare në procesin e konsultimit.
Aktiviteti 1.3.9.c	Aplikimi i një sistemi njoftimi paraprak për të informuar qytetarët dhe grupet e interesit për nismat e reja që do të publikohen për konsultim publik.
Masa 1.3.11	Rritja e transparencës së agjendës vendimmarrëse të qeverisjes qendrore.
Aktiviteti 1.3.11.a	Publikimi i rregullt i raporteve të monitorimit të zbatimit të Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale.
Aktiviteti 1.3.11.b	Publikimi i rregullt i raporteve të monitorimit të zbatimit të PKIE.
Aktiviteti 1.3.11.c	Publikimi i rregullt i urdhrave ministrorë të karakterit normativ në Fletoren Zyrtare.
Aktiviteti 1.3.11.d	Mundësimi i kërkimit të akteve ligjore në faqen e QBZ-së sipas datës së hyrjes së tyre në fuqi.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 1.3. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në zbatim të masës 1.3.2 "*Përmirësimi i përputhshmërisë së politikave të propozuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve me politikat e përgjithshme dhe prioritetet qeveritare*", Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit (DMZ) të PPAP, e cila funksionon si njësi qendrore koordinuese dhe mbikëqyrëse brenda strukturës së Kryeministrisë, me rol kryesor ruajtjen e disiplinës dhe parashikueshmërisë së PPAP, kryen monitorime me peridocitet javor. Në këtë kuadër, ajo kryen monitorim të rregullt të zbatimit PPAP duke përditësuar në kohë reale databazën qendrore me të gjitha aktet normative: ato të parashikuara dhe të realizuara brenda PPAP, si dhe ato të miratuara jashtë tij. Ky proces periodik lejon identifikimin e shpejtë të devijimeve, evidentimin e akteve të reja emergjente apo të shtyra, dhe përgatitjen e raporteve.

Gjithashtu, procedura standarde për regjistrimin e akteve normative të PPAP që nuk realizohen brenda vitit kalendarik, parashikon një mekanizëm të detyrueshëm për të gjitha institucionet përkatëse. Në fund të çdo viti kalendarik, ministritë dhe agjencitë raportojnë për arsyet e mosarritjes së objektivave të planifikuara, duke përfshirë faktorë si vonesat, mosmarrëveshjet ndërinstitucionale ose ndryshimet e prioriteteve. Aktet e parealizuara regjistrohen dhe dakordësohet nëse ato do të shtyhen për vitin pasardhës, duke u integruar në PPAP-në e re, apo do të hiqen plotësisht nga plani, me qëllim ruajtjen e harmonizimit me prioritetet strategjike qeveritare dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Në zbatim të masës 1.3.3 "*Mbështetja në praktika të mira ndërkombëtare dhe përafrimi efikas me acquis-në dhe standardet evropiane përgjatë përgatitjes së nismave të reja ligjore dhe politike*", gjatë vitit 2025 Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri ka konceptuar një databazë e cila ka shërbyer edhe per periudhen 1 janar-23 korrik 2026 si një mekanizëm për monitorimin e rregullt dhe të vazhdueshëm, për përdorimin e referencave në raportet RIA me qëllim arritjen e standardeve më të mira Evropiane dhe ndërkombëtare në këtë drejtim. Gjatë këtij monitorimi janë evidentuar raste në të cilat institucionet hartuese të raportit të vlerësimit të ndikimit (RIA) nuk kanë përdorur referenca në praktikën më të mirë Evropiane apo ndërkombëtare, edhe pse këto praktika ekzistonin dhe ishin të aksesueshme. Për këtë qëllim, anëtarët e Drejtorisë RIA dhe të Konsultimit Publik, përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së raporteve RIA në këtë Njësi, udhëheqin një proces koordinues me institucionet duke bërë të mundur përdorimin e referencave të sakta, në mënyrë të qartë. Ky proces ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë, jo vetëm të raportit RIA, por edhe të analizës së ndikimit për nismën.

Pavarësisht progresit të evidentuar gjatë periudhës raportuese, Departamenti i Politikës dhe Integrimit Evropian në Kryeministri duhet të vijojë punën për krijimin dhe konsolidimin e një mekanizmi të rregullt monitorimi, me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin periodik të trendit të akteve ligjore që shoqërohen me tabelat e përputhshmërisë, si dhe versionin e përkthyer të acquis-së që transpozohet. Krijimi i këtij mekanizmi do të mundësojë evidentimin në kohë të progresit, mangësive dhe nevojave për ndërhyrje, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së procesit të përafrimit të legjislacionit me acquis-në e BE-së.

Në zbatim të masës 1.3.4 "*Përmirësimi i cilësisë së kryerjes dhe monitorimit të procesit RIA, përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve në Kryeministri dhe institucionet përkatëse*", gjatw periudhës 29 prill-7 maj 2026, ASPA ka zhvilluar nje kurs online me certifikim me teme: Vlerësimi i impaktit rregullator (RIA) ku kanë marrë pjesë 25 pjesëmarrës dhe janë kualifikuar 14 pjesëmarrës. Gjithashtu, Njësia zhvillon trajnime praktike dhe sipas kërkesës, me rrjetin e koordinatorëve RIA në ministritë e linjës, si dhe me nëpunës të rinj që i shtohen këtij rrjeti. Këto trajnime janë në varësi të kërkesës së tyre, në varësi të vlerësimit tonë mbi nevojën për zhvillimin e trajnimeve për anëtarët e rrjetit, ose të një nisme specifike mbi të cilën kërkohet përgatitja e një raporti RIA. Në bashkëpunim me OECD/SIGMA janë zhvilluar edhe disa seanca trajnuese për zbatimin e procesit RIA për projektvendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të procesit pilot. Një seancë tjetër trajnuese është parashikuar të zhvillohet gjatë muajit shtator 2026.

Në zbatim të masës 1.3.5 "*Zgjerimi i procesit RIA tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit dhe plotësimit të kuadrit normativ, si dhe zbatimit të tij në praktikë*", gjatë muajit mars 2026, janë përzgjedhur 6 (gjashtë) ministri për t'u përfshirë në fazën pilot të procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), për aktet e legjislacionit dytësor që do t'i nënshtrohen këtij procesi. Ministritë e përzgjedhura janë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

Në kuadër të përgatitjes së udhëzimeve për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) për aktet e përzgjedhura në fazën pilot, bazuar në rekomandimet e ekspertëve të OECD/SIGMA, është konstatuar se metodologjia aktuale e RIA-s mund të zbatohet edhe për hartimin e raporteve RIA për akte të legjislacionit dytësor me interes të lartë publik. Ky qëndrim vijon të mbetet i vlefshëm. Në kuadër të fazës pilot, ministrive pjesëmarrëse u janë ofruar udhëzime mbështetëse lidhur me kriteret për përzgjedhjen e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave që do t'i nënshtrohen procesit të RIA-s, duke filluar nga viti 2027, si dhe lidhur me metodologjinë dhe mënyrën e përgatitjes së raporteve RIA për projektvendimet e Këshillit të Ministrave të përfshira në fazën pilot. Këto udhëzime synojnë të sigurojnë një zbatim të njëtrajtshëm të metodologjisë së RIA-s dhe forcimin gradual të kapaciteteve të ministrive pjesëmarrëse në këtë proces.

Në kuadër të fillimit dhe zbatimit të fazës pilot të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), gjatë periudhës së raportimit janë zhvilluar një sërë aktivitetesh informuese dhe trajnuese, me synim orientimin dhe mbështetjen e institucioneve pjesëmarrëse në përgatitjen e raporteve RIA.

Më 2 prill 2026, u zhvillua një webinar informues, me pjesëmarrjen e të gjitha ministrive të linjës, ku u prezantua fillimi i fazës pilot dhe u ofruan orientime të përgjithshme mbi procesin. Më tej, më 23 prill 2026, në bashkëpunim me OECD/SIGMA, u zhvillua një workshop me pjesëmarrje fizike, me përfaqësuesit e 6 (gjashtë) ministrive të përfshira në fazën pilot. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan në mënyrë të detajuar hapat dhe udhëzimet teknike për përgatitjen e raporteve RIA për projektvendimet e Këshillit të Ministrave të përzgjedhura për fazën pilot, në total 7 (shtatë) projektvendime.

Gjatë muajve maj dhe qershor 2026, deri më 11 qershor 2026, janë zhvilluar një sërë takimesh dhe trajnimesh praktike ndërmjet Drejtorisë RIA dhe ministrive pjesëmarrëse në fazën pilot. Këto aktivitete kanë synuar ofrimin e asistencës teknike dhe adresimin e çështjeve konkrete të identifikuara gjatë procesit të hartimit të raporteve RIA për projektvendimet e përzgjedhura.

Pas përzgjedhjes së akteve që do t'i nënshtrohen fazës pilot dhe identifikimit të ministrive përgjegjëse, ka nisur procesi i përgatitjes së raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) nga institucionet propozuese për projektaktet e legjislacionit dytësor, konkretisht projektvendimet

e Këshillit të Ministrave (VKM), të përfshira në këtë fazë. Procesi synon testimin praktik të zbatimit të metodologjisë së RIA-s në hartimin e akteve nënligjore, si dhe identifikimin e nevojave për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e saj.

Në zbatim të masës 1.3.6 "*Harmonizimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator me procesin e konsultimit publik*", më 27 janar 2026, Njësia, nëpërmjet Drejtorisë RIA dhe Konsultimit Publik, organizoi një takim online me rrjetin e koordinatorëve të konsultimit publik në ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë. Takimi kishte për qëllim forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe adresimin e çështjeve me rëndësi për zhvillimin e proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) dhe konsultimit publik. Gjatë takimit u trajtuan, ndër të tjera, çështjet që lidhen me:

- rëndësinë e zhvillimit të një procesi konsultimi publik transparent, gjithëpërfshirës dhe efektiv;
- përgatitjen e Planit Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2026;
- përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian, në lidhje me proceset RIA dhe konsultimin publik;
- harmonizimin dhe ndërlidhjen e procesit të konsultimit publik me procesin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA);
- problematikat dhe vështirësitë e evidentuara gjatë përgatitjes **së** Raportit Vjetor të Konsultimit Publik 2025 dhe Planit Vjetor të Konsultimit Publik 2026.

Takimi kontribuoi në shkëmbimin e praktikave dhe në identifikimin e çështjeve që kërkojnë koordinim dhe mbështetje të mëtejshme ndërinstitucionale, me synim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të proceseve të konsultimit publik dhe RIA-s.

Gjatë periudhës raportuese, Njësia ka vijuar të ndërmarrë masa për nxitjen e ministrive të linjës dhe institucioneve propozuese për publikimin në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP), jo vetëm të projektakteve, por edhe të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), si në fazën fillestare ashtu edhe pas konfirmimit të tyre.

Në këtë kuadër, pas çdo vlerësimi të kryer, Njësia RIA i ka rekomanduar institucionit propozues publikimin e raportit përkatës në të njëjtën rubrikë të RENJKP-së ku është publikuar projektakti. Kjo praktikë synon rritjen e transparencës së procesit vendimmarrës, si dhe krijimin e mundësive për marrjen e komenteve dhe kontributeve nga grupet e interesit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së analizës dhe të procesit rregullator.

Si rezultat, gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe publikuar në RENJKP raportet e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) për 40 projektligje/akte, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe aksesit publik ndaj informacionit që shoqëron procesin e hartimit dhe miratimit të akteve.

Për zbatimin e mekanizmave të koordinimit ndërmjet proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) dhe Konsultimit Publik, Njësia RIA ka vijuar të theksojë, gjatë komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet propozuese, rëndësinë e zhvillimit të koordinuar, paralel dhe të ndërlidhur të këtyre dy proceseve. Në kuadër të vlerësimit të raporteve RIA, ministrive dhe institucioneve propozuese u është rekomanduar që gjetjet, të dhënat dhe kontributet e mbledhura gjatë procesit të konsultimit publik të reflektohen në analizën e problemit, vlerësimin e ndikimeve dhe analizën e opsioneve të politikave.

Njëkohësisht, Njësia RIA ka nxitur publikimin e raporteve RIA në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP), së bashku me dokumentet dhe projektaktet përkatëse. Publikimi i raportit RIA në të njëjtën rubrikë të RENJKP-së ku publikohet dokumenti konsultativ dhe, më pas, projektakti për konsultim, krijon mundësi për një pjesëmarrje më të informuar të grupeve të interesit në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Nëpërmjet këtij mekanizmi, palët e interesuara kanë mundësi të japin kontribut jo vetëm mbi nismën në tërësi, por edhe mbi elementet kryesore të analizës RIA, duke kontribuar në identifikimin dhe evidentimin e problemit, shkaqeve dhe pasojave të tij, si dhe në vlerësimin e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative, direkte dhe indirekte, financiare, ekonomike, sociale dhe mjedisore për grupet e prekura. Përfshirja e këtyre kontributeve synon të sigurojë që ndërhyrjet rregullatore të bazohen në të dhëna dhe evidenca, të adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë problemet e identifikuara dhe të minimizojnë krijimin e barrës administrative apo financiare të panevojshme për grupet e prekura.

Gjithashtu, në rubrikën përkatëse të raportit RIA, hartuesit duhet të paraqesin informacion të qartë dhe të detajuar mbi mënyrën e zhvillimit të procesit të konsultimit publik, kontributet dhe komentet e mbledhura, si dhe mënyrën se si këto kontribute janë marrë në konsideratë dhe kanë ndikuar në formulimin dhe përmirësimin e politikës së propozuar. Kjo qasje synon të forcojë lidhjen funksionale ndërmjet RIA-s dhe konsultimit publik, duke rritur transparencën, cilësinë e analizës dhe bazën e evidencës mbi të cilën mbështeten vendimmarrjet rregullatore.

Në zbatim të masës 1.3.7 "*Përmirësimi cilësor dhe sasior i procesit të konsultimit publik, përmes rritjes së numrit të akteve që konsultohen, si dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proces*", janë kryer veprimet e mëposhtme:

- Gjatë periudhës janar–qershor 2026, janë konsultuar 41 akte që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*". Nga këto, 39 akte janë konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP), duke rezultuar në një indeks përdorimi të regjistrit prej 95% për periudhën e raportimit. Për të gjitha aktet e konsultuara janë respektuar afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke evidentuar respektimin e kërkesave procedurale dhe vijimin e zbatimit të standardeve të transparencës dhe konsultimit publik në procesin e hartimit të akteve.

- Më 27 janar 2026, Njësia, nëpërmjet Drejtorisë RIA dhe Konsultimit Publik, organizoi një takim online me rrjetin e koordinatorëve të konsultimit publik në ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë. Takimi synoi forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe adresimin e çështjeve me rëndësi për zbatimin e proceseve të Konsultimit Publik dhe Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA). Gjatë takimit u trajtuan çështje që lidhen me rëndësinë e zhvillimit të një procesi konsultimi publik transparent dhe gjithëpërfshirës, përgatitjen e Planeve Vjetore të Konsultimit Publik për vitin 2026, përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian, si dhe harmonizimin e procesit të konsultimit publik me procesin e RIA-s. Gjithashtu, u diskutuan pengesat dhe vështirësitë e evidentuara gjatë përgatitjes së Raportit Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2025 dhe Planit Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2026.

  Në vijim të këtij procesi koordinues, Planet Vjetore të Konsultimit Publik për vitin 2026 janë publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP) gjatë javës së parë të muajit shkurt 2026, në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik nga organet e qeverisjes qendrore. Publikimi në afatin e përcaktuar kontribuon në rritjen e parashikueshmërisë dhe transparencës së procesit të konsultimit publik dhe u mundëson grupeve të interesit të njihen në kohë me nismat e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2026.

- Gjatë periudhës janar-23 korrik 2026, Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik, si strukturë përgjegjëse, ka vijuar koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të procesit të konsultimit publik nga ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të Kryeministrit. Në kuadër të këtij procesi, janë përgatitur në mënyrë periodike raportet javore të monitorimit, të cilat janë prezantuar dhe diskutuar në mbledhjet javore të Sekretarëve të Përgjithshëm, duke mundësuar ndjekjen e vazhdueshme të ecurisë së procesit dhe evidentimin në kohë të problematikave. Në përputhje me përcaktimet e Udhëzuesit për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik, gjatë muajit qershor 2026, ministritë e linjës duhet të përgatisin raportet gjashtëmujore të konsultimit publik për periudhën janar-qershor 2026. Mbi bazën e informacionit të përcjellë nga institucionet, Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik përgatit dhe publikon "*Raportin Gjashtëmujor të Performancës së Konsultimit Publik*", gjatë muajit korrik 2026.

- Për 41 aktet e miratuara dhe të konsultuara gjatë periudhës janar-23 korrik 2026, janë përgatitur raportet individuale të konsultimit publik. Raportet, pas shqyrtimit dhe konfirmimit nga struktura përgjegjëse, në këtë rast Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik, pjesë e Njësisë së Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, janë publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik (RENJKP). Në përfundim, për periudhën e raportimit është arritur një indeks prej 100% për përgatitjen dhe publikimin e

raporteve individuale të konsultimit publik, duke evidentuar përmbushjen e plotë të kërkesës për dokumentimin dhe transparencën e procesit të konsultimit publik.

Gjithashtu, në zbatim të kësaj mase, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e zbatimit të procesit të konsultimit publik, gjatë muajit prill 2026, ASPA organizoi një trajnim mbi procesin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA). Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan edhe mënyrat e harmonizimit dhe ndërlidhjes së procesit të RIA-s me procesin e konsultimit publik, me fokus në aspektet kryesore të mbarëvajtjes dhe zbatimit efektiv të procesit të konsultimit publik.

Njëkohësisht, gjatë periudhës raportuese, Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik ka zhvilluar takime të dedikuara me koordinatorët e konsultimit publik në ministritë e linjës, me qëllim ofrimin e asistencës teknike, orientimeve dhe sqarimeve konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara dhe përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të procesit të konsultimit publik. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve të koordinatorëve dhe në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit të konsultimit publik.

Në zbatim të masës 1.3.8 "*Zgjerimi i procesit të konsultimit publik tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik*", gjatë vitit 2025 dhe muajit janar 2026, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, ka vijuar procesin e koordinimit, monitorimit dhe verifikimit të cilësisë së zbatimit të procesit të Konsultimit Publik, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi dhe garantimin e zbatimit të standardeve të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Në këtë kuadër, institucionet propozuese janë orientuar dhe ndërgjegjësuar në mënyrë të vazhdueshme për rëndësinë e zhvillimit të një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe efektiv të konsultimit publik, përfshirë edhe projektvendimet me interes të lartë publik, në rastet kur ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët ose grupe të caktuara interesi.

Në kuadër të përgatitjes së "*Planit Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2026*", Njësia ka përgatitur një listë të projektakteve të propozuara për konsultim, bazuar në "*Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026*". Në këtë listë janë përfshirë edhe projektvendime të cilat, për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë që mund të kenë mbi qytetarët ose grupe të caktuara interesi, janë vlerësuar si të përshtatshme për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik.

Ky vlerësim është kryer në përputhje me nenin 1 të ligjit nr. 146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*", si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian dhe OECD/SIGMA për zhvillimin e një procesi politikëbërës transparent, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt përfshirjes së aktorëve të interesuar.

Në zbatim të masës 1.3.9 "*Rritja e pjesëmarrjes qytetare në procesin e konsultimit publik*", me qëllim rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin e konsultimit publik, është aplikuar sistemi i njoftimit automatik, i cili mundëson informimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit për nismat e reja të publikuara për konsultim publik. Ky mekanizëm është funksional që

prej vitit 2023 dhe vijon të përdoret në mënyrë të rregullt për dërgimin e njoftimeve pranë qytetarëve dhe grupeve të interesit të regjistruara, duke lehtësuar aksesin në informacion dhe mundësinë e pjesëmarrjes në proceset e konsultimit publik.

Në kuadër të aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes qytetare në procesin e konsultimit publik, gjatë periudhës 1 janar-23 korrik 2026, janë përdorur edhe metoda alternative të konsultimit, krahas publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP). Nga 41 aktet e miratuara dhe të konsultuara gjatë kësaj periudhe, për 16 akte janë përdorur metoda alternative konsultimi, përfshirë takime publike, tryeza konsultative dhe forma të tjera të ndërveprimit me grupet e interesit. Përdorimi i këtyre metodave ka synuar zgjerimin e mundësive për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e konsultimit publik. Për periudhën e raportimit, indeksi i organizimit të takimeve publike rezulton 39%, duke reflektuar përdorimin e metodave alternative në 16 nga 41 aktet e konsultuara.

Gjatë periudhës së raportimit, në 39% të rasteve, publikimi i nismave në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP) është paraprirë nga organizimi i tryezave konsultative me grupet e interesit. Në këto raste, palët e interesuara janë informuar paraprakisht mbi nismën dhe procesin e pritshëm të konsultimit të projektaktit. Megjithatë, përdorimi i këtij mekanizmi nuk është aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha nismat e konsultuara gjatë periudhës së raportimit. Për këtë arsye, vijimi i zbatimit të masës kërkon zgjerimin e praktikës së njoftimit paraprak dhe përdorimin më sistematik të mekanizmave të informimit të qytetarëve dhe grupeve të interesit përpara publikimit të nismave për konsultim publik.

Në zbatim të masës 1.3.11 "*Rritja e transparencës së agjendës vendimmarrëse të qeverisjes qëndrore*", një pjesë e konsiderueshme e raporteve të monitorimit të Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale janë publikuar në faqet zyrtare të institucioneve përgjegjëse. Publikimi i raporteve të monitorimit vijon të jetë përgjegjësi e institucioneve përkatëse, ndërsa SASPAC, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), vijon të kryejë procesin e shqyrtimit dhe validimit të draft-raporteve të monitorimit, me qëllim garantimin e cilësisë dhe konsistencës së raportimit.

Gjatë periudhës së raportimit, SASPAC ka dhënë mendimin institucional për "*Raportin e Monitorimit për vitin 2025 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030*", si dhe për "*Raportin e Monitorimit për vitin 2025 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2025-2030*".

Në tërësi, vijimi i publikimit të raporteve të monitorimit nga institucionet përgjegjëse, së bashku me procesin e validimit të tyre nga SASPAC, kontribuon në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së monitorimit të zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ) ka vijuar garantimin e publikimit të rregullt të akteve normative, në Fletoren Zyrtare, në përputhje me kërkesat e

legjislacionit në fuqi. Gjatë kësaj periudhe janë botuar 137 numra të Fletores Zyrtare, me një total prej 1,896 aktesh, në format të printuar dhe elektronik.

Në zbatim të ligjit nr. 78/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare*", i cili përcakton afatin 10-ditor për botimin e Fletores Zyrtare dhe Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, publikimi i akteve është realizuar me afate të përshpejtuara, duke mundësuar hyrjen në fuqi të akteve brenda afateve përkatëse dhe garantimin e së drejtës së publikut për informim. Gjithashtu, gjatë muajit janar 2026 është realizuar botimi i publikuar indeksit të Fletores Zyrtare për vitin 2025.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, QBZ ka realizuar botimin elektronik të 16 numrave të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, me një total prej 26 aktesh dhe 128 faqe. Të gjitha aktet janë botuar brenda afatit 10-ditor, të përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 78/2014, duke evidentuar respektimin e afatit ligjor të publikimit.

Në kuadër të mirëmbajtjes dhe përditësimit të bazës elektronike të legjislacionit, gjatë periudhës janar-qershor 2026, QBZ ka publikuar në format elektronik 1,896 akte të botueshme. Gjithashtu, janë përditësuar 928 akte, përfshirë ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime të ministrave, si dhe akte të tjera. Pas përfundimit të procesit të përditësimit, versionet e përditësuara të akteve janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit, duke lehtësuar aksesin e publikut në legjislacionin e konsoliduar.

Gjatë periudhës së raportimit, QBZ ka realizuar 3 tituj botimesh, konkretisht: "*Kodi Penal*", "*Përmbledhëse e Vendimeve të Gjykatës së Lartë*" dhe "*Përmbledhëse e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë 2024–2025*". Titujt e tjerë të planifikuar për botim vijojnë të jenë në proces përgatitjeje.

Në tërësi, veprimtaria e realizuar gjatë periudhës janar-qershor 2026 evidenton vijimin e publikimit në kohë të akteve normative dhe të njoftimeve zyrtare, përditësimin e legjislacionit në format elektronik dhe rritjen e aksesit të publikut në informacionin zyrtar dhe legjislativ.

Për këtë Objektivin Specifik 1.3 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar 9 (nëntë) tregues performance. Të monitorueshëm për këtë periudhë raportimi janë 6 (gjashtë) tregues performance, si më poshtë:[27]

- 1.3.1 "*Përmirësimi cilësor i procesit të programimit rregullator*".
- 1.3.4 "*Përqindja e ligjeve që i plotësojnë kriteret, të shoqëruara nga raporte RIA*".
- 1.3.6 "*Përqindja e draft-raporteve RIA të publikuara në RENJKP përpara finalizimit*".
- 1.3.7 "*Përmirësimi i cilësisë së procesit të konsultimit publik*".
- 1.3.8 "*Numri i akteve të legjislacionit dytësor, me interes të lartë publik, të konsultuara*".

[27] Për detaje të mëtejshme, referoju Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

- 1.3.9 "*Rritja e kapaciteteve analitike në institucionet qendrore lidhur me proceset RIA dhe të konsultimit publik*".

Treguesit në kuadër të Objektivit 1.3 synojnë të matin në mënyrë të integruar përmirësimin e cilësisë së procesit të programimit dhe hartimit të legjislacionit, duke u fokusuar në forcimin e analizës së ndikimit rregullator (RIA), rritjen e transparencës dhe efektivitetit të konsultimit publik, si dhe në përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Këta tregues vlerësojnë:

- cilësinë dhe realizimin e procesit të programimit rregullator (përmes PPAP);
- nivelin e zbatimit të analizës së ndikimit rregullator (RIA) në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore;
- shkallën e transparencës dhe përfshirjes së publikut në procesin vendimmarrës;
- zhvillimin e kapaciteteve analitike të administratës publike në këto procese;

duke siguruar që procesi legjislativ të jetë më cilësor, i bazuar në evidencë, transparent dhe gjithëpërfshirës, në përputhje me standardet e mira të qeverisjes dhe kërkesat e integrimit evropian.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 1.3 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
1.3.1 Përmirësimi cilësor i procesit të programimit rregullator".	72%	78%	67%	86%
1.3.4 Përqindja e ligjeve që i plotësojnë kriteret, të shoqëruara nga raporte RIA.	92%	100%	100%	100%
1.3.6 Përqindja e draft-raporteve RIA të publikuara në RENJKP përpara finalizimit.	0%	50% e draft-raporteve RIA të publikuara	98% Publikimi në REKNJP i 39 nga 40 draft-raporte RIA)	196%

1.3.7 Përmirësimi i cilësisë së procesit të konsultimit publik.	7.03 pikë	7.2 pikë	7.63 pikë	106%
1.3.8 Numri i akteve të legjislacionit dytësor, me interes të lartë publik, të konsultuara.	16	44	47	107%
1.3.9 Rritja e kapaciteteve analitike në institucionet qendrore lidhur me proceset RIA dhe të konsultimit publik.	2	8	10	125%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.3[28]				**98%**

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.3 "*Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikat e mira ndërkombëtare*" i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 98%.[29]

Për sa më sipër, në vijim paraqitet në mënyrë më të detajuar progresi i realizuar për secilin prej treguesve të Objektivit Specifik 1.3 gjatë periudhës së raportimit:

Treguesi 1.3.1 "*Përmirësimi cilësor i procesit të programimit rregullator*", ka si qëllim të masë nivelin e përmirësimit cilësor të procesit të programimit rregullator duke u bazuar në nivelin e realizimit të PPAP. Për këtë qëllim, Kryeministria bashkëpunim me ministritë e linjës mbledh dhe analizon të dhënat mbi realizueshmërinë e PPAP. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.1, për vitin 2026 është "78% e PPAP e realizuar".

[28] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë. Për treguesit për të cilët niveli i realizimit ka tejkaluar 100%, në llogaritjen e nivelit të përgjithshëm të realizimit është marrë në konsideratë vlera 100% si niveli maksimal i realizimit për secilin tregues. Kjo qasje metodologjike siguron që tejkalimi i objektivit të një treguesi të mos kompensojë mosrealizimin ose realizimin e pjesshëm të treguesve të tjerë. Në këtë mënyrë, niveli i përgjithshëm i realizimit pasqyron në mënyrë më të saktë shkallën reale të përmbushjes së objektivave, duke garantuar që një tregues i realizuar, për shembull, në masën 150%, të mos ndikojë në mënyrë disproporcionale në rezultatin e përgjithshëm kur tregues të tjerë nuk janë realizuar në masën 100%.

[29] Për detaje të mëtejshme mbi metodologjinë, burimin e të dhënave për treguesit dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit, konkretisht TP 1.3.1, TP 1.3.4, TP 1.3.6, TP 1.3.7, TP 1.3.8 dhe TP 1.3.9.

Realizimi i Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) për katërmujorin e parë të vitit 2026 rezulton 67%, ndërsa realizimi i PPAP-së i llogaritur në raport me planifikimin vjetor rezulton 30%. Vlera e synuar prej 78% i referohet realizimit për të gjithë vitin 2026 dhe jo periudhës janar-qershor 2026. Niveli përfundimtar i realizimit dhe progresi real në raport me vlerën e synuar prej 78% do të evidentohen në "*Raportin Vjetor të Monitorimit për vitin 2026*".

Gjatë periudhës së monitorimit janë evidentuar disa vonesa në zbatimin e udhëzimeve dhe në koordinimin ndërinstitucional, të cilat kanë ndikuar në ecurinë e proceseve të lidhura me treguesin. Gjithashtu, nga disa institucione propozuese janë konstatuar vonesa në hartimin dhe përcjelljen brenda afateve të përcaktuara të projektakteve, duke ndikuar në respektimin e afateve të parashikuara dhe në vijueshmërinë e procesit.

Për adresimin e problematikave të evidentuara dhe për përmirësimin e ecurisë së procesit, në vijim parashikohen këta hapa:

- Forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe përmirësimi i udhëzimeve për procesin e programimit rregullator.
- Vijimi i raportimit periodik gjatë vitit, me përcaktimin e pikave të ndërmjetme të monitorimit për aktet që paraqesin rrezik për mosrealizim brenda afateve të planifikuara.
- Organizimi i takimeve të strukturuara koordinuese, me fokus adresimin në kohë të problematikave dhe ndjekjen e ecurisë së akteve.

Treguesi 1.3.4 "*Përqindja e ligjeve që i plotësojnë kriteret, të shoqëruara nga raporte RIA*", synon të masë nivelin e ligjeve të miratuara në Këshillin e Ministrave të shoqëruara nga raporti RIA. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.4, për vitin 2026 është "100% ligjeve të miratuara që i plotësojnë kriteret të shoqërohen me raport RIA".

Sipas metodologjisë së përcaktuar për vlerësimin e treguesit, çdo ligj i miratuar që plotëson kriteret për t'iu nënshtruar *Vlerësimit të Ndikimit Rregullator* (RIA) duhet të shoqërohet me raportin përkatës RIA. Niveli i realizimit të treguesit përcaktohet duke krahasuar realizimin faktik me vlerën e synuar.

Gjatë periudhës raportuese janar-korrik 2026, 100% e ligjeve të miratuara në Këshillin e Ministrave, të cilat plotësonin kriteret për t'u shoqëruar me raport RIA, janë shoqëruar me raportin përkatës të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator. Për rrjedhojë, treguesi ka arritur vlerën e synuar prej 100%, duke reflektuar përmbushjen e plotë të objektivit të përcaktuar për këtë tregues.

Realizimi i këtij niveli evidenton zbatimin e qëndrueshëm të kërkesës për shoqërimin e ligjeve me raportet RIA dhe përmirësimin e integrimit të vlerësimit të ndikimit në procesin e politikëbërjes dhe hartimit të legjislacionit. Gjithashtu, ai dëshmon për një nivel të lartë të koordinimit ndërinstitucional dhe të zbatimit të kërkesave metodologjike në procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator.

Arritja e treguesit 1.3.4 kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e Objektivit Specifik 1.3, duke siguruar që ligjet që plotësojnë kriteret përkatëse të mbështeten në analiza të strukturuara dhe të bazuara në të dhëna. Zbatimi i qëndrueshëm i këtij standardi kontribuon në rritjen e cilësisë, transparencës dhe parashikueshmërisë së procesit politikëbërës, si dhe në mbështetjen e vendimmarrjes së mirëplanifikuar dhe të bazuar në evidenca.

Nismat e shoqëruara me raporte RIA gjatë periudhës raportuese mbulojnë një gamë të gjerë fushash të politikëbërjes, duke përfshirë: administratën publike, ekonominë dhe sipërmarrjen, sektorin financiar, bujqësinë dhe zhvillimin rural, energjinë dhe infrastrukturën, mjedisin dhe burimet natyrore, si dhe shëndetësinë, mbrojtjen sociale, turizmin dhe kulturën. Kjo shtrirje dëshmon për integrimin e procesit të RIA-s në fusha të ndryshme të politikëbërjes dhe për përdorimin e tij si instrument për mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Në muajt në vijim, puna do të përqendrohet në forcimin e zbatimit dhe të cilësisë së procesit RIA, përmes ndërmarrjes së këtyre hapave:

- Monitorimi i vazhdueshëm i shoqërimit të projektligjeve me raportin RIA;
- Organizimi i trajnimeve periodike për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të raporteve RIA;
- Vijimi i shqyrtimit cilësor nga struktura përgjegjëse për procesin RIA në Kryeministri, me qëllim garantimin e ruajtjes së standardeve të cilësisë së raporteve RIA të konfirmuara;
- Forcimi i koordinimit të hershëm ndërinstitucional, me qëllim garantimin që të gjitha projektaktet e parashikuara në PPAP, të cilat plotësojnë kriteret përkatëse, të shoqërohen në kohë me raportin RIA.

Treguesi 1.3.6 "*Përqindja e draft-raporteve RIA të publikuara në RENJKP përpara finalizimit*", synon të masë nivelin e publikimit në RENJKP të draft-raporteve RIA përpara finalizimit. Për këtë qëllim, Njësia përgjegjëse për RIA në Kryeministri, në cilësinë e strukturës teknike grumbullon dhe analizon të dhënat mbi nivelin e draft-raporteve RIA të publikuara në RENJKP përpara finalizimit kundrejt totalit të draft-raporteve RIA të hartuara nga institucionet përgjegjëse. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.6, për vitin 2026 është "50% e draft-raporteve RIA të publikuara në REKNJP përpara finalizimit".

Gjatë periudhës janar-23 korrik 2026, 98% e draft-raporteve RIA janë publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJKP) përpara finalizimit të tyre. Në raport me vlerën e synuar prej 50%, niveli i realizimit të treguesit rezulton 196%, duke evidentuar një tejkalim të konsiderueshëm të objektivit të përcaktuar për periudhën e raportimit.

Ky rezultat dëshmon një nivel të lartë të zbatimit të praktikës së publikimit paraprak të draft-raporteve RIA dhe kontribuon në rritjen e transparencës së procesit politikëbërës, si dhe në krijimin e mundësive për marrjen e kontributeve dhe komenteve nga qytetarët dhe grupet e interesit në një fazë të hershme të procesit.

Gjatë periudhës së monitorimit, draft-raportet RIA të publikuara në RENJKP përfshijnë projektakte ligjore që mbulojnë një gamë të gjerë fushash të politikave publike dhe janë përgatitur nga institucione të ndryshme të administratës publike. Publikimet evidentojnë përfshirjen e institucioneve qendrore, duke reflektuar shtrirjen ndërinstitucionale të procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA). Në tërësi, kjo pasqyron zbatimin e procesit RIA në fusha të ndryshme të politikëbërjes dhe angazhimin e institucioneve propozuese në përmbushjen e kërkesave për vlerësimin dhe konsultimin e projektakteve përpara finalizimit të tyre.

Arritja e treguesit 1.3.6 kontribuon pozitivisht në realizimin e Objektivit Specifik 1.3, pasi publikimi i hershëm i draft-raporteve RIA në RENJKP:

- Rrit transparencën dhe aksesin e publikut në informacionin që mbështet procesin vendimmarrës;
- Krijon mundësi për marrjen e një feedback-u më gjithëpërfshirës nga grupet e interesit;
- Mbështet përmirësimin e cilësisë së analizës së ndikimit dhe hartimin e politikave të bazuara në të dhëna;
- Forcon ndërlidhjen ndërmjet procesit RIA dhe konsultimit publik.

Tejkalimi i ndjeshëm i vlerës së synuar reflekton angazhimin e institucioneve për rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin politikëbërës, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe të vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Në muajt në vijim, puna do të përqendrohet në forcimin e procesit të publikimit në kohë të draft-raporteve RIA dhe në rritjen e respektimit të procedurave përkatëse, përmes këtyre hapave:

- Koordinimi me ministritë e linjës për të siguruar që të gjitha draft-raportet RIA të publikohen në RENJKP përpara finalizimit.
- Monitorimi i vazhdueshëm i RENJKP-së, me qëllim verifikimin e publikimit në kohë të draft-raporteve RIA.
- Përcaktimi i afateve të qarta për publikimin e draft-raporteve nga të gjitha institucionet propozuese.
- Organizimi i trajnimeve dhe ofrimi i udhëzimeve për institucionet, lidhur me rëndësinë e publikimit të raporteve RIA dhe procedurat që duhet të ndiqen në RENJKP.
- Vijimi i raportimit periodik mbi nivelin e publikimit të draft-raporteve RIA dhe adresimi në kohë i çdo vonese apo problematike teknike dhe procedurale.

Treguesi 1.3.7 "*Përmirësimi i cilësisë së procesit të konsultimit publik*", synon të masë nivelin e përmirësimit të cilësisë së procesit të konsultimit publik. Për këtë qëllim, njësia përgjegjëse në Kryeministri në bashkëpunim me ministritë e linjës kryen matjen e performancës institucionale dhe cilësisë së konsultimeve publike nëpërmjet llogaritjes së indeksit të cilësisë së këtij procesi duke u bazuar në kritere që lidhen me: % (përqindjen) e akteve të miratuara në Këshillin e Ministrave, objekt i procesit, të konsultuara në RENJKP; % (përqindjen) e konsultimeve të kryera

në respektim të afatit ligjor të konsultimit publik; % (përqindjen) e raporteve individuale të konsultimit publik të publikuara në RENJKP; % (përqindjen) e raporteve insitucionale periodike të konsultimit publik të publikuara në RENJKP. Performanca maksimale vlerësohet me 8 pikë, sipas qasjes së hartuar me mbështetjen e SIGMA dhe të integruar në metodologjinë e konsultimit publik. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.7, për vitin 2026 është "7.2 pikë".

Gjatë periudhës 1 janar-23 korrik, procesi i konsultimit publik ka arritur një vlerë prej **7**.63 pikësh, kundrejt 7.2 pikëve të synuara, duke rezultuar në një nivel realizimi prej 106% të objektivit të përcaktuar për periudhën. Rezultati i arritur tregon se performanca e procesit ka tejkaluar nivelin e synuar.

Rezultati i arritur tregon për një nivel të lartë të performancës së procesit të konsultimit publik dhe për përmbushjen e standardeve të përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit. Arritja e treguesit 1.3.7 ka kontribuar pozitivisht në realizimin e Objektivit Specifik 1.3, përmes përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të procesit të konsultimit publik. Konkretisht, përmirësimi i këtij procesi kontribuon në:

- rritjen e transparencës dhe zgjerimin e mundësive për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit;
- zhvillimin e një procesi më të strukturuar, të planifikuar dhe të monitoruar për konsultimin e akteve rregullatore;
- mbështetjen e vendimmarrjes mbi bazën e analizave dhe të dhënave të siguruara përmes publikimit dhe konsultimit gjithëpërfshirës;
- forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përafrimin me praktikat e mira ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, progresi i evidentuar për treguesin përbën një kontribut të rëndësishëm në forcimin e parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës dhe pjesëmarrjes publike, si dhe në rritjen e efektivitetit të administrimit publik.

Për periudhën në vijim, fokusi do të vijojë të jetë në koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së procesit të konsultimit publik në institucionet e qeverisjes qendrore, me synim garantimin e zbatimit të standardeve të përcaktuara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit.

Treguesi 1.3.8 "*Numri i akteve të legjislacionit dytësor, me interes të lartë publik, të konsultuara*", ka si qëllim të masë numrin akteve rregullatore të legjislacionit dytësor, objekt i procesit të konsultimit publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat i janë nënshtruar këtij procesi në zbatim të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" të ndryshuar, si dhe të rregullores së Këshillit të Ministrave. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.6, për vitin 2026, është "të paktën 44 akte të konsultuara në total deri në vitin 2026".

Deri në vitin 2026, (duke përfshirë edhe rezultatet e viteve 2024 dhe 2025, sipas metodologjisë së monitorimit), synohet konsultimi i 44 akteve rregullatore të legjislacionit dytësor me interes të

lartë publik. Deri në fund të vitit 2025, janë konsultuar 31 akte. Gjatë periudhës 1 janar–23 korrik 2026 janë konsultuar 16 projektakte rregullatore të legjislacionit dytësor me interes të lartë publik. Si rezultat, numri kumulativ i akteve të konsultuara gjatë periudhës së monitorimit arrin në 47 akte, duke tejkaluar vlerën e synuar prej 44 aktesh dhe duke arritur një nivel realizimi te treguesit prej 107%.

Rezultati i arritur tregon se vlera faktike ka tejkaluar objektivin kumulativ të përcaktuar, duke reflektuar një nivel të lartë të realizimit të treguesit dhe vijimësinë e procesit të konsultimit publik për aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik.

Arritja e treguesit 1.3.8 ka kontribuar pozitivisht në realizimin e Objektivit Specifik 1.3, pasi rritja e numrit të akteve të legjislacionit dytësor të konsultuara ka ndikuar në forcimin e procesit të konsultimit publik dhe zgjerimin e mundësive për pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve dhe grupeve të interesit. Konsultimi i këtyre akteve kontribuon gjithashtu në rritjen e transparencës dhe sigurimin e mundësive për marrjen e komenteve dhe sugjerimeve përpara miratimit të tyre në Këshillin e Ministrave, si dhe në mbështetjen e hartimit të politikave mbi bazën e të dhënave dhe analizave cilësore. Për më tepër, ky proces kontribuon në forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe në përafrimin me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e konsultimit publik.

Në tërësi, rezultati i arritur për këtë tregues përbën një kontribut në forcimin e transparencës, pjesëmarrjes publike dhe cilësisë së procesit të politikëbërjes, në funksion të një administrimi publik më të hapur dhe efektiv.

Në kuadër të vijimit të këtij procesi, do të vijojë koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së zbatimit të procesit të konsultimit publik nga institucionet e qeverisjes qendrore, me qëllim konsolidimin e praktikave të konsultimit, garantimin e zbatimit të standardeve të përcaktuara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit.

Treguesi 1.3.9 "*Rritja e kapaciteteve analitike në institucionet qendrore lidhur me proceset RIA dhe të konsultimit publik*", synon të masë nivelin e rritjes së kapaciteteve analitike në institucionet qëndrore lidhur me proceset RIA dhe të konsultimit publik. Për këtë qëllim, Kryeministria dhe ASPA në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucione të tjera të administratës publike kanë detyrë të përgatisin një plan trajnimesh për nëpunësit publikë. Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.3.9 për vitin 2026 është "8 trajnime të organizuara gjithsej", përfshirë rezultatet e viteve 2024 dhe 2025.

Për sa më sipër, deri në fund të vitit 2025 janë zhvilluar 6 trajnime, ndërsa gjatë periudhës janar–23 korrik 2026 janë zhvilluar 4 trajnime, duke e çuar numrin kumulativ të trajnimeve të realizuara në 10. Referuar formulës së llogaritjes së progresit të treguesit, sipas metodologjisë së monitorimit, niveli i realizimit rezulton 125%, kundrejt objektivit kumulativ të synuar prej 8 trajnimesh.

Vlera faktike e arritur tejkalon objektivin kumulativ të përcaktuar për vitin 2026, duke reflektuar një nivel të lartë realizimi të treguesit dhe vijimësinë e përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve në fushën përkatëse.

Një nga trajnimet e zhvilluara gjatë periudhës së monitorimit ishte trajnimi me temë "Vlerësimi i Impaktit Rregullator (RIA)", i organizuar nga ASPA. Trajnimi kishte si objektiv forcimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve për zbatimin e metodologjisë së Vlerësimit të Impaktit Rregullator (RIA), përmes ofrimit të njohurive mbi parimet, fazat dhe instrumentet e analizës së ndikimit të projektakteve, identifikimin dhe vlerësimin e alternativave rregullatore, si dhe përdorimin e analizës së bazuar në evidencë në procesin e hartimit të politikave publike. Gjithashtu, trajnimi trajtoi aspekte praktike të përgatitjes së një analize RIA, përfshirë vlerësimin e kostove dhe përfitimeve, konsultimin publik dhe monitorimin e ndikimit të politikave.

Në trajnim morën pjesë 25 pjesëmarrës, nga të cilët 14 përmbushën kriteret e përcaktuara nga ASPA për certifikim. Këto kritere përfshinin përmbushjen e kërkesave të pjesëmarrjes në program dhe përfundimin me sukses të procesit të vlerësimit të parashikuar nga ofruesi i trajnimit.

Arritja e treguesit 1.3.9 ka kontribuar pozitivisht në realizimin e Objektivit Specifik 1.3, përmes forcimit të kapaciteteve analitike në institucionet e qeverisjes qendrore. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve mbështet përmirësimin e përgatitjes dhe analizës së raporteve RIA dhe të proceseve të konsultimit publik, si dhe forcimin e vendimmarrjes të bazuar në të dhëna dhe analiza cilësore. Gjithashtu, rritja e kapaciteteve analitike kontribuon në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së procesit të hartimit të akteve dhe konsultimit publik, si dhe në përafrimin e praktikave institucionale me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

Në tërësi, progresi i evidentuar për këtë tregues përbën një kontribut në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së politikëbërjes, në funksion të qeverisjes së mirë, transparente dhe administrimit publik efektiv.

Sa më sipër, në vijim, është e rëndësishme të sigurohet vazhdimësia e programeve të trajnimit, me synim ruajtjen, konsolidimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në lidhje me proceset e Vlerësimit të Impaktit Rregullator (RIA) dhe të Konsultimit Publik.

QËLLIMI I POLITIKËS II: SHËRBIMI CIVIL DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Përmes Qëllimit të Politikës II, është synuar konsolidimi i një administrate profesionale, të përzgjedhur me meritë, të painfluencuar nga aktorë dhe faktorë të jashtëm, që punon me efikasitet, motivim dhe llogaridhënie të lartë.

Në zbatim të Qëllimit të Politikës II, gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë monitoruar një sërë masash dhe aktivitetesh që lidhen me përmirësimin e proceseve të pranimit në shërbimin civil, në funksion të zbatimit të parimit të meritës, forcimit të motivimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve. Në të njëjtën kohë, masat dhe aktivitetet e monitoruara kanë synuar përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e efikasitetit në administrimin e burimeve njerëzore, ndër të tjera edhe përmes përdorimit dhe zhvillimit të sistemeve elektronike lehtësuese.


Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë realizuar masat dhe aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme.

Qëllimet e Politikës	**Masat dhe Aktivitetet**	**Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve**			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M e I-rë të 2026	**Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[30]**	**Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[31]**	**Masa dhe aktivitete të pazbatuara[32]**
Qëllimi i Politikës II	Masa	17	6	6	5
	Aktivitete	29	12	6	11

Rezulton se, nga 17 masa dhe 29 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027 për Qëllimin e Politikës II "Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore", gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, janë zbatuar plotësisht 6 masa dhe 12 aktivitete, pjesërisht 6 masa dhe 6 aktivitete, ndërsa 5 masa dhe 11 aktivitete rezultojnë të pazbatuara.

Ecuria e realizimit të masave dhe aktiviteteve të paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

[30] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[31] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[32] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.



Qëllimi i Politikës II përfshin gjithsej 10 tregues performance, nga të cilët, referuar Aneksit 2 të SNRAP 2025-2030 "Pasaporta e Treguesve të Performancës", 5 tregues janë të matshëm për këtë periudhë monitorimi, duke pasur parasysh frekuencën vjetore të matjes së tyre.

Për treguesit e performancës të QP II, në tabelën e mëposhtme paraqitet realizueshmëria e tyre.

Qëllimi i Politikës II	Totali i Treguesve e performancës	Totali i Treguesve e Performancës të matur për periudhën janar-qershor 2026	Realizimi i Treguesve të Performancës		
			Vlera e synuar është realizuar plotësisht.[33]	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht.[34]	Vlera e synuar nuk është e realizuar.[35]
	10	5	1	4	0

Nga 5 treguesit e performancës të matur për periudhën e raportimit për Qëllimin e Politikës II "Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore", vlera e synuar është arritur plotësisht për 1 tregues performance, ndërsa për 4 tregues të tjerë është arritur pjesërisht.

[33] Që është realizuar në shkallën 100 për qind.
[34] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 99% për qind.
[35] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar nivelin e progresit, në përqindje, për secilin objektiv specifik të Qëllimit të Politikës II, bazuar në ecurinë e treguesve të performancës dhe nivelin e realizimit të masave përkatëse.

Objektivi Specifik (OS)	Shkalla e realizimit të OS sipas masave.[36]	Shkalla realizimit sipas treguesve të performancës.[37]
OS 2.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.	18%	50%
OS 2.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës	40%	96%
OS 2.3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integrimit evropian të Shqipërisë	58%	94%
OS 2.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ	71%	Nuk matet.
Zbatueshmëria e Qëllimit të Politikës II	**47%**	**80%**

Nga analiza e mësipërme rezulton se niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës II, i vlerësuar mbi bazën e performancës së treguesve përkatës, është 80%.

Në vijim paraqitet analiza e masave të monitoruara gjatë periudhës raportuese, së bashku me ecurinë e treguesve të performancës përkatës, në funksion të vlerësimit të progresit në zbatimin e Objektivave Specifikë të Qëllimit të Politikës II.

[36] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%.

[37] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$ x 100%.

Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Objektivi Specifik 2.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet tërheqja dhe mbajtja në administratën publike e nëpunësve të kualifikuar dhe me rezultate të larta në punë, të rekrutuar mbi bazën e parimit të meritës dhe të kritereve të vlerësimit të aplikuara në mënyrë të barabartë dhe transparente për të gjithë kandidatët. Një nga sfidat e konsiderueshme gjatë dhjetëvjeçarit të zbatimit të ligjit ka qenë konsolidimi i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), krahas nevojës për rritjen e efektivitetit të procedurave të rekrutimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të testimit të bazuara në kompetenca.

Për periudhën janar–qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 2.1 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 7 (shtatë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 2.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë	
Masa 2.1.2	Plotësimi i kuadrit nënligjor për garantimin e një procesi të përmirësuar, objektiv dhe meritokratik rekrutimi.
Aktiviteti 2.1.2.a	Identifikimi i akteve për t'u ndryshuar dhe hartimi i drafteve fillestare.
Masa 2.1.3	Miratimi i kornizës së kompetencave për shërbimin civil dhe përshtatja e procedurave të rekrutimit me kompetencat e reja.
Aktiviteti 2.1.3.a	Analiza e kuadrit të kompetencave për TND dhe propozimi për ndryshim. Përgatitja e kuadrit të kompetencave për nëpunësit e tjerë civilë.
Aktiviteti 2.1.3.b	Konsultimi me drejtorët e njësive të BNJ dhe me Sekretarët e Përgjithshëm dhe konsultimi publik me aktorët e tjerë të përfshirë i kuadrit të kompetencave për TND dhe nëpunësit e tjerë civilë.
Masa 2.1.4	Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit në shërbimin civil dhe për lëvizjet në karrierë dhe përditësimi i vazhdueshëm i databazës elektronike të pyetjeve.
Aktiviteti 2.1.4.a	Trajnimi i anëtarëve të Komiteteve të Pranimit në shërbimin civil dhe për lëvizjet në karrierë.
Aktiviteti 2.1.4.b	Përditësimi i bazës së të dhënave të pyetjeve për procedurat e rekrutimit.
Masa 2.1.5	Zbatimi i një programi të dedikuar për përshtatjen e nëpunësve të rinj me institucionin punëmarrës dhe pozicionin e punës gjatë periudhës së provës apo në rastet e ngritjes në detyrë.
Aktiviteti 2.1.5.a	Krijimi i një procedure formale që përfshin sesione të mirëseardhjes dhe trajnimit fillestar për të gjithë nëpunësit e rinj dhe ata që janë ngritur në detyrë.

Aktiviteti 2.1.5.b	Përcaktimi i mentorëve me përvojë të cilët do të ndihmojnë nëpunësit e rinj dhe ata që janë promovuar, duke ofruar udhëzime dhe mbështetje gjatë periudhës së provës.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 1.1. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit, puna për rishikimin e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, vijoi nëpërmjet konsultimeve të mëtejshme me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Departamenti i Administratës Publike kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me Komisionin Evropian dhe ekspertët e OECD/SIGMA, për të diskutuar dhe adresuar komentet dhe sugjerimet e tyre.

Pas marrjes së komenteve të tyre, gjatë periudhës janar-shkurt 2026, u vijua me: (i) përgatitjen e një dokumenti sqarues për partnerët mbi komentet dhe sugjerimet e tyre; (ii) ndryshimin e projektligjit, me qëllim reflektimin e komenteve të partnerëve të marra në konsideratë; (iii) ndryshimet në draftin e konsoliduar krahasimor të ligjit aktualisht në fuqi me projektligjin për ndryshimin e ligjit nr. 152/2013, ku u integruan sugjerimet e partnerëve të marra në konsideratë. Këto dokumente iu dërguan, në rrugë elektronike, shërbimeve të Komisionit Evropian.

Në fund të muajit mars, në Tiranë, u zhvillua një takim i dedikuar, me pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Departamentit të Administratës Publike, përfaqësuesve të lartë të OECD/SIGMA dhe ekspertit të angazhuar në hartimin e projektligjit, me qëllim diskutimin e çështjeve teknike të mbetura.

Mbi bazën e komenteve dhe rekomandimeve teknike të SIGMA-s, projektligji u rishikua më tej, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së tij me standardet dhe praktikat më të mira evropiane në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Pas përfundimit të procesit të konsultimit dhe dakordësimit me partnerët ndërkombëtarë, do të vijohet me procedurën e bashkërendimit ndërinstitucional. Në këtë kuadër, projektligji, së bashku me relacionin shpjegues dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA), do të përcillen zyrtarisht për mendim pranë ministrive, nëpërmjet sistemit e-Akte, nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Referuar draftit aktual të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar", janë identifikuar 12 akte nënligjore për t'u hartuar, të cilat, sipas rastit, do të shfuqizojnë ose ndryshojnë aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht, planifikohet hartimi i projektvendimeve mbi institutet/çështjet e mëposhtme:

- Pranimi, lëvizja paralele, periudha e provës në kategorinë ekzekutive;
- Plotësimi i vendeve të lira në kategoritë drejtuese;
- Përshkrimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës;
- Transferimi, pezullimi dhe lirimi nga shërbimi civil;
- Vlerësimi i performancës dhe njohurive shtesë;
- Rikthimi në detyrë sipas vendimit gjyqësor;
- Punësimi i përkohshëm i studentëve të ekselencës;
- Dosjet e personelit dhe Regjistri Qendror i Personelit;
- Procedura disiplinore dhe organet disiplinore;
- Organizimi i ASPA-s, trajnimet dhe tarifat;
- Dispozitat kalimtare për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues;
- Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil.

Fillimi i punës për hartimin e drafteve fillestare të projektvendimeve të Këshillit të Ministrave është i lidhur me miratimin e projektligjit. Pas miratimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave dhe dërgimit të tij në Kuvend, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance", do të nisë punën për hartimin e akteve nënligjore të parashikuara.

Në funksion të përgatitjes së këtij procesi, do të hartohet një plan pune, në të cilin do të përcaktohen projektaktet konkrete që do të hartohen, institucionet përgjegjëse dhe bashkëpërgjegjëse për hartimin e tyre, niveli i prioritetit, risqet e mundshme, si dhe elemente të tjera të nevojshme për organizimin dhe ndjekjen e procesit.

Ndërkohë, në projektligj parashikohet një afat maksimal prej 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja në fuqi e tij për miratimin e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave. Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, aktet nënligjore aktualisht në fuqi të dala në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

Përsa i përket miratimit të kornizës së kompetencave për shërbimin civil (masa 2.1.3) dhe më pas miratimi i saj nga Këshilli i Ministrave do të pasojë miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar. Për rrjedhojë, pas miratimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave dhe dërgimit të tij në Kuvend, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance", do të nisë punën për hartimin e akteve nënligjore të parashikuara, ndër të cilët edhe projektvendimin për miratimin e kornizës së kompetencave për nëpunësit civilë.

Në kuadër të zbatimit të masës 2.1.4, banka e pyetjeve për procedurat e konkurrimit është pasuruar dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil dhe me kërkesat e procedurave të rekrutimit të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit. Për periudhën janar-korrik 2026, janë zhvilluar rreth 299 procedura konkurrimi, me kontributin e

drejtpërdrejtë të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit dhe në përputhje me ndryshimet përkatëse ligjore.

Përditësimi dhe pasurimi i bankës së pyetjeve vijon të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili realizohet në funksion të procedurave të rekrutimit dhe përshtatjes së tyre me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Ky proces parashikohet të vijojë edhe në periudhat dhe vitet pasardhëse, në përputhje me nevojat e identifikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit.

Sa i përket "trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit në shërbimin civil dhe për lëvizjet në karrierë" (aktiviteti 2.1.4.a), procesi i trajnimit do të vijojë në përputhje me ndryshimet e parashikuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Vijimi i trajnimeve do të mundësojë përshtatjen e njohurive dhe kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara nga kuadri i përditësuar ligjor dhe nënligjor.

Në këtë kuadër, realizimi i trajnimeve lidhet me përfundimin dhe hyrjen në zbatim të ndryshimeve përkatëse ligjore dhe nënligjore, pas së cilës procesi do të vijojë në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme.

Në zbatim të masës 2.1.5, Projekti i Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë (EU for Good Governance), ka hartuar Udhëzuesin "Për programin e Orientimit Fillestar në Shërbimin Civil Shqiptar". Ky dokument u ofron drejtuesve dhe punonjësve të burimeve njerëzore udhëzime për programin e orientimit fillestar të punonjësve të rinj. Objektivi kryesor i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për institucionet publike që planifikojnë kryerjen e programit të orientimit fillestar për punonjësit që i bashkohet shërbimit civil për herë të parë. Megjithatë, elementët e këtij programi mund të zbatohen edhe për:

- përsëritje e programit – kur një punonjës kthehet pas një mungese më të gjatë, siç është një transferim i përkohshëm ose leje lindjeje;
- punonjës i ri që është ngritur në detyrë ose është transferuar dhe nuk ka nevojë të kalojë një periudhë prove.

Aktualisht, ky Udhëzues është pranë Departamentit të Administratës Publike për vlerësim dhe shqyrtim. Në vijim të këtij procesi, DAP pritet të hartojë dhe të miratojë një udhëzim të posaçëm, bazuar në parimet dhe rekomandimet e këtij Udhëzuesi, i cili do të shërbejë si dokument orientues për njësitë e burimeve njerëzore të të gjitha institucioneve të administratës publike. Udhëzimi do të synojë të sigurojë një qasje të unifikuar dhe të standardizuar në zbatimin e programit të orientimit fillestar për punonjësit e rinj të shërbimit civil.

Për Objektivin Specifik 2.1 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar tre tregues performance, ku vetëm një është i matshëm për këtë periudhë monitorimi konkretisht: 2.1.3 "*Niveli i plotësimit të pozicioneve vakante në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 2.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
2.1.3 Niveli i plotësimit të pozicioneve vakante në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit.	100%	100%	50%	50%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.1[38]				**50%**

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.1 "Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 50%.[39]

Treguesi 2.1.3 "*Niveli i plotësimit të pozicioneve vakante në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit*" ka si qëllim të masë shkallën e rekrutimit në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të hapura, meritokratike dhe transparente. Gjithashtu, treguesi jep një tablo më të qartë: (i) për të monitoruar funksionimin në praktikë të sistemit të rekrutimit; (ii) për të identifikuar pengesat që mund të ndikojnë në mosplotësimin e vakancave; (iii) për të vlerësuar tipologjitë e pozicioneve më atraktive për kandidatët.

Nëpërmjet këtij treguesi synohet të jepet niveli i plotësimit të pozicioneve vakante për procedurat e konkurrimit për pozicione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, e konkretisht në: Kryeministri; Ministritë e linjës; Institucionet qendrore në varësi të Kryeministrisë apo ministrave të linjës, përfshirë degët e tyre territoriale.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 është realizuar emërimi për 255 pozicione vakante, duke arritur një nivel plotësimi prej 49.8%. Mosrealizimi i plotë i treguesit lidhet me faktin se për 130 pozicione të shpallura procedurat e konkurrimit janë ende në proces dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si pozicione të plotësuara në këtë periudhë raportimi. Gjithashtu, kohëzgjatja e

[38] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$.

[39] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

procedurave të konkurrimit dhe fazat administrative të parashikuara në legjislacion ndikojnë në përfundimin e emërimeve brenda periudhës raportuese.

Mosplotësimi i të gjitha pozicioneve vakante brenda periudhës raportuese ndikon pjesërisht në arritjen e objektivit specifik për sigurimin e plotësimit me burime njerëzore. Megjithatë, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e procedurave të konkurrimit është ende në zhvillim, pritet që niveli i realizimit të treguesit të përmirësohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit, pas përfundimit të këtyre procedurave.

Objektivi Specifik 2.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës

Rritja e motivimit, tërheqja dhe mbajtja e nëpunësve të kualifikuar në administratën publike përbëjnë një komponent të rëndësishëm të reformës në administratën publike dhe lidhen drejtpërdrejt me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efektivitetit të administratës. Në kontekstin e procesit të integrimit evropian, nevoja për një administratë profesionale, të qëndrueshme dhe të motivuar mbetet e rëndësishme, duke kërkuar investime të vazhdueshme në zhvillimin profesional, përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e mekanizmave që mbështesin motivimin dhe angazhimin e nëpunësve.

Në këtë kuadër, Objektivi Specifik 2.2 synon forcimin e kapaciteteve të administratës publike përmes masave që mbështesin tërheqjen dhe mbajtjen e burimeve njerëzore të kualifikuara, si dhe rritjen e motivimit dhe angazhimit të nëpunësve ekzistues. Këto përpjekje marrin rëndësi të veçantë në funksion të përballimit të kërkesave dhe ngarkesës së shtuar institucionale që lidhen me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 2.2 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 5 (pesë) masa dhe 7 (shtatë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 2.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.	
Masa 2.2.2	Rritja e transparencës së pagave për nëpunësit publikë, përfshirë edhe në njoftimet për aplikime për vendet vakante.
Aktiviteti 2.2.2.b	Publikimi i vendeve vakante sipas modelit të miratuar.
Masa 2.2.3	Miratimi dhe zbatimi i metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike.

Aktiviteti 2.2.3.a	Hartimi i metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike.
Masa 2.2.4	Rishikimi dhe zbatimi praktik i procesit të vlerësimit të performancës individuale, duke garantuar harmonizim me performancën institucionale.
Aktiviteti 2.2.4.a	Përgatitja e ndryshimeve në metodologjinë për vlerësimin e rezultateve në punë.
Masa 2.2.8	Konsolidimi i praktikave të rregullta promovuese të kapitalit njerëzor profesional dhe me integritet të administratës publike.
Aktiviteti 2.2.8.b	Organizimi i përvitshëm i eventit për ndarjen e çmimeve për punonjësit e dalluar.
Masa 2.2.11	Promovimi i rolit të shërbimit civil dhe administratës publike si punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues.
Aktiviteti 2.2.11.a	Organizimi i përvitshëm i Javës së Administratës Publike.
Aktiviteti 2.2.11.b	Pjesëmarrje e rregullt e DAP në panaire kombëtare të punës për të promovuar mundësitë e karrierës në administratën publike.
Aktiviteti 2.2.11.c	Bashkëpunimi me institucionet akademike dhe partnerë të tjerë.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 2.2. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në funksion të rritjes së transparencës së pagave për nëpunësit publikë (masa 2.2.2), është ideuar dhe përgatitur modeli i njoftimit për aplikim për vende vakante, duke përfshirë informacionin mbi elementët përbërës të pagës së pozicionit vakant dhe vlerat e tyre përkatëse. Ndërkohë, publikimi i vendeve vakante sipas modelit të përgatitur nuk është realizuar ende për shkak të nevojës për më shumë kohë për të operacionalizuar procesin.

Metodologjia e re për vlerësimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil (masa 2.2.3), e cila do të përdoret për klasifikimin e pozicioneve në kategorinë dhe klasën përkatëse, do të miratohet nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në zbatim të ndryshimeve ligjore të përgatitura. Për rrjedhojë, hartimi i metodologjisë së re kushtëzohet nga miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar. Pas miratimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave dhe dërgimit të tij në Kuvend, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance", do të nisë punën për hartimin e akteve nënligjore të parashikuara, ndër të cilët edhe projektvendimin për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, ku do të përfshihet metodologjia për vlerësimin e pozicioneve të punës.

Projektligji "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*", të ndryshuar", propozon, ndër të tjera, ndryshime edhe sa i takon procesit të vlerësimit të performancës individuale të nëpunësve civilë (masa 2.2.4). Këto ndryshime do të materializohen me miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit përkatës për vlerësimin e rezultateve në punë, pjesë e të cilit do të jetë edhe metodologjia e vlerësimit. Për rrjedhojë, hartimi i metodologjisë së re kushtëzohet nga miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar. Pas miratimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave dhe dërgimit të tij në Kuvend, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance", do të nisë punën për hartimin e akteve nënligjore të parashikuara, ndër të cilët edhe projektvendimin për vlerësimin e rezultateve në punë, ku do të përfshihet metodologjia e vlerësimit.

Me qëllim promovimin e rolit të shërbimit civil dhe administratës publike si punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues, më 29 qershor - 3 korrik 2026 u organizua edicioni i tretë i Javës së Administratës Publike 2026, nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike.
Gjatë kësaj jave u zhvillua një program i larmishëm aktivitetesh kushtuar administratës publike 2030, me fokus zhvillimin e talenteve, forcimin e lidershipit, integritetin, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe përgatitjen e institucioneve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, i cili u konkretizua përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- *Karriera ime: Administrata zgjedhje e parë*, më datë 29 qershor 2026;
- *Ti je Aset: Nga formimi në ekselencë*, më datë 30 qershor 2026;
- *Përvoja që frymëzon: Vitet që ndërtuan administratën publike*, më datë 2 korrik 2026;
- *Formëso të ardhmen evropiane të Shqipërisë: Karrierë me impakt në shërbimin publik*, më datë 3 korrik 2026;
- *Kampionati i volejbollit: Kampionati i administratës*, më datë 29 qershor - 3 korrik 2026.

Me aktivitetin "**Karriera ime: Administrata zgjedhje e parë**", në datën 29 qershor u çel zyrtarisht edicioni i tretë i Javës së Administratës Publike, një nismë që promovon administratën publike si një zgjedhje moderne karriere, duke vendosur në qendër kapitalin njerëzor si themelin e institucioneve të së ardhmes.

Aktiviteti bëri bashkë përfaqësues të institucioneve publike, partnerë ndërkombëtarë, universitete, studentë dhe profesionistë të rinj për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë që ofron shërbimi publik, në një kohë kur administrata shqiptare po përgatitet për fazën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në fokus të diskutimeve ishte krijimi i një administrate profesionale, të bazuar në meritë, inovacion dhe zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore.

Në kuadër të aktivitetit u organizuan panelet e diskutimit me fokus në temat e mëposhtme:

- Dialogu i Nivelit të Lartë "Një agjendë e re për administratën e së ardhmes", pjesë e të cilit ishin Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministri i Shtetit për

Pushtetin Vendor dhe Drejtori i Departamentit të Administratës Publike. Diskutimi u fokusua në reformat për ndërtimin e një administrate moderne, tërheqjen dhe zhvillimin e talenteve, si dhe në forcimin e kapaciteteve administrative në funksion të integrimit evropian.

- Paneli tematik "Talenti në qendër: Sfidat dhe mundësitë për administratën moderne", ku përfaqësues të institucioneve shqiptare dhe partnerë ndërkombëtarë diskutuan mbi mënyrat se si administrata publike mund të tërheqë, zhvillojë dhe mbajë profesionistët më të mirë. Diskutimet evidentuan rëndësinë e investimit te kapitali njerëzor, zhvillimit profesional, bashkëpunimit me universitetet dhe krijimit të mundësive të reja për brezin e ri në shërbimin publik.

Në kuadër të "Javës së Administratës Publike 2026 - Edicioni III" u zhvillua eventi "**Ti je Aset: Nga Formimi në Ekselencë**", i rikthyer për të tretin vit radhazi si momenti më simbolik i javës. I konceptuar si një ceremoni mirënjohjeje dhe reflektimi, ky aktivitet mblodhi së bashku punonjës të administratës, drejtues institucionesh dhe ekspertë. Gjatë eventit u vlerësuan me trofe simbolikë punonjës të administratës publike për kontributin, profesionalizmin dhe angazhimin e tyre në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike.

Gjithashtu gjatë këtij aktiviteti, u lançua "*Programi i Mirëseardhjes*", një program i dedikuar punonjësve të rinj që i bashkohen administratës publike. Programi i Mirëseardhjes përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt standardizimit të procesit të orientimit të punonjësve të rinj dhe forcimit të kulturës organizative në institucionet publike. Përmes tij, punonjësit e rinj do të njihen me organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, standardet e etikës dhe integritetit, si edhe me vlerat që udhëheqin shërbimin publik.

Më datë 2 korrik 2026, Java e Administratës Publike 2026, vijoi me aktivitetin **"Përvoja që frymëzon: Vitet që ndërtuan administratën publike"**. Aktiviteti iu dedikua vlerësimit të kontributit shumëvjeçar të nëpunësve civilë dhe forcimit të dialogut ndërbrezor në administratën publike. Në qendër të tij ishte bashkëbisedimi ndërbrezor, ku profesionistë me përvojë dhe punonjës të rinj ndanë histori, sfida dhe mësime të fituara gjatë viteve të shërbimit publik. Aktiviteti solli në vëmendje rëndësinë e ruajtjes dhe transmetimit të përvojës profesionale, si një vlerë thelbësore për zhvillimin e një administrate moderne dhe të qëndrueshme.

Gjatë aktivitetit u vlerësuan me Certifikatën e Mirënjohjes punonjës të administratës publike, të cilët, përmes përkushtimit dhe profesionalizmit të tyre ndër vite, kanë dhënë një kontribut të çmuar në forcimin e shërbimit publik dhe të institucioneve shqiptare.

Një nga aktivitetet kryesore të Edicionit III të Javës së Administratës Publike ishte dialogu me Kryeministrin, me temë **"Formëso të ardhmen evropiane të Shqipërisë: Karrierë me impakt në shërbimin publik"**. Në hapje të aktivitetit, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin prezantoi disa nga nismat kryesore të reformës, përfshirë sistemin e ri të kontrollit të performancës së institucioneve, zgjerimin e mundësive të rekrutimit për pozicionet menaxheriale, si dhe masat për forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit.

Në fjalën e tij, kryeministri e cilësoi transformimin e administratës publike si një proces kompleks dhe afatgjatë, duke vlerësuar rolin e nëpunësve publikë në modernizimin e shtetit dhe në ecurinë e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

Programi i aktivitetit vijoi me panelin "*Karriera pa kufij: Administrata shqiptare më pranë Brukselit*", ku Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme theksoi se administrata publike shqiptare ndodhet në një proces të thellë transformimi evropian. Ai nënvizoi se negociatat me Bashkimin Evropian kanë krijuar një brez të ri nëpunësish me ekspertizë të specializuar, ndërsa administrata duhet të vijojë të forcojë profesionalizmin, meritokracinë dhe kulturën institucionale për të përmbushur standardet e një vendi anëtar të BE-së.

Duke vijuar traditën e dy viteve më parë, gjatë "*Javës së Administratës Publike Edicioni III*", u zhvillua **kampionati i volejbollit ndërmjet ministrive dhe Kryeministrisë**, një aktivitet që promovoi bashkëpunimin, frymën e skuadrës dhe një stil jetese aktiv në administratën publike.

Kampionati mblodhi 13 ekipe nga institucione të ndryshme publike, të cilat gjatë gjithë javës sollën në fushë përkushtim, energji, profesionalizëm dhe frymë të fortë bashkëpunimi, duke dëshmuar se sporti është një mënyrë e rëndësishme për të forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe kulturën e punës në ekip.

Pas një jave garash, ekipi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u shpall kampion, duke fituar finalen përballë ekipit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe duke ngritur trofeun e këtij edicioni.

Në kuadër të promovimit të mundësive të karrierës në administratën publike dhe afrimit të të rinjve me shërbimin civil, Departamenti i Administratës Publike mori pjesë në **Panairin e Karrierës 2026 në Universitetin POLIS** dhe në "Ditën e Karrierës 2026 - Hidh hapin tënd" në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Gjatë këtyre aktiviteteve, përfaqësuesit e DAP prezantuan mundësitë konkrete të punësimit në administratën shtetërore, vendet vakante, kriteret dhe procedurat e rekrutimit, si dhe mënyrën e aplikimit online përmes platformës dap.gov.al, duke krijuar kontakte të drejtpërdrejta me studentët dhe duke promovuar administratën publike si një mundësi për zhvillimin e karrierës së të rinjve.

Në kuadër të Reformës së Administratës Publike, DAP ka zhvilluar dhe mbështetur aktivitete të fokusuara në rritjen e performancës, forcimin e integritetit dhe konsolidimin e standardeve profesionale në shërbimin civil. Në Konferencën e **Nivelit të Lartë për Reformën në Administratën Publike**, zhvilluar në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian, projektin EU4GoodGovernance dhe Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, diskutimet u përqëndruan te përmirësimi i menaxhimit të performancës, sistemet e vlerësimit, mekanizmat e motivimit dhe shpërblimit, si dhe delegimi i përgjegjësive.

Paralelisht, DAP ka nxitur forcimin e etikës dhe integritetit përmes bashkëpunimit me botën akademike, duke prezantuar para studentëve të Fakultetit të Drejtësisë zhvillimet, praktikat dhe

mekanizmat e rinj në këtë fushë, në funksion të ndërtimit të një administrate më profesionale, transparente, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt qytetarit, në përputhje me standardet evropiane.

Për Objektivin Specifik 2.2 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar tre tregues performance, ku vetëm një është i matshëm për këtë periudhë monitorimi konkretisht: 2.2.1 *"Rritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 2.2 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
2.2.1 Rritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike.	100%	100%	96.3%	96%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.2[40]				**96%**

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.2 "*Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 96%.[41]

Treguesi 2.2.1 "*Rritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike*" ka qëllim të masë nivelin e fuqizimit të kapaciteteve të punonjësve të administratës publike, për zbatimin në praktikë të rregullave të etikës.

Treguesi synon që ky modul trajnimi të zhvillohet çdo vit për nëpunësit e administratës publike, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike (DAP).

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, në kuadër të zbatimit të planit të trajnimeve për forcimin e integritetit dhe etikës në administratën publike, u zhvilluan trajnimet për Koordinatorët e Etikës

[40] Përllogaritur sipas formulës $\text{NR} = \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$.

[41] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

në institucionet e administratës shtetërore. Sipas planifikimit, ishte parashikuar trajnimi i 300 nëpunësve civilë, ndërsa gjatë periudhës raportuese u trajnuan dhe u certifikuan 289 nëpunës civilë, duke arritur një nivel realizimi prej 96.3% (289/300 × 100).

Trajnimet synuan rritjen e njohurive dhe aftësive të koordinatorëve të etikës për zbatimin e legjislacionit dhe standardeve të etikës në shërbimin civil, promovimin e integritetit institucional, parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të konfliktit të interesit, si dhe forcimin e mekanizmave të raportimit dhe trajtimit të shkeljeve të etikës në institucionet publike.

Pjesëmarrësit që përmbushën kriteret e përcaktuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), në përputhje me programin e trajnimit dhe kërkesat për certifikim, u pajisën me certifikatë përfundimi.

Mosrealizimi i plotë i treguesit lidhet me faktin se 11 nëpunës civilë nga numri i planifikuar nuk arritën të marrin pjesë ose të përfundojnë trajnimin gjatë periudhës raportuese, për shkak të angazhimeve institucionale, ndryshimeve organizative ose pamundësisë për të ndjekur programin e plotë të trajnimit. Përfshirja e tyre është planifikuar në sesionet e radhës të organizuara nga ASPA, me qëllim përmbushjen e plotë të objektivit të treguesit.

Objektivi Specifik 2.3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integrimit evropian të Shqipërisë

Përmbushja e këtij Objektivi Specifik synon forcimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale të nëpunësve në të gjitha nivelet e administratës publike, me qëllim krijimin e kapaciteteve administrative të afta për të përmbushur kërkesat e procesit të integrimit evropian dhe për të mbështetur në mënyrë efektive avancimin e tij. Në këtë kuadër, një rëndësi e veçantë i kushtohet forcimit të rolit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) si institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin profesional të administratës publike, si dhe përmirësimit të kapaciteteve dhe infrastrukturës së nevojshme për ofrimin e trajnimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

Në zbatim të SNRAP 2025-2030, zhvillimi i ASPA-s synon konsolidimin e saj si një qendër ekselence për formimin profesional publik, përmes përmirësimit të modelit organizativ, forcimit të bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike (DAP) dhe rritjes së efektivitetit në identifikimin dhe adresimin e nevojave për trajnim. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë merr zhvillimi i rregullt i Vlerësimit të Nevojave për Trajnime (VNT) dhe përshtatja e programeve të trajnimit me nevojat e administratës dhe prioritetet e politikave publike.

Gjithashtu, forcimi i kapaciteteve të ASPA-s dhe diversifikimi i ofrimit të trajnimeve, përfshirë bashkëpunimin me ofrues të tjerë dhe zhvillimin e programeve për palë të treta, synojnë rritjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të institucionit. Në këtë kuadër, monitorimi i masave dhe

aktiviteteve të parashikuara për Objektivin Specifik 2.3 fokusohet në ecurinë e zhvillimit të kapaciteteve profesionale, përmirësimin e mekanizmave të trajnimit dhe forcimin e rolit të ASPA-s në mbështetje të një administrate publike profesionale dhe të aftë për të përballuar kërkesat e procesit të integrimit evropian.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 2.3 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 7 (shtatë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 2.3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integrimit evropian të Shqipërisë.	
Masa 2.3.1	Hartimi dhe zbatimi efikas i modelit ekonomik të ASPA-s në ofrimin e trajnimeve për të tretët në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator.
Aktiviteti 2.3.1.b	Të paktën 3 paketa trajnimi mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi konsolidohen dhe ofrohen rregullisht në fushat me interes të lartë për të tretët.
Masa 2.3.4	Trajnim i dedikuar dhe periodik për përmirësimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë, me synim menaxhimin efikas të proceseve dhe burimeve njerëzore.
Aktiviteti 2.3.4.a	Dizenjimi i një pakete trajnimi për zhvillimin e lidershipit për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues.
Aktiviteti 2.3.4.b	Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues.
Masa 2.3.5	Thellimi i bashkëpunimit të ASPA-s me institucionet homologe, autoritete të tjera dhe rrjete me ekspertizë në fushën e trajnimit të sektorit publik në BE dhe më gjerë
Aktiviteti 2.3.5.a	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me institucione homologe të vendeve të rajonit, Bashkimit Evropian, si dhe partnerëve të tjerë.
Aktiviteti 2.3.5.b	Forcimi i rrjetëzimit mes ASPA dhe institucioneve homologe.
Masa 2.3.7	Rishikimi i modelit të trajnimit fillestar.
Aktiviteti 2.3.7.a	Hartimi i kurrikulës së rishikuar të trajnimit fillestar.
Aktiviteti 2.3.7.b	Zhvillimi i trajnimeve për nëpunësit në periudhë prove.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 2.3. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në kuadër të hartimit të kurrikulave me interes për palët e treta, ASPA ka hartuar kurrikulën "*Hartimi i Planit të Biznesit*", e cila është konceptuar për t'iu përgjigjur nevojave të këtij grupi të synuar. Gjithashtu me shumë interes janë edhe tematikat "*Procedurat e reja të menaxhimit të Investimeve*", "*Menaxhimi i burimeve njerëzore*", "*Auditimi i performacës*", "*AI në menaxhim*", "*Menaxhimi i projektit*", "*Koncensionet dhe PPP*" etj.

Më herët, në dhjetor 2025, është hartuar edhe kurrikula "*Prokurimi Publik për Operatorët Ekonomikë*", për të cilën janë zhvilluar dy trajnime në klasë me pjesëmarrjen e 37 përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë.

Krahas këtyre, ASPA ofron një gamë të gjerë programesh trajnimi me interes edhe për palët e treta, ndër të cilat tematikat më të kërkuara janë: Antikorrupsioni, Auditimi, Vlerësimi dhe Kontrolli Financiar, Drejtësia Gjinore dhe Mosdiskriminimi, E Drejta e Informimit dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale, Etika dhe Integriteti në Administratën Publike, si dhe tema të tjera të përfshira në Planin Vjetor të Trajnimeve të ASPA-s. Këto programe janë të hapura për të gjitha grupet e interesit që kanë nevojë për zhvillim profesional në këto fusha.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, ASPA ka zhvilluar një sërë trajnimesh për të tretët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë këtyre trajnimeve janë certifikuar 360 pjesëmarrës. Më poshtë gjeni të detajuara modulet e zhvilluara për të tretët:

- Antikorrupsioni;
- Auditi, Vlerësimi dhe Kontrolli Financiar;
- Drejtësia Gjinore dhe Mosdiskriminimi;
- E drejta e Informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale;
- Etika dhe Integriteti në Administratën Publike;
- Etika, integriteti dhe transparenca ne administraten Publike;
- Infrastruktura Kombëtare e Ofrimit të të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore;
- Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative;
- Lidershipi;
- Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fonde;
- Mbrojtja e të Dhënave Personale;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Ndërtimi i Karrierës në Administratën Publike;
- Paketa office;
- Planifikim, Programim dhe Menaxhim Financiar;
- Planifikimi Buxhetor dhe pasqyrat financiare;
- Prokurimi publik;
- Prokurimi publik për operatorët ekonomikë;
- Qeverisja për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE,Statistikë, Të drejtat themelore mbrojtja nga diskriminimi.

Në kuadër të zhvillimit të trajnimeve të dedikuara dhe periodike për përmirësimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë **(masa 2.3.4**), procesi i dizenjimit dhe zhvillimit të paketës së trajnimit është në vijim dhe përbën një fazë paraprake të domosdoshme për realizimin e trajnimeve të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit. Gjatë periudhës së raportimit janë zhvilluar diskutime dhe komunikime të vazhdueshme me palët e përfshira, si dhe janë kontaktuar palë të treta me qëllim identifikimin e mundësive për bashkëpunim në hartimin dhe zbatimin e paketës së trajnimit. Deri në këtë fazë, nuk është marrë konfirmim përfundimtar për vijimin e bashkëpunimit.

Në kushtet kur zhvillimi i trajnimeve kushtëzohet nga përfundimi i paketës së trajnimit, ato nuk mund të realizohen në këtë fazë. Për këtë arsye, vijimi i procesit të zhvillimit të paketës përbën parakusht për nisjen e trajnimeve. Ecuria e mëtejshme e procesit dhe rezultatet e arritura do të pasqyrohen në raportin e monitorimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026.

Në zbatim të masës 2.3.5, ASPA vijon forcimin e bashkëpunimit institucional me partnerë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, me fokus shkëmbimin e eksperiencave, përhapjen dhe përshtatjen e praktikave të mira, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të administratës publike. Gjatë periudhës së raportimit, bashkëpunimi është zhvilluar nëpërmjet pjesëmarrjes në iniciativa, aktivitete dhe programe të përbashkëta me organizata dhe institucione partnere.

Në nivel rajonal dhe evropian, ASPA vijon bashkëpunimin me ReSPA (Regional School of Public Administration) dhe EIPA (European Institute of Public Administration), nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta, programe të zhvillimit profesional dhe iniciativa që synojnë forcimin e kapaciteteve të administratës publike. Ky bashkëpunim kontribuon në shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave, si dhe në njohjen dhe përshtatjen e praktikave bashkëkohore në fushën e administratës publike.

Gjithashtu, ASPA vijon zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me institucione homologe dhe partnerë strategjikë në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve, bashkëpunimi synon mbështetjen e zhvillimit profesional, shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Ndër partnerët ndërkombëtarë dhe rajonalë me të cilët ASPA ka marrëveshje bashkëpunimi përfshihen Lech Kaczyński National School of Public Administration (KSAP), Institut National du Service Public (INSP) - Francë, The Italian National School of Administration (SNA), Ludovika University of Public Service, Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), Instituti i Kosovës për Administratën Publike (IKAP), UNDP dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Në nivel kombëtar, ASPA ka marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Agjencinë e Prokurimit Publik, Agjencinë Kombëtare të Rinisë, Institutin e Statistikave (INSTAT), IDENTITEK SH.A., Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këto

marrëveshje krijojnë një kuadër për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e ekspertizës, në funksion të rritjes së kapaciteteve të administratës publike.

Këto partneritete krijojnë një kuadër për zhvillimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit, shkëmbimin e ekspertizës dhe përvojave profesionale, si dhe zbatimin e iniciativave të përbashkëta. Bashkëpunimi me këta partnerë kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale, si dhe në mbështetjen e proceseve të modernizimit të administratës publike.

Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneriteteve strategjike, ASPA ka zhvilluar një sërë aktivitetesh me synim shkëmbimin e përvojave, transferimin e praktikave më të mira dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike. Ndër zhvillimet kryesore gjatë periudhës raportuese përfshihen:

- Bashkëpunimi ASPA - EIPA, në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Luksemburgut, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen e proceseve të zhvillimit profesional të administratës publike.
- Bashkëpunimi ASPA - INSP - ReSPA - Ambasada e Francës, për organizimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimit për nëpunësit civilë.
- Bashkëpunimi ASPA - Këshilli i Evropës, për mbështetjen e dixhitalizimit të proceseve të trajnimit dhe të vlerësimit të nevojave për trajnim (TNA).
- Bashkëpunimi ASPA - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), në kuadër të projektit EU4Nature, të zbatuar nga UNDP, për zhvillimin e programeve të specializuara të trajnimit në fushën e mjedisit.
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me projektin "Support to EU Financial Assistance Management in Albania (EUSFAM)", me qëllim hartimin e kurrikulave të trajnimit, përgatitjen e grupit të trajnerëve (Training of Trainers) dhe zhvillimin e programeve të trajnimit në fushën e menaxhimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian.
- Anëtarësimi i ASPA në rrjetin NISPAcee (Network of Institutes and Schools of Public Administration in Central and Eastern Europe), i cili forcon pozicionin e institucionit si qendër kombëtare e ekselencës për zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike. Ky anëtarësim krijon mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar, shkëmbim të praktikave më të mira, pjesëmarrje në projekte dhe iniciativa rajonale e evropiane, si dhe mbështet modernizimin e administratës publike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Në zbatim të masës 2.3.7, gjatë periudhë janar-qershor 2026 janë rishikuar dhe përshtatur kurrikulat sipas programit të ri të miratuar. Këshilli Drejtues ka miratuar programin e rishikuar "Prezantimi me Administratën Publike". Ky program trajnimi është hartuar dhe miratuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), mbi bazën e analizës së kryer në kuadër të projektit EU4Good Governance - "*Onboarding and Induction Training in the Albanian Civil Service*", me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe SIGMA-s, si dhe në konsultim me trajnerë dhe ekspertë të fushës. Programi synon zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për

integrimin profesional të nëpunësve civilë, duke mbështetur ushtrimin e detyrës në përputhje me parimet e profesionalizmit, etikës dhe shërbimit ndaj qytetarit.

Programi "*Prezantimi me Administratën Publike*" përbën një komponent themelor të procesit të integrimit profesional të nëpunësve civilë në administratën publike dhe shërben si faza fillestare e integrimit të tyre në institucionin publik. Programi synon të mbështesë përshtatjen e nëpunësve të rinj me mjedisin institucional, kuadrin ligjor dhe mënyrën e funksionimit të administratës publike, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe në ndërtimin e një kulture organizative të bazuar në parimet e etikës, profesionalizmit, integritetit dhe orientimit ndaj shërbimit për qytetarët. Përmes këtij programi, nëpunësit civilë njihen me përgjegjësitë që burojnë nga ushtrimi i funksionit publik, me standardet e sjelljes profesionale dhe me mekanizmat institucionalë që garantojnë funksionimin efektiv të administratës publike.

Programi "*Prezantimi me Administratën Publike*" është i organizuar në 10 module trajnuese, me një kohëzgjatje totale prej 54 orësh. Programi mbulon temat kryesore që lidhen me funksionimin e administratës publike, kuadrin ligjor, etikën dhe integritetin, shërbimin civil, procedurat administrative, integrimin evropian, mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e informimit, informacionin e klasifikuar, si dhe organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Këto module synojnë të pajisin nëpunësit civilë me njohuritë dhe aftësitë bazë të nevojshme për ushtrimin e detyrës në përputhje me standardet e administratës publike.

Qëllimi i programit "*Prezantim me Administratën Publike*" është të mbështesë integrimin profesional të punonjësve civilë të emëruar për herë të parë në shërbimin civil, duke i njohur ata me funksionimin e administratës publike, kuadrin ligjor që rregullon shërbimin civil dhe parimet themelore të ushtrimit të funksionit publik. Programi synon zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve profesionale të nëpunësve civilë, me qëllim që ata të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre në administratën publike, të respektojnë standardet e etikës dhe integritetit në shërbimin publik dhe të kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve publike cilësore dhe të orientuara drejt qytetarit. Përmes këtij programi synohet gjithashtu të lehtësohet procesi i përshtatjes së nëpunësve të rinj me mjedisin institucional dhe të forcohet kultura organizative e administratës publike.

Gjate periudhës 10 - 22 qershor 2026 u zhvillua trajnimi për grupin pilot të programit të rishikuar të trajnimit "Prezantimi me Administratën Publike", ku morën pjesë 41 pjesëmarrës.

Për Objektivin Specifik 2.3 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar tre tregues performance, konkretisht:

- 2.3.1 "*Rritja e kapaciteteve të nivelit menaxherial të administratës publike*";
- 2.3.2 "*Kënaqësia e të trajnuarve me trajnimin (bazuar në formularët e vlerësimeve)*";
- 2.3.3 "*Rëndësia e trajnimeve të ofruara nga ASPA*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 2.3 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
2.3.1 Rritja e kapaciteteve të nivelit menaxherial të administratës publike	100%	100%	88%	88%
2.3.2 Kënaqësia e të trajnuarve me trajnimin (bazuar në formularët e vlerësimeve).	Mbi 80% e pjesëmarrësve vlerësojnë me "Plotësisht të kënaqur" trajnimin e kryer	Mbi 80% e pjesëmarrësve vlerësojnë me "Plotësisht të kënaqur" trajnimin e kryer	90% e pjesëmarrësve vlerësojnë me "Plotësisht të kënaqur" trajnimin e kryer	113%
2.3.3 Rëndësia e trajnimeve të ofruara nga ASPA.	1. 89% e personave të planifikuar janë trajnuar. 2. 75% e trajnimeve të planifkuaara janë zhvilluar	100%	95%	95%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.3[42]				**94%**

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 2.3 "*Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integrimit evropian të Shqipërisë*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 94%.[43]

[42] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

[43] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Treguesi 2.3.1 "*Rritja e kapaciteteve të nivelit menaxherial të administratës publik*". Ka si qëllim të masë nivelin e përmirësimit të aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, me synim menaxhimin efikas të proceseve të punës dhe burimeve njerëzore.

Për vitin 2026, ASPA, në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, ka planifikuar të trajnojë rreth 4000 drejtues të niveleve të ulëta, të mesme dhe të larta në fushën e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale. Për periudhën janar–qershor 2026, plani parashikon trajnimin e rreth 2000 drejtuesve. Deri në fund të kësaj periudhe janë trajnuar 1753 drejtues, duke arritur një nivel realizimi prej 88% të objektivit të planifikuar për gjashtëmujorin e parë. Krahasuar me objektivin vjetor, niveli i realizimit të treguesit deri në fund të periudhës janar–qershor 2026 është rreth 44%.

Niveli i realizimit prej 44% pasqyron ecurinë e zbatimit të Planit Vjetor të Trajnimeve për drejtuesit deri në fund të periudhës janar–qershor 2026. Ky rezultat është në përputhje me planifikimin vjetor, pasi një pjesë e trajnimeve të parashikuara sipas kalendarit të ASPA-së do të zhvillohen gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Për rrjedhojë, realizimi aktual nuk lidhet me problematika në zbatimin e treguesit, por pasqyron shpërndarjen e planifikuar të aktiviteteve gjatë vitit.

Treguesi 2.3.2 "*Kënaqësia e të trajnuarve me trajnimin (bazuar në formularët e vlerësimeve)*" ka si qëllim të masë nivelin e kënaqësisë/pritshmërive së nëpunësve të trajnuar në lidhje me çdo aspekt të trajnimit të kryer, bazuar në formularët e vlerësimit. Matja e nivelit të kënaqësisë së të trajnuarve në lidhje me trajnimin realizohet nëpërmjet anketimeve online, pas çdo trajnimi të zhvilluar nga ASPA. Nëpërmjet plotësimit të formularëve online, të trajnuarit vlerësojnë disa aspekte që lidhen më trajnimin dhe trajnerin.

Performaca mbi kënaqësinë e të trajnuarve u krye nga ASPA sipas metodologjisë së përcaktuar, bazuar në formularët e vlerësimit që plotësohen në fund të çdo trajnimi nga pjesëmarrësit. Sipas metodologjisë kënaqësia e të trajnuarve ka qenë 90%, tejkaluar me 10%.

ASPA vlerësoi në mënyrë sistematike kënaqësinë e pjesëmarrësve përmes formularëve standardë të vlerësimit, të cilët administrohen në përfundim të çdo aktiviteti trajnimor. Formularët plotësohen menjëherë pas zhvillimit të trajnimit dhe synojnë të evidentojnë perceptimin e pjesëmarrësve mbi cilësinë, efektivitetin dhe dobishmërinë e programeve të trajnimit. Kjo metodologji siguron mbledhjen e të dhënave të standardizuara dhe të krahasueshme, të cilat përdoren për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së trajnimeve dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

Formulari i vlerësimit është i strukturuar në katër dimensione kryesore:

1) Vlerësimi i objektivave të trajnimit, ku vlerësohet ndikimi i trajnimit në përditësimin e njohurive, shkëmbimin e përvojave profesionale, zhvillimin e ideve të zbatueshme në punë, zgjidhjen e problematikave profesionale, zhvillimin e aftësive analitike dhe kontributin në përmirësimin e performancës në vendin e punës.

2) Vlerësimi i përmbajtjes së trajnimit, ku analizohen relevanca e tematikës, niveli i informacionit të ri, qartësia e materialeve, mbulimi i aspekteve kryesore të temës, përshtatja me nivelet e njohurive të pjesëmarrësve dhe lidhja e përmbajtjes me nevojat e tyre profesionale dhe personale.
3) Vlerësimi i organizimit dhe logjistikës, ku përfshihen organizimi administrativ i aktivitetit, kohëzgjatja e trajnimit, metodat e interaktivitetit të përdorura gjatë zhvillimit të tij, përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve, si edhe komunikimi dhe promovimi i programeve të trajnimit.
4) Vlerësimi i trajnerëve, ku maten njohuritë profesionale, aftësitë prezantuese, menaxhimi i kohës, përdorimi i metodave interaktive, cilësia e udhëzimeve të ofruara, gatishmëria për t'iu përgjigjur nevojave të pjesëmarrësve dhe koherenca e ushtrimeve praktike me çështjet e punës.

Për periudhën janar-qershor 2026, formularët e vlerësimit janë plotësuar nga 2,935 pjesëmarrës në programet e trajnimit të organizuara nga ASPA. Nga këta, 2,023 pjesëmarrës (68.9%) i përkasin administratës qendrore, 554 pjesëmarrës (18.9%) administratës vendore dhe 358 pjesëmarrës (12.2%) institucioneve të pavarura. Kjo shpërndarje tregon se programet e trajnimit të ASPA kanë mbuluar të gjitha nivelet kryesore të administratës publike, me përfaqësimin më të lartë nga administrata qendrore.

Përpunimi i të dhënave realizohet në mënyrë të agreguar. Për secilin indikator llogaritet nota mesatare dhe përqindja përkatëse, ndërsa rezultatet analizohen sipas katër dimensioneve të vlerësimit. Analiza shërben për evidentimin e pikave të forta dhe identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim, duke mbështetur rishikimin e programeve të trajnimit, metodologjisë së mësimdhënies dhe organizimit të aktiviteteve trajnuese.

Rezultatet e analizës tregojnë një nivel shumë të lartë kënaqësie të pjesëmarrësve në të gjitha dimensionet e vlerësimit. Në aspektin e objektivave të trajnimit, notat mesatare variojnë nga 4.33 deri në 4.60 (86.6%–92.0%), duke treguar se pjesëmarrësit e konsiderojnë trajnimin të dobishëm për përditësimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe zbatimin praktik të tyre në vendin e punës.

Për përmbajtjen e trajnimit, vlerësimet variojnë nga 3.77 deri në 4.60 (75.4%–92.0%). Rezultatet më të larta lidhen me relevancën e tematikave, informacionin e ri të ofruar dhe lidhjen e përmbajtjes me nevojat profesionale të pjesëmarrësve. Indikatori me vlerësimin më të ulët lidhet me qartësinë dhe nivelin e përgjithësisë së përmbajtjes, duke evidentuar nevojën për përshtatje më të madhe të materialeve sipas niveleve të ndryshme të njohurive të pjesëmarrësve.

Në dimensionin e organizimit dhe logjistikës, notat mesatare variojnë nga 4.45 deri në 4.84 (89.0%–96.8%), duke reflektuar një nivel shumë të lartë kënaqësie për administrimin e procesit, organizimin e aktiviteteve, kohëzgjatjen e trajnimeve dhe komunikimin e tyre.

Edhe trajnerët kanë marrë vlerësime shumë të larta, me nota mesatare nga 4.74 deri në 4.81 (94.8%-96.2%). Rezultatet dëshmojnë nivelin e lartë të ekspertizës profesionale, aftësive prezantuese dhe përdorimin efektiv të metodave interaktive, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në procesin e të nxënit dhe në përfshirjen aktive të pjesëmarrësve.
Në tërësi, analiza e formularëve të vlerësimit tregon se pjesëmarrësit shprehin një nivel shumë të lartë kënaqësie me programet e trajnimit të ofruara nga ASPA. Rezultatet e përftuara përdoren si instrument për monitorimin e cilësisë, identifikimin e nevojave për përmirësim dhe zhvillimin e vazhdueshëm të programeve të trajnimit, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përshtatjen e tyre me nevojat e administratës publike.

Treguesi 2.3.3 "*Rëndësia e trajnimeve të ofruara nga ASPA*", ky tregues synon të masë rëndësinë e trajnimeve të ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës, përmes dy komponentëve si më poshtë:

- numri i pjesëmarrësve në trajnime;
- numri i trajnimeve të zhvilluara.

Treguesi - Numri i pjesëmarrësve në trajnim

Për vitin 2026, ASPA, në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, ka planifikuar të trajnojë gjithsej 22600 pjesëmarrës. Për periudhën janar–qershor 2026 ishte planifikuar trajnimi i 11250 pjesëmarrësve, ndërsa deri në fund të kësaj periudhe janë trajnuar 11051 persona. Niveli i realizimit për periudhën janar–qershor është 98%, ndërsa krahasuar me objektivin vjetor realizimi i treguesit arrin në rreth 49%.

Treguesi - Numri i trajnimeve të zhvilluara

Për vitin 2026, ASPA ka planifikuar zhvillimin e gjithsej 300 trajnimeve. Për periudhën janar–qershor ishte planifikuar zhvillimi i 150 trajnimeve, ndërsa janë realizuar 136 trajnime. Si rrjedhojë, niveli i realizimit për gjashtëmujorin e parë është 91%, ndërsa krahasuar me objektivin vjetor realizimi i treguesit arrin në rreth 45%.

Duhet theksuar se Plani Vjetor i Trajnimeve 2026 parashikon zhvillimin e gjithsej 400 aktiviteteve trajnuese, të përbëra nga 250 kurse online, 50 trajnime në klasë dhe 100 sesione informuese. Megjithatë, për qëllime të monitorimit të këtij treguesi merren në konsideratë vetëm 300 trajnimet (kurset online dhe trajnimet në klasë), pasi sesionet informuese nuk janë aktivitete me certifikim dhe, për rrjedhojë, nuk përfshihen në llogaritjen e treguesit të performancës.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 ka vijuar zbatimi i Planit Vjetor të Trajnimeve 2026, i hartuar për të gjithë vitin kalendarik. Aktivitetet trajnuese janë zhvilluar sipas kalendarit të miratuar dhe kanë mbuluar temat kryesore të përcaktuara në plan, duke përfshirë menaxhimin publik, lidershipin, etikën dhe integritetin, shërbimin civil, prokurimin publik, financat publike, hartimin

e politikave publike, digjitalizimin e administratës, ofrimin e shërbimeve publike, si dhe fusha të tjera specifike sipas nevojave të institucioneve.

Trajnimet janë organizuar në forma të ndryshme, si kurse me certifikim, trajnime në klasë dhe sesione informuese, me pjesëmarrjen e nëpunësve dhe punonjësve të administratës qendrore, administratës vendore dhe institucioneve të varësisë. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve është synuar përmirësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të pjesëmarrësve, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, zbatimin më efektiv të legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve.

Niveli i realizimit i raportuar pasqyron ecurinë e zbatimit të Planit Vjetor të Trajnimeve deri në fund të periudhës janar-qershor 2026 dhe duhet parë në kontekstin e planifikimit vjetor. Një pjesë e aktiviteteve trajnuese është planifikuar të zhvillohet gjatë gjashtëmujorit të dytë, sipas kalendarit të miratuar të ASPA-së. Për këtë arsye, realizimi prej rreth 49% i numrit të pjesëmarrësve dhe 45% i numrit të trajnimeve ndaj objektivit vjetor është në përputhje me fazën e zbatimit të planit dhe nuk tregon problematika në implementimin e treguesve.

Objektivi Specifik 2.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ

Përdorimi i sistemeve elektronike për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të punës përbën një komponent të rëndësishëm në modernizimin e administratës publike dhe rritjen e efikasitetit të saj. Në këtë kuadër, përdorimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve elektronike në menaxhimin e burimeve njerëzore synon thjeshtimin dhe përmirësimin e procedurave ekzistuese, rritjen e shpejtësisë dhe efikasitetit të proceseve, si dhe përmirësimin e aksesit dhe administrimit të informacionit.

Njëkohësisht, digjitalizimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore kontribuon në reduktimin e përdorimit të dokumentacionit në format fizik dhe në konsolidimin e praktikave të një administrate më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Në këtë drejtim, masat dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të Objektivit Specifik 2.4 synojnë forcimin e përdorimit të zgjidhjeve elektronike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore, në funksion të një administrate publike më efikase, moderne dhe të digjitalizuar.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 2.4 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 8 (tetë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 2.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ.	
Masa 2.4.1	Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij.
Aktiviteti 2.4.1.a	Implementimi i ndryshimeve në funksionalitet përfshirë ketu dhe korigjimet.
Masa 2.4.2	Gjenerimi automatik në faza i listës së pagave për institucionet publike.
Aktiviteti 2.4.2.a	Përfundimi i zhvillimeve dhe përmirësimeve teknike.
Aktiviteti 2.4.2.b	Implementimi në institucionet e qeverisjes qendrore.
Aktiviteti 2.4.2.c	Implementimi në sistemin arsimor.
Aktiviteti 2.4.2.d	Implementimi i pagave në sistemin shëndetësor.
Aktiviteti 2.4.2.e	Implementimi i pagave në pushtetin vendor.
Masa 2.4.3	Rritja e ndërveprimit virtual mes institucioneve publike, përmes përdorimit të platformave të dedikuara dhe modeleve të miratuara për këtë qëllim.
Aktiviteti 2.4.3.b	Institucione publike përdorin platformën e ndërveprimit.
Masa 2.4.4	Përgatitja dhe zhvillimi i një pakete të plotë trajnimi për të gjitha modulet e HRMIS për drejtoritë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike.
Aktiviteti 2.4.4.b	Zhvillimi i trajnimeve.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 2.4. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në zbatim të masës 2.4.1 "*Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij*", gjatë vitit 2026, janë realizuar në mënyrë të vazhdueshme përmirësime funksionale, të identifikuara si të nevojshme për rritjen e performancës, sigurisë dhe eficiencës së sistemit. Të gjitha përmirësimet e planifikuara për gjysmën e parë të vitit 2026 janë implementuar dhe janë aktualisht funksionale në mjedisin Production. Si shembuj konkretë të përmirësimeve të realizuara mund të përmenden:

- Rivendosja me sukses e komunikimit ndërmjet HRMIS dhe AFMIS (sistemit të Thesarit), në bashkëpunim të ngushtë me Thesarin.
- Rivendosja me sukses e komunikimit ndërmjet e-Raporteve dhe HRMIS, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë.
- Implementimi i mbajtjes së kontributit vullnetar të sigurimeve, në përputhje me legjislacionin tatimor, si dhe përmirësimi i logjikës së vjetërsisë në punë, me qëllim rritjen e saktësisë së përllogaritjeve.

- Realizimi i optimizimeve dhe përditësimeve të tjera jo kritike në komponentë të ndryshëm të sistemit HRMIS, me synim përmirësimin e performancës dhe funksionalitetit të tij.

Përsa i përket progresit në lidhje me "**Gjenerimi automatik në faza i listës së pagave për institucionet publike**", sistemi HRMIS është plotësisht funksional për procesin e gjenerimit të automatizuar të listëpagesave. Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha ministritë, me qëllim finalizimin me sukses të procesit të llogaritjes së pagave për muajt prill, maj dhe qershor. Ky proces ka mundësuar vijimin me gjenerimin dhe testimin e dërgimit elektronik të urdhër-shpenzimeve pranë sistemit të Thesarit, duke kontribuar në përmbylljen e procesit të ekzekutimit të pagave.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, është finalizuar me sukses procesi i llogaritjes së pagave për pothuajse të gjitha ministritë (11/13), ndërsa për një pjesë të tyre është realizuar edhe dërgimi elektronik i urdhër-shpenzimeve pranë sistemit të Thesarit (3/13). Procesi vijon për institucionet që janë ende në fazat e testimit, validimit dhe/ose finalizimit të integrimit me sistemin e Thesarit, me synim përmbylljen e plotë të ciklit të automatizuar të listëpagesës.

Përsa i përket **implementimit në institucionet e qeverisjes qendrore**, në kuadër të procesit të integrimit HRMIS–SIFQ, testimet për institucionet e planifikuara, konkretisht 13 institucione (12 ministri dhe Kryeministria), kanë përfunduar me sukses për 11 prej tyre. Për 2 institucionet e mbetura, procesi i testimit vijon me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve teknike dhe funksionale të evidentuara, përmes verifikimeve dhe ndërhyrjeve përkatëse teknike.

Në përfundim të testimeve të suksesshme për procesin e urdhër-shpenzimeve, është realizuar kalimi në mjedisin Production për një nga ministritë, duke mundësuar verifikimin e mbylljes së plotë të ciklit, nga gjenerimi i urdhër-shpenzimit në HRMIS deri në përpunimin e tij në sistemin e Thesarit. Për ministritë e tjera, vijimi i procesit do të realizohet sipas planit të dakordësuar gjatë muajve korrik dhe gusht, duke përfshirë përfundimin e testimeve, adresimin e çështjeve të evidentuara dhe kalimin gradual në mjedisin Production.

Ndërsa në lidhje me **implementimin në sistemin arsimor**, procesi i plotësimit dhe përditësimit të të dhënave në sistemin HRMIS ka përfunduar për të gjithë punonjësit e institucionit në nivel qendror (AKAP).

Në nivel rajonal, 4 nga 5 DRAP-e (Tiranë, Fier, Lezhë dhe Korçë) kanë përfunduar procesin e hedhjes dhe përditësimit të të dhënave të punonjësve në sistemin HRMIS. DRAP Durrës vijon procesin e plotësimit dhe përditësimit të të dhënave të administratës.

Në nivel vendor, 39 nga 52 ZVAP-e kanë përfunduar procesin e hedhjes dhe përditësimit të të dhënave në sistemin HRMIS, ndërsa 13 ZVAP vijojnë punën për përmbylljen e procesit. Vështirësitë e evidentuara lidhen kryesisht me çështje teknike, kapacitetet njerëzore në dispozicion dhe nevojën për caktimin ose përforcimin e stafit përgjegjës për administrimin e të dhënave.

Në tërësi, ecuria e zbatimit të masës 2.4.2.c paraqitet pozitive, duke reflektuar angazhimin e institucioneve për plotësimin, përditësimin dhe administrimin e të dhënave të punonjësve në sistemin HRMIS.

Çështjet e evidentuara në njësitë që nuk e kanë përfunduar ende procesin janë në ndjekje të vazhdueshme, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, me qëllim adresimin e problematikave teknike dhe organizative dhe përmbylljen e procesit në të gjitha nivelet e administrimit të sistemit arsimor.

Në lidhje me **implementimin e pagave në sistemin shëndetësor dhe në pushtetin vendor**, nuk ka përfunduar ende faza pilot dhe plotësimi i dosjeve, e cila synon të mundësojë validimin e funksionaliteteve të implementuara, identifikimin e kërkesave shtesë dhe adresimin e nevojave për përmirësime teknike dhe funksionale, përpara kalimit në fazën e përdorimit të zgjeruar të platformës.

Përsa i përket **masës 2.4.3 "*Rritja e ndërveprimit virtual mes institucioneve publike, përmes përdorimit të platformave të dedikuara dhe modeleve të miratuara për këtë qëllim*"**, Platforma e bashkëpunimit dhe ndërveprimit "Colab" është aktualisht e aksesueshme dhe ndodhet në fazën e testimit të brendshëm, me akses të kufizuar për nëpunësit e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, DAP ka vijuar punën për planifikimin, konfigurimin dhe testimin e platformës "Colab", e cila synon të krijojë një mjedis të dedikuar për mbështetjen, standardizimin dhe digjitalizimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike.

Në këtë fazë, fokusi kryesor është vendosur në testimin dhe validimin e funksionaliteteve të:

- Modulit të Vlerësimit të Performancës, për mbështetjen e procesit të vlerësimit dhe administrimit të të dhënave të performancës së nëpunësve;
- Modulit të Lejeve (HR), për menaxhimin, administrimin dhe gjurmimin e proceseve të aplikimit dhe miratimit të lejeve të punonjësve.

Faza pilot synon të mundësojë validimin e funksionaliteteve të implementuara, identifikimin e kërkesave shtesë dhe adresimin e nevojave për përmirësime teknike dhe funksionale, përpara kalimit në fazën e përdorimit të zgjeruar të platformës.

Ndërsa në zbatim të **masës 2.4.4 "*Përgatitja dhe zhvillimi i një pakete të plotë trajnimi për të gjitha modulet e HRMIS për drejtoritë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike*"**, është hartuar në nëntor 2025 kurrikula specifike për HRMIS me titull "*Administrimi dhe Menaxhimi i të Dhënave ne Regjistrin Qendror të Personelit*". Shkolla Shqiptare e Administratës Publike gjatë periudhës janar - qershor 2026 ka zhvilluar 3 kurse online për modulin "*Administrimi dhe Menaxhimi i të Dhënave në Regjistrin Qëndror të Personelit*" ku janë trajnuar 62 pjesëmarrës.

Indikatori i këtij objektivi specifik ka një frekuencë vjetore matjeje dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt matjeje gjatë kësaj periudhe raportimi. Për këtë arsye, në këtë fazë nuk mund të vlerësohet progresi në lidhje me realizimin e treguesve të përcaktuar. Vlerësimi i tyre do të bëhet në përputhje me frekuencën e parashikuar të matjes dhe do të pasqyrohet në raportimin përkatës vjetor.

QËLLIMI I POLITIKËS III - OFRIMI I SHËRBIMEVE DHE DIGJITALIZIMI

Qëllimi i Politikës III, synon përmirësimin e vazhdueshëm të aksesit dhe cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset, përmes ofrimit të tyre nëpërmjet një portali të vetëm dhe kanaleve të integruara të shërbimit. Kjo qasje synon thjeshtimin dhe standardizimin e proceseve administrative, reduktimin e barrës dhe kostove administrative për përdoruesit, si dhe rritjen e efikasitetit dhe lehtësisë së ndërveprimit ndërmjet qytetarëve, bizneseve dhe administratës publike. Në këtë kuadër, përmirësimi i vazhdueshëm i aksesit dhe përvojës së përdoruesit në marrjen e shërbimeve publike synon të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe besimit ndaj institucioneve publike, si dhe në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin ekonomik.

Komponentët e kësaj shtylle adresojnë përmirësimin e platformës e-Albania, ri-inxhinierimin e shërbimeve përmes thjeshtimit të procedurave administrative, si dhe ndërtimin dhe përsosjen e aftësive digjitale të shoqërisë së gjerë. Masat janë parashikuar nën këtë shtyllë të Strategjisë synojnë të ofrojnë shërbime digjitale gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe bizneset.


Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë realizuar masat dhe aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme.

Qëllimet e Politikës	**Masat dhe Aktivitetet**	**Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve**			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M e I-rë të 2026	**Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[44]**	**Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[45]**	**Masa dhe aktivitete të pazbatuara[46]**
Qëllimi i Politikës III	Masa	7	4	2	1
	Aktivitete	9	6	2	1

[44] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[45] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[46] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.

Rezulton se, nga 7 masa dhe 9 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025–2027 për Qëllimin e Politikës III "Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi", gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, janë zbatuar plotësisht 4 masa dhe 6 aktivitete, pjesërisht 2 masa dhe 2 aktivitete, ndërsa 1 masë dhe 1 aktivitet rezultojnë të pazbatuara.

Ecuria e realizimit të masave dhe aktiviteteve të paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Qëllimi i Politikës III përfshin gjithsej 2 tregues performance, nga të cilët, referuar Aneksit 2 të SNRAP 2025-2030 "Pasaporta e Treguesve të Performancës", nuk janë të matshëm për këtë periudhë monitorimi, duke pasur parasysh frekuencën vjetore të matjes së tyre.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar nivelin e progresit, në përqindje, për secilin objektiv specifik të Qëllimit të Politikës III, bazuar në nivelin e realizimit të masave përkatëse.

Objektivi Specifik (OS)	Shkalla e realizimit të OS sipas masave.[47]
OS 3.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.	87%

[47] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%

OS 3.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale përmes zbatimit të masave që sigurojnë arritjen e kompetencave bazë digjitale për nxënësit, përmirësojnë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve elektronike për qytetarët, dhe fuqizojnë mundësuesit teknologjikë në sektorin publik.	53%
Zbatueshmëria e Qëllimit të Politikës III	**70%**

Nga analiza e mësipërme rezulton se niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës III, i vlerësuar mbi bazën e realizimit të masave dhe aktiviteteve, është 70%.

Në vijim paraqitet analiza e masave dhe aktiviteteve të monitoruara gjatë periudhës raportuese, në funksion të vlerësimit të progresit në zbatimin e Objektivave Specifikë të Qëllimit të Politikës III.

Objektivi Specifik 3.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi

Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike përbën një komponent të rëndësishëm të modernizimit të administratës publike dhe përmirësimit të aksesit të qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet administrative. Në këtë kuadër, ofrimi i shërbimeve publike përmes platformës "e-Albania" ka synuar zhvendosjen e proceseve nga ofrimi tradicional në sportele drejt ofrimit online, duke reduktuar nevojën për ndërveprim fizik me administratën, me përjashtim të rasteve kur prania fizike e qytetarit është e domosdoshme.

Në funksion të këtij objektivi, vijimi i procesit të digjitalizimit dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike synon rritjen e aksesueshmërisë, eficiencës dhe cilësisë së shërbimeve publike, si dhe thjeshtimin e ndërveprimit ndërmjet administratës publike, qytetarëve dhe bizneseve. Masat dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të Objektivit Specifik 3.1 fokusohen në konsolidimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve publike në mënyrë elektronike.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 3.1 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 3 (tre) masa dhe 4 (katër) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 3.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.	
Masa 3.1.1	Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij. Ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në aksesueshmërinë dhe përvojën e përdoruesit (UX).

Aktiviteti 3.1.1.a	Përmirësimi i portalit e-Albania web dhe mobile me funksionalitete të reja dhe në përputhje me standardet e pranueshme të aksesueshmërisë.
Masa 3.1.2	"Riorganizimi i shërbimeve elektronike me standarde të larta, të personalizuara dhe të bazuara në ngjarje proaktive.
Aktiviteti 3.1.2.a	Riorganizimi i portalit e-Albania sipas modelit “life events”.
Aktiviteti 3.1.2.b	Mekanizmi i përshtypjeve dhe opinioneve të përdoruesit për shërbimet elektronike plotësisht funksional (përdorimi i teknologjive të reja për mbledhjen dhe analizimin automatik të përgjigjeve).
Masa 3.1.3	“Përditësimi i infrastrukturës bazë të shërbimeve elektronike dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG).
Aktiviteti 3.1.3.a	Rritje e numrit të të dhënave të shkëmbyera midis institucioneve publike dhe numrit të transaksioneve përmes Platformës së Ndërveprimit, në mënyrë që të ofrohen shërbime më të shpejta, më të përshtatura dhe, sipas rastit, më të personalizuara.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 3.1. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në zbatim të masës 3.1.1, **“*Ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në aksesueshmërinë dhe përvojën e përdoruesit (UX)*”**, gjatë periudhës së raportimit janë ndërmarrë një sërë hapash dhe aktivitetesh në funksion të përmirësimit të aksesueshmërisë, funksionalitetit dhe përvojës së përdoruesit në portalin e-Albania.

Më 18 maj 2026 u lançua platforma e përditësuar e-Albania 2.0, një hap i ri në transformimin e mëtejshëm digjital të shërbimeve publike online në Shqipëri. Platforma e re sjell një eksperiencë më efikase, më të shpejtë dhe më të aksesueshme për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe për personat me aftësi të kufizuara, duke vendosur standarde të reja në ofrimin e shërbimeve elektronike. Risitë e e-Albania 2.0 janë si më poshtë:

- Infrastrukturë tërësisht e modernizuar;
- Aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara;
- Menaxhim i autorizimeve për delegimin e përkohshëm të përdorimit të shërbimeve publike online për bizneset;
- Optimizim i procesit të autentikimit.

Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës publike dhe rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset.

Lidhur me aksesueshmërinë, në kuadër të Programit “*Përmirësimi i aksesit universal në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet teknologjisë (Govtech)*” që AKSHI po zbaton me Bankën

Botërore, pjesë e së cilit është edhe përshtatja e platformës qeveritare e-Albania për personat me aftësi të kufizuar, AKSHI ka marrë ekspertizë nga një ekspert i jashtëm. Ai ka kryer testime si dhe ka dhënë rekomandime për përmirësime, të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë implementuar në e-Albania 2.0.

Në zbatim të masës 3.1.2, **"*Riorganizimi i shërbimeve elektronike me standarde të larta, të personalizuara dhe të bazuara në ngjarje proaktive*"**, gjatë periudhës së raportimit janë ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me lancimin e ri të portalit e-Albania, e-Albania 2.0 është riorganizuar sipas modelit "*life events*", duke i grupuar shërbimet bazuar në "*ngjarje të jetës*". Aktualisht, janë nivel 2, (informative) dhe po punohet për t'u implementuar në nivel 4, (të ekzekutueshme). Më poshtë janë gjashtë "*life events*" që janë publikuar në e-Albania 2.0:

- Kërkimi për punë;
- Ndryshimi i vendbanimit;
- Lindja e një fëmije;
- Hapja e një biznesi;
- Plani i pensionit;
- Aftësia ndryshe (disability).

Po punohet që "Life events" të jenë një model i ri organizimi i shërbimeve elektronike, ku qytetari apo biznesi nuk aplikon më për shërbime të ndara në e-Albania, por bën një aplikim të vetëm online dhe ky transmetohet në të gjitha sistemet elektronike të institucioneve që ofrojne shërbime pjese të "*life-event*". Në këtë kuadër, sipas të dhënave dhe dokumenteve që ju nevojiten, secili institucion ndjek proceset e tij, dhe qytetari apo biznesi merr vetëm një përgjigje/dokument administrativ në fund.

Në kuadër të riorganizimit të portalit e-Albania sipas modelit "life events", është në proces vlerësimi "*as-is–to-be*" dhe hartimi i planit të rikonceptimit për 6 ngjarjet e jetës në "*Nivelin 4*". Grupi i Punës për "*Ngjarjet e jetës*" po punon aktivisht për përfundimin e këtij procesi.

Në kuadër të aktivitetit 3.1.2.b, **"*Mekanizmi i përshtypjeve dhe opinioneve të përdoruesit për shërbimet elektronike plotësisht funksional (përdorimi i teknologjive të reja p ër mbledhjen dhe analizimin automatik të përgjigjeve)*"**, me lançimin e ri të portalit e-Albania 2.0 ky mekanizëm është plotësisht funksional dhe gjendet te rubrika "*Vlerësime*" në e-Albania.

Portali i ri e-Albania 2.0 ka një mekanizëm plotësisht funksional të feedback-ut, i cili u mundëson qytetarëve dhe bizneseve të dërgojnë komente dhe vlerësime për shërbimet elektronike përmes kanaleve të ndryshme (formularë online, email), përfshirë edhe mundësinë e komenteve anonime. Mekanizmi mbështetet në teknologji të reja për mbledhjen, kategorizimin dhe analizimin automatik të reagimeve, si dhe për ndjekjen e statusit të tyre në kohë reale. Çdo koment pajiset me

një ID unike për gjurmim, drejtohet te institucionet përgjegjëse dhe sistemi është i aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në zbatim të masës 3.1.3 "*Përditësimi i infrastrukturës bazë të shërbimeve elektronike dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG)*", është realizuar përmirësimi për Platformën Qeveritare të Ndërveprimit për të siguruar ofrimin e sigurt dhe të besueshëm të shërbimeve të avancuara dixhitale. Kjo i është përmbajtur një dizajni modern të arkitekturës së mikroshërbimeve të mundësuar nga cloud computing, e cila mbështet zgjerueshmërinë e sistemit të decentralizuar, shkallëzueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e lartë, si dhe aftësinë për t'u përballur me rritje të parregullta të përdorimit të lartë. Gjithashtu, është bërë i mundur forcimi i ndërveprimit dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG) përmes dy nën-aktiviteteve: (i) modernizimin dhe miratimin e një arkitekture të re zgjidhjeje softuerike te Platformes Qeveritare te Nderveprimit (GG) për të lehtësuar ndërveprimin e përmirësuar dhe ofrimin e shërbimeve dixhitale; dhe (ii) mbështetjen e shtimit të sistemeve të reja qeveritare back-end të lidhura me Platformen Qeveritare te Nderveprimit (GG) për të forcuar ndërveprimin dhe për të përmirësuar më tej shkëmbimin e të dhënave.

Platforma e re është vënë në funksion me daljen live të e-Albania 2.0, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve në mënyrë më të shpejtë dhe më të përshtatur me nevojat e përdoruesve. Në muajt në vijim do të mundësohet vlerësimi i ndikimit të këtij përmirësimi, nëpërmjet matjes dhe krahasimit të numrit të transaksioneve të kryera përmes platformës me të dhënat e periudhave të mëparshme.

Indikatorët e këtij objektivi specifik kanë frekuencë vjetore matjeje dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt matjeje gjatë kësaj periudhe raportimi. Për këtë arsye, në këtë fazë nuk mund të vlerësohet progresi në lidhje me realizimin e treguesve të përcaktuar. Vlerësimi i tyre do të bëhet në përputhje me frekuencën e parashikuar të matjes dhe do të pasqyrohet në raportimin përkatës vjetor.

Objektivi Specifik 3.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale përmes zbatimit të masave që sigurojnë arritjen e kompetencave bazë digjitale për nxënësit, përmirësojnë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve elektronike për qytetarët, dhe fuqizojnë mundësuesit teknologjikë në sektorin publik

Objektivi Specifik 3.2 synon rritjen dhe zhvillimin e aftësive digjitale të shoqërisë, duke kontribuar në forcimin e kompetencave digjitale që në arsimin parauniversitar, përmirësimin e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve elektronike, si dhe zgjerimin e mundësive për përfshirjen e grupeve të ndryshme të popullsisë në transformimin digjital. Në këtë kuadër, masat dhe aktivitetet e parashikuara synojnë forcimin e kompetencave bazë digjitale përmes implementimit të laboratorëve SMART në arsimin parauniversitar publik, përmirësimin e aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset dhe rritjen e aksesit në shërbimet elektronike për grupet e synuara.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 3.2 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 5 (pesë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 3.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale përmes zbatimit të masave që sigurojnë arritjen e kompetencave bazë digjitale për nxënësit, përmirësojnë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve elektronike për qytetarët, dhe fuqizojnë mundësuesit teknologjikë në sektorin publik.	
Masa 3.2.1	Forcimi i kompetencave bazë minimale të aftësive digjitale në arsimin parauniversitar.
Aktiviteti 3.2.1.a	Implementimi i laboratorëve "SMART" në të gjithë vendin.
Masa 3.2.2	Përmirësimi i aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.
Aktiviteti 3.2.2.c	Ngritja e platformës së asistentit virtual dhe sistemit helpdesk.
Masa 3.2.3	Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike për target-grupe të caktuara.
Aktiviteti 3.2.3.b	"Upgrade i Portalit e-Albania në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për aksesueshmërinë e përmbajtjes së web-it (WCAG 2.1/web Content Accessibility Guidelines).
Aktiviteti 3.2.3.c	Ngritja e platformës së asistentit virtual dhe sistemit helpdesk.
Masa 3.2.4	"Forcimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Data Governance.
Aktiviteti 3.2.4.a	Implementimi i Platformës Qeveritare të Ndërveprimit 2.0 dhe site sekondare - Forcimi i mbrojtjes së të dhënave dhe ndërveprimit.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 3.2. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në lidhje me masat 3.2.1 dhe 3.2.2, procesi ndodhet në fazën e finalizimit të Termave të Referencës (ToR). Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur përditësime të mëtejshme përtej këtij procesi, ndërsa vijimi i aktiviteteve do të raportohet në përputhje me ecurinë e procesit të finalizimit dhe hapat pasues.

Në lidhje me aktivitetin 3.2.3.a "*Transpozimi i Direktivës (BE) 2016/2102 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 tetor 2016, mbi aksesin në faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të institucioneve publike*" projektvendimi "*Mbi aksesin e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik*", vlerësohet se legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nuk përmban një dispozitë deleguese që t'i japë kompetencë për të propozuar miratimin e një akti nënligjor në nivel vendimi të Këshillit të Ministrave për këtë çështje. Për rrjedhojë, çdo akt që do të mund të nxirrej nga AKSHI në kuadër të kompetencave aktuale do të kufizohej në formën e një

udhëzimi teknik, i cili, për shkak të mungesës së një baze të qartë ligjore deleguese, nuk do të kishte fuqi detyruese dhe zbatim të përgjithshëm për organet e sektorit publik.

Në këtë kuadër, pas konsultimeve ndërinstitucionale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vlerësuar se transpozimi dhe harmonizimi i plotë i legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë duhet të realizohet nëpërmjet një projektligji të posaçëm, i cili do të krijojë bazën e nevojshme ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatimin e detyrueshëm të kërkesave të aksesueshmërisë.

Projektligji do të hartohet si nismë e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Drejtësisë, me bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila do të kontribuojë në hartimin e dispozitave teknike dhe standardeve të nevojshme për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë së faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik.

Në kuadër të aktivitetit 3.2.3.b "*Upgrade i Portalit e-Albania në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për aksesueshmërinë e përmbajtjes së web-it*", integrimi i standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara eshte realizuar me daljen live të e-Albania 2.0, në datën 18 maj 2026. Portali e-Albania 2.0 ofron opsione aksesueshmërie të përshtatshme për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Opsionet janë të dukshme për akses në të gjitha faqet, si "Lexuesi i Ekranit", "Kontrasti i Ngjyrave", "Madhësia e Shkronjës" etj. Klikimi mbi secilën prej tyre ndryshon pamjen e faqes në nivele të ndryshme, p.sh., kontrast i lartë ngjyrash, mesatar, i ulët. Opsionet grupohen gjithashtu sipas profileve të aksesueshmërisë për përdorim më të shpejtë. Përmirësimi është një proces i vazhdueshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë.

Në kuadër të aktivitetit 3.2.3.c, përmirësimi i shërbimit dhe aksesit ndaj qytetarëve, arkitektura e modernizuar e shërbimit ndaj qytetarëve për ta bërë më të lehtë aksesin e shërbimeve dhe asistencës dixhitale, duke përfshirë grupet e synuara vulnerabël është realizuar me daljen live të e-Albania 2.0, në datë 18 maj 2026.

Portali e-Albania 2.0 ofron opsione aksesueshmërie të përshtatshme për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Arkitektura e modernizuar e shërbimeve ndaj qytetarëve përmirëson aksesin dhe përdorshmërine e shërbimeve elektronike, duke integruar standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë dhe një qasje gjithëpërfshirëse për grupet vulnerabël. Përmes përmirësimeve të vazhdueshme teknike dhe zhvillimit të e-Albania 2.0, po garantohet asistencë digjitale më e lehtë, më e barabartë dhe më e përshtatur për personat me aftësi të kufizuara dhe përdoruesit me nevoja të veçanta.

Bazuar në Programin "Rritja e barazisë në përdorimin e shërbimeve publike me standard të lartë përmes teknologjive në qeverisje (GovTech)" me përmirësimin e portalit e-Albania synohet ndër të tjera edhe integrimi i standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara që portali të jetë lehtësisht i përdorshëm prej tyre. Portali e-Albania 2.0 ofron opsione

aksesueshmërie të përshtatshme për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Opsionet janë të dukshme për akses në të gjitha faqet, si: Lexuesi i ekranit; Kontrasti i ngjyrave; Madhësia e shkronjës etj. Klikimi mbi secilën prej tyre ndryshon pamjen e faqes në nivele të ndryshme, p.sh., kontrast i lartë ngjyrash, mesatar, i ulët. Opsionet grupohen gjithashtu sipas profileve të aksesueshmërisë për përdorim më të shpejtë.

Në kuadër të aktivitetit 3.2.4.a "*Implementimi i Platformës Qeveritare të Ndërveprimit 2.0 dhe site sekondare - Forcimi i mbrojtjes së të dhënave dhe ndërveprimit*", shërbimet elektronike janë zhvilluar duke aplikuar arkitekturat moderne sic është ajo e mikroshërbimeve, duke siguruar që shërbimet të zhvillohen në mënyrë të shpejtë, pavarësisht kompleksitetit të tyre, dhe përmirësimet e nevojshme bëhen shpesh dhe shpejt, sa herë është e nevojshme, pa shkaktuar ndërprerje të shërbimit. Shërbimet elektronike janë përmirësuar me daljen live të e-Albanias 2.0, më datë 18 maj 2026.

Gjithashtu, e-shërbimet janë zhvilluar duke aplikuar arkitekturat moderne siç është ajo e mikroshërbimeve, duke siguruar që shërbimet të zhvillohen në mënyrë të shpejtë, pavarësisht kompleksitetit të tyre, dhe përmirësimet e nevojshme bëhen shpesh dhe shpejt, sa herë është e nevojshme, pa shkaktuar ndërprerje të shërbimit.

Indikatorët e këtij objektivi specifik kanë frekuencë vjetore matjeje dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt matjeje gjatë kësaj periudhe raportimi. Për këtë arsye, në këtë fazë nuk mund të vlerësohet progresi në lidhje me realizimin e treguesve të përcaktuar. Vlerësimi i tyre do të bëhet në përputhje me frekuencën e parashikuar të matjes dhe do të pasqyrohet në raportimin përkatës vjetor.

QËLLIMI I POLITIKËS IV - ORGANIZIMI, LLOGARIDHËNIA DHE MBIKËQYRJA E ADMINISTRATËS

Qëllimi i Politikës IV synon konsolidimin e një administrate publike efikase, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore, përmes forcimit të strukturave dhe kapaciteteve organizative, si dhe përmirësimit të mekanizmave të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes. Në këtë kuadër, një rëndësi e veçantë i kushtohet forcimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë në proceset vendimmarrëse, si dhe konsolidimit të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të këtij Qëllimi të Politikës synojnë përmirësimin e funksionimit institucional, forcimin e llogaridhënies dhe rritjen e efektivitetit të proceseve administrative. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve është synuar gjithashtu forcimi i besimit të qytetarëve te institucionet publike, përmes një administrate më transparente, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt rezultateve.


Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë realizuar masat dhe aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M e I-rë të 2026	**Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[48]**	**Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[49]**	**Masa dhe aktivitete të pazbatuara[50]**
Qëllimi i Politikës IV	Masa	13	5	5	3
	Aktivitete	22	10	6	6

Rezulton se, nga 13 masa dhe 22 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027 për Qëllimin e Politikës IV "Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës", gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe 10 aktivitete, pjesërisht 5 masa dhe 6 aktivitete, ndërsa 3 masa dhe 6 aktivitete rezultojnë të pazbatuara.

Ecuria e realizimit të masave dhe aktiviteteve të paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

[48] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[49] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[50] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.



Qëllimi i Politikës IV përfshin gjithsej 11 tregues performance, nga të cilët, referuar Aneksit 2 të SNRAP 2025-2030 "Pasaporta e Treguesve të Performancës", 4 tregues janë të matshëm për këtë periudhë monitorimi, duke pasur parasysh frekuencën vjetore të matjes së tyre.

Për treguesit e performancës të QPI IV në tabelën e mëposhtme paraqitet realizueshmëria e tyre.

Qëllimi i Politikës IV	Totali i Treguesve e performancës	Totali i Treguesve e Performancës të matur për periudhën janar-qershor 2026	Realizimi i Treguesve të Performancës		
			Vlera e synuar është realizuar plotësisht.[51]	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht.[52]	Vlera e synuar nuk është e realizuar.[53]
	11	4	2	1	1

Nga 4 treguesit e performancës të matur për periudhën e raportimit për Qëllimin e Politikës IV "Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës", vlera e synuar është arritur plotësisht për 2 (dy) tregues performance, për 1 (një) tregues është arritur pjesërisht, ndërsa për 1 (një) tregues nuk është arritur vlera e synuar.

[51] Që është realizuar në shkallën 100 për qind.
[52] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 99% për qind.
[53] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar nivelin e progresit, në përqindje, për secilin objektiv specifik të Qëllimit të Politikës IV, bazuar në ecurinë e treguesve të performancës dhe nivelin e realizimit të masave përkatëse.

Objektivi Specifik (OS)	Shkalla e realizimit të OS sipas masave.[54]	Shkalla realizimit sipas treguesve të performancës.[55]
OS 4.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase	0%	Nuk matet
OS 4.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre	50%	81%
OS 4.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut	67%	100%
OS 4.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë	70%	63%
Zbatueshmëria e Qëllimit të Politikës IV	**47%**	**81%**

Nga analiza e mësipërme rezulton se niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës IV, i vlerësuar mbi bazën e performancës së treguesve përkatës, është 80%.

Në vijim paraqitet analiza e masave të monitoruara gjatë periudhës raportuese, së bashku me ecurinë e treguesve të performancës përkatës, në funksion të vlerësimit të progresit në zbatimin e Objektivave Specifikë të Qëllimit të Politikës IV.

[54] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}}$ x 100%.

[55] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$ x 100%.

Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase

Objektivi Specifik 4.1 synon përmirësimin dhe qartësimin e organizimit institucional të administratës shtetërore, përmes përcaktimit të qartë të tipologjive të institucioneve të varësisë dhe shmangies së mbivendosjeve ndërmjet tyre. Një nga sfidat e identifikuara në këtë drejtim lidhet me ekzistencën e institucioneve që pozicionohen në kufijtë e dy ose më shumë tipologjive, duke krijuar nevojën për një klasifikim më të qartë dhe koherent të tyre. Përcaktimi i kritereve të qarta dhe të unifikuara për secilën tipologji të institucioneve të varësisë synon të kontribuojë në një organizim institucional më koherent, në qartësimin e përgjegjësive dhe kompetencave dhe në rritjen e efektivitetit të administratës shtetërore.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 4.1 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 1 (një) masë dhe 1 (një) aktivitet, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase.	
Masa 4.1.2	Plotësimi i kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të rishikuar.
Aktiviteti 4.1.2.b	Miratimi i draft akteve nga Këshilli i Ministrave.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 4.1. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Një moment i rëndësishëm në avancimin e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të progresit lidhur me organizimin dhe llogaridhënien e administratës shtetërore është miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë, më datë 2 korrik 2026, i ligjit "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"*". Projektligji iu përcoll Kuvendit pas miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 10.6.2026.

Ndryshimet synojnë të forcojnë organizimin, funksionimin dhe llogaridhënien e administratës shtetërore. Kuadri ligjor i rishikuar parashikon, ndër të tjera, masa për përmirësimin e arkitekturës institucionale të administratës shtetërore, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe forcimin e eficiencës dhe koherencës së sistemit administrativ. Ndryshimet kryesore të ligjit përfshijnë:

1) Krijimin e sistemit efektiv të mbikëqyrjes/llogaridhënies për institucionet e varësisë

Kuadri i rishikuar ligjor prezanton një sistem të detyrueshëm, të uniformizuar të mbikëqyrjes/llogaridhënies së institucioneve të varësisë bazuar në rezultatet/performancën e institucionit, që konsiston në:

i. mbikëqyrjen profesionale nga një njësi e shërbimit civil në kuadër të ministrisë mëmë;
ii. instrumente të strukturuara në mënyrë eksplicite të planifikimit, raportimit dhe vlerësimit, që përfshijnë: a) një plan vjetor performance që dakordësohet ndërmjet institucionit dhe ministrisë; b) një raport vjetor performance që hartohet nga institucioni; c) vlerësimin dhe deklaratën vjetore të performancës që përgatitet nga ministria; dhe
iii. transparencë e plotë (bërja publike) e të gjitha instrumenteve të mësipërm.

Ky rregullim adreson gjithashtu rekomandimin e OECD/SIGMA për përmirësimin e sistemit tërësor të mbikëqyrjes institucionale nga ministria tek institucionet e varësisë.

2) Mirëpërcaktimin e tipologjisë institucionale

Ligji i ndryshuar përcakton rregulla që qartësojnë tipologjinë e institucioneve publike. Këto ndryshime thjeshtojnë organizimin e institucioneve, duke i përshtatur tipin e institucionit funksioneve që ai kryen dhe duke synuar funksionimin më të mirë të institucioneve, përmirësimin e punës në shërbim të qytetarit dhe uljen e shpenzimeve publike për menaxhimin e tyre. Konkretisht, ligji parashikon dy lloje institucionesh joministrore:

i. Institucionet klasike të varësisë, ku përfshihen edhe agjencitë autonome ekzistuese;
ii. Agjencitë autonome, si një kategori e veçantë institucionesh me funksione rregullatore mbi tregjet, autonomia funksionale e të cilave garantohet me ligj.

3) Riorganizimin e qendrës së qeverisë duke e lehtësuar atë nga institucionet që nuk mbështesin drejtpërdrejt ushtrimin e funksioneve kushtetuese të Kryeministrit

Ligji i ndryshuar përcakton kritere pozitive dhe negative për krijimin e institucioneve në varësi të Kryeministrit. Kështu, mund të jenë në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit vetëm institucionet që i shërbejnë dhe kontribuojnë në realizimin e funksionit kushtetues të Kryeministrit (sipas nenit 102 të Kushtetutës) dhe institucionet e ngarkuara me funksione horizontale që nuk mund të kryhen nga ministritë e linjës. Përjashtimisht, mund të krijohen institucione në varësi të Kryeministrit, jashtë kritereve të mësipërme, por vetëm për funksione ose fusha të konsideruara prioritare në përputhje me programin politik të qeverisë dhe për aq kohë sa konsiderohen prioritare.

4) Kufizimin e shkëputjes së strukturave të vogla të brendshme ministrore (drejtori/drejtori të përgjithshme) dhe të organizimit të tyre si institucione varësie më vete

Për të kufizuar shkëputjen e strukturave të vogla të brendshme ministrore (drejtori/drejtori të përgjithshme) dhe organizimin e tyre si institucione varësie më vete, ligji parashikon: i) vendosjen nga Këshilli i Ministrave të një pragu minimal të punonjësve që justifikojnë krijimin e një institucioni varësie, dhe ii) një lloj të ri drejtorie/drejtorie të përgjithshme me status të veçantë

brenda aparatit të ministrisë, pa personalitet juridik, por me pavarësi të shtuar funksionale, në bazë të autorizimit të ministrit.

5) Mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi ndryshimet institucionale

Ligji i ndryshuar parashikon një sistem të detyrueshëm të përgatitjes dhe vlerësimit paraprak, kontrollit dhe filtrimit të nismave për ndryshime institucionale (krijim, ndarje, shuarje apo bashkim institucionesh) me dy shtylla kryesore: i) ministritë kryejnë një analizë të thelluar dhe të detyrueshme përpara (*ex ante)* se të fillojë hartimi i akteve ligjore për ndryshime institucionale, dhe ii) Departamenti i Administratës Publike ngarkohet qartazi dhe në mënyrë eksplicite si njësi ekskluzive e zhvillimit të politikave të qeverisë shqiptare në fushën e organizimit të administratës publike, me rolin për të filtruar dhe dhënë mendime në këtë fazë të nismës.

6) Transferimin e vendimmarrjes në nivel drejtorie të përgjithshme/departamenti

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm lidhet me mënyrën e organizimit të vendimmarrjes në ministri, duke e "transferuar" atë nga niveli politik (ministri apo nivelet e larta) drejt drejtorive të përgjithshme/departamenteve apo drejtorive, në rast se këto të fundit nuk janë pjesë e një drejtorie të përgjithshme apo departamenti. "Drejtoria e përgjithshme/departamenti" bëhet niveli thelbësor i vendimmarrjes në një ministri dhe drejtori i përgjithshëm/departamentit është përgjegjës për vendimmarrjen e çdo lloji në fushën e përgjegjësisë së drejtorisë së përgjithshme/departamentit, përveç asaj që i është caktuar shprehimisht sipas legjislacionit, nëpunësve civilë të niveleve më të larta apo vetë ministrit.

Kjo qasje qartëson ku ndodh vendimmarrja, personat përgjegjës për të, por edhe rrit përgjegjësinë për vendimet e marra, duke rritur cilësinë e menaxhimit dhe shërbimeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.

Në dispozitat tranzitore të ligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"", janë identifikuar aktet nënligjore që duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij ligji. Gjithashtu, përcaktohet se Këshilli i Ministrave miraton apo përkatësisht propozon, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndryshimet në legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore, për përshtatjen e tij me dispozitat e këtij ligji.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, nëpërmjet DAP-it, do të jetë përgjegjës për hartimin e akteve nënligjore të parashikuara, të cilat janë përfshirë edhe në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026. Konkretisht, planifikohet që deri në fund të vitit 2026 të hartohen dhe të dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave, projektvendimet e mëposhtme:

- Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe procedurën për hartimin dhe miratimin e planit të performancës, observacionit, raportit të performancës dhe deklaratës së performancës, formatet e tyre, si dhe rregullat e hollësishme për sistemin e brendshëm të performancës;

- Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse dhe të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, të procedurave të hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm;
- Për rregullat për përmbajtjen e detajuar, formën dhe procedurën e shqyrtimit paraprak të raportit të analizës organizativ-funksionale dhe vendimmarrjen mbi vazhdimësinë e saj, si dhe procesin e hartimit e miratimit të aktit ligjor apo nënligjor përkatës;
- Për numrin minimal të punonjësve për krijimin e një institucioni varësie.

Hartimi i akteve nënligjore do të mbështetet nga ekspertiza teknike e projektit "EU for Good Governance". Në funksion të përgatitjes së këtij procesi, do të hartohet një plan pune, në të cilin do të përcaktohen projektaktet konkrete që do të hartohen, institucionet përgjegjëse dhe bashkëpërgjegjëse për hartimin e tyre, niveli i prioritetit, risqet e mundshme, si dhe elemente të tjera të nevojshme për organizimin dhe ndjekjen e procesit.

Indikatorët e këtij objektivi specifik kanë një frekuencë vjetore matjeje dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt matjeje gjatë kësaj periudhe raportimi. Për këtë arsye, në këtë fazë nuk mund të vlerësohet progresi në lidhje me realizimin e treguesve të përcaktuar. Vlerësimi i tyre do të bëhet në përputhje me frekuencën e parashikuar të matjes dhe do të pasqyrohet në raportimin përkatës vjetor.

Objektivi specifik 4.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre

Objektivi Specifik 4.2 synon forcimin e llogaridhënies së brendshme dhe të mekanizmave të mbikëqyrjes në administratën publike, me qëllim rritjen e efektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve. Në këtë kuadër, një rëndësi e veçantë i kushtohet përmirësimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të performancës së institucioneve, përcaktimit dhe ndjekjes së objektivave, si dhe forcimit të koordinimit dhe mbikëqyrjes nga ministritë përgjegjëse.

Gjithashtu, objektivi synon përmirësimin e marrëdhënies së administratës me qytetarët, përmes trajtimit në kohë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të ankesave dhe kërkesave të lidhura me veprimtarinë administrative, si dhe përmirësimit të standardeve të ofrimit të shërbimeve publike. Në këtë drejtim, harmonizimi i legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative synon të kontribuojë në një veprimtari administrative më të unifikuar, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 4.2 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 7 (shtatë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 4.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.	
Masa 4.2.1	Krijimi dhe zbatimi i një kornize të qartë monitorimi dhe funksionimi të institucioneve të varësisë, përmes rishikimit të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
Aktiviteti 4.2.1.a	Pilotimi i kornizës së llogaridhënies dhe caktimin e objektivave/indikatorëve në 5 sisteme ministrore.
Masa 4.2.2	Monitorimi i funksionimit të plotë dhe të rregullt të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQNDE).
Aktiviteti 4.2.2.a	Monitorim i zbatimit të afateve dhe të përdorimit të SQDNE-së.
Aktiviteti 4.2.2.b	Trajtim i ankesave ose kërkesave të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe raportime mujore për performancën e institucioneve.
Masa 4.2.3	Garantimi i ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.
Aktiviteti 4.2.3.a	Nënshkrimi i marrëveshjeve me bashkitë për ndërveprimin e sistemeve elektronike dhe protokolleve për të siguruar të njëjtat standarte cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.
Aktiviteti 4.2.3.b	Trajtim i ankesave ose kërkesave të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe raportime mujore për performancën e institucioneve të nivelit vendor.
Masa 4.2.5	Rritja e efikasitetit në zbatimin e ligjit nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen".
Aktiviteti 4.2.5.a	Nënshkrimi i marrëveshjeve me bashkitë për trajtimin e ankesave të adresuara në platformën "Shqipëria që Duam".
Aktiviteti 4.2.5.b	Fillimi i inspektimeve në perputhje me Ligjin 107/2021 "Për bashkëqeverisjen".

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 4.2. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Përsa i përket **zbatimit të masës 4.2.1**, pilotimi i kornizës së llogaridhënies në 5 sisteme ministrore nuk ka filluar ende, pasi duhet të paraprihet nga hartimi dhe miratimi i kornizës së llogaridhënies, përmes miratimit të projektvendimit "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe procedurën për hartimin dhe miratimin e planit të performancës, observacionit, raportit të performancës dhe deklaratës së performancës, formatet e tyre, si dhe rregullat e hollësishme për sistemin e brendshëm të performancës*". Për rrjedhojë, pilotimi do të fillojë pas miratimit të këtij kuadri rregullator.

Në kuadër të **implemetimit të masës 4.2.2 "*Monitorimi i funksionimit të plotë dhe të rregullt të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQNDE)*",** për periudhën janar-qershor 2026, Drejtoria e Monitorimit të SQDNE ka ndërmarrë dhe zbatuar një paketë të plotë masash dhe aktivitetesh me qëllim forcimin e monitorimit të aplikimeve hyrëse të institucioneve publike, rritjen e transparencës, si dhe garantimin e respektimit të afateve ligjore të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në kuadër të forcimit të monitorimit, është realizuar ndjekja në kohë reale e aplikimeve përmes sistemit SQDNE, duke mundësuar evidentimin e aplikimeve në proces, të përfunduara brenda afateve ligjore, si dhe të atyre të vonuara apo të pa trajtuara. Ky proces ka shërbyer si bazë për identifikimin e problematikave konkrete dhe për ndërhyrjen në kohë pranë institucioneve përgjegjëse. Paralelisht, janë përpunuar dhe analizuar në mënyrë periodike të dhëna statistikore mbi performancën e institucioneve publike në trajtimin e aplikimeve.

Për periudhën 1 janar-30 qershor 2026, në sistemin e monitorimit SQDNE janë monitoruar gjithsej 1.252.612 aplikime të ardhura. Procesi i monitorimit mbi trajtimin e aplikimeve kryhet në kohë reale për të gjitha ministritë e konfiguruara në sistemin SQDNE. Masat e marra mbi ecurinë dhe vijimësinë e monitorimit kanë konsistuar në takime periodike me institucionet shërbimofruese, titullarët përgjegjës dhe punonjësit të cilët merren me trajtimin e aplikimeve.

Një tjetër fokus i rëndësishëm ka qenë monitorimi dhe analiza e shkëmbimit elektronik të dokumentacionit me vulë elektronike ndërmjet institucioneve publike, me synim garantimin e gjurmueshmërisë, integritetit të dokumenteve të shkëmbyera dhe evidentimin e rasteve të mungesës së dokumentacionit shoqërues, si pjesë e përmirësimit të proceseve administrative.

Në lidhje me aplikimet me dokumentacion shoqërues, për të cilat afati për inicimin e trajtimit është 24 (njëzet e katër) orë, sistemi i monitorimit SQDNE ka monitoruar gjithsej 68.935 aplikime. Nga këto, 55.681 aplikime 81% janë iniciuar dhe lëvruar brenda afatit të përcaktuar.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, në zbatim të fushëveprimit të saj realizon trajtimin e ankesave dhe kërkesave përmes mekanizmave ekzistues në Platformën e Bashkëqeverisjes. Për periudhën e kërkuar janar-qershor 2026, në Platformën e Bashkëqeverisjes u regjistruan 9297 çështje nga qytetarë dhe biznese mbi problematika lidhur me qeverisjen qendrore dhe vendore dhe kanë marrë përgjigje 87% prej tyre. 2697 çështje u zgjidhën dhe u realizuan 431 histori suksesi, duke reflektuar një nivel të konsiderueshëm reagimi institucional ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Në funksion të informimit dhe mbështetjes së strukturave drejtuese, janë hartuar dhe shpërndarë raporte periodike (raporte ditore, javore, mujore, vjetore) monitorimi dhe statistika analitike, të cilat kanë pasqyruar ecurinë e treguesve, nivelin e realizimit të objektivave dhe kanë shërbyer si bazë për procesin e vendimmarrjes institucionale. Në vijim të gjetjeve të monitorimit, janë ndërmarrë masa korrigjuese përmes komunikimit dhe koordinimit me institucionet publike me nivel të ulët performance, duke adresuar vonesat në trajtimin e aplikimeve dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e proceseve të brendshme administrative.

Gjithashtu, janë evidentuar nevojat për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e proceseve të monitorimit, përfshirë nevojën për trajnim të mëtejshëm të personelit mbi përdorimin e sistemit SQDNE, raportimin e problematikave teknike për përmirësimin e funksionaliteteve të sistemit dhe rishikimin e praktikave të monitorimit me qëllim rritjen e efikasitetit. Pavarësisht realizimit në masë të konsiderueshme të objektivave të përcaktuara, janë konstatuar disa sfida, kryesisht të natyrës teknike, të kapaciteteve njerëzore dhe të nevojës për trajnim të mëtejshëm të personelit, të cilat kanë ndikuar në mosarritjen e plotë të treguesve në nivelin 100%.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar gjithsej 19 takime pune dhe koordinimi me përfaqësues të institucioneve publike, me qëllim diskutimin e problematikave të evidentuara nga monitorimi, sqarimin e detyrimeve procedurale, shkëmbimin e praktikave të mira dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e performancës në trajtimin e aplikimeve.

Përsa i përket implementimit të aktiviteteve në zbatim **të masës 4.2.3 "*Garantimi i ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor*"**, AKSHI dhe ADB nuk kanë raportuar përditësime në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve me bashkitë për ndërveprimin e sistemeve elektronike dhe protokolleve për të siguruar të njëjtat standarte cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.

Ndërsa përsa i përket trajtimit të ankesave ose kërkesave të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe raportime javore dhe mujore për performancën e institucioneve të nivelit vendor është një proces i cili zbatohet ne vijueshmëri.

Në drejtim të garantimit të standardeve të njëjta të cilësisë në nivel vendor, për periudhën janar - qershor 2026, me pushtetin vendor janë regjistruar 1777 çështje dhe janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje 1515 ankesa dhe kërkesa dhe 326 prej tyre janë zgjidhur. Rezultojnë 50 raste suksesi të realizuara, të cilat janë promovuar me qëllim vizibilitetin në faqet zyrtare të institucionit për të treguar qytetarëve se çështjet e tyre shqyrtohen me shumë vëmendje.

Krahas institucioneve qendrore, edhe ato në nivel vendor janë pajisur me akses në platformën e Bashkëqeverisjes për të trajtuar rastet e adresuar dhe për të kthyer përgjigje në respektim të afateve ligjore. Tipologjitë më të shpeshta të ankesave që trajtohen me pushtetin vendor janë ato të infrastrukturës vendore, zaptimit të hapësirave publike dhe ato të përbashkëta, përputhshmëria e zbatimit të lejeve të ndërtimit, ndërtime pa leje, ndotje akustike dhe mjedisore, etj.

Raportet mbi problematikat e hasura dorëzohen periodikisht mbi baza javore tek krerët e bashkive dhe të qarqeve bashkë me theksimin e rasteve që tejkalojnë afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve me fokus dhënien e një zgjidhjeje dhe informimin transparent të palës ankuese. Gjithashtu organizohen dhe takime online dhe tryeza të rrumbullakëta diskutimi me aktorët e përfshirë për të dhënë zgjidhje dhe orientime për çështje specifike.

Në **zbatim të masës 4.2.5 "*Rritja e efikasitetit në zbatimin e ligjit nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen*"**, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) bazuar në Ligjin nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen", ushtron kompetencat e saj edhe në pushtetin vendor, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve kuadër për qëllime të këtij ligji, për trajtimin e çështjeve nën fushën e përgjegjësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore. Një kompetencë e tillë ka për qëllim garantimin e ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.

Me qëllim zbatimin dhe finalizimin e nënshkrimit të marëveshjeve kuadër me pushtetin vendor, është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të ADB, me Nr.151 prot, datë 23.09.2025 'Për ngritjen e grupit të punës". Ky proces është në fazën për nënshkrimin e marrëveshjeve me Kryetarët e Bashkive respektive.

Gjatë periudhës së raportimit, ADB nuk ka filluar ende inspektimet dhe zhvillimi i tyre është parashikuar në vijim të procesit. Në funksion të krijimit të kuadrit të nevojshëm për fillimin dhe zhvillimin e inspektimeve, si dhe në zbatim të ligjit nr. 107/2021, "*Për bashkëqeverisjen*", Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka miratuar "*Procesverbalin e Konstatimit të Shkeljeve gjatë Inspektimit*", me Urdhrin nr. 23, datë 20.04.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të ADB.

Fillimi i inspektimeve do të vijojë në përputhje me kuadrin ligjor dhe proceduror në fuqi, ndërsa ecuria e procesit do të pasqyrohet në raportimet e ardhshme.

Për Objektivin Specifik 4.2 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar dy tregues performance, por për këtë periudhë monitorimi, është i matshëm vetëm një tregues performance, konkretisht: "*4.2.1 "Indeksi i funksionimit të SQNDE"*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 4.2 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
4.2.1 Indeksi i funksionimit të SQNDE.	N/A	100% e numrit te dokumentave të përpunuara dhe të shkëmbyera brenda afatit ligjor	81% e dokumentev e janë të përpununara, ndërsa 19% të dokumentav e janë të pa përpunuara jashtë afatit	81%

			për periudhën monitoruese janar - qershor 2026.	
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.2[56]				**81%**

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.2 "*Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 81%.[57]

Treguesi "*4.2.1 "Indeksi i funksionimit të SQNDE""* ka si qëllim të masë monitorimin e funksionimit dhe zbatimit të afateve dhe të përdorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQNDE).

Burimi i të dhënave për këtë raport është sistemi i monitorimit SQDNE, i cili pasqyron në kohë reale të gjithë treguesit mbi aplikimet hyrëse të institucioneve publike, përfshirë aplikimet në proces trajtimi, të trajtuara brenda afateve ligjore dhe ato të vonuara e të pa trajtuara. Sistemi mundëson gjithashtu monitorimin e shkëmbimit të dokumentacionit me vulë elektronike ndërmjet institucioneve publike.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë monitoruar 68.935 aplikime me dokumentacion shoqërues. Nga këto, për 55.681 aplikime është përpunuar dhe shkëmbyer dokumentacioni, ndërsa 13.254 aplikime kanë mbetur të pa trajtuara, duke përfaqësuar 19% të totalit. Niveli i realizimit të treguesit është 81%= 55681/ 68935 x 100%.

Mosarritja e nivelit të synuar 100% të treguesit ka ardhur si pasojë e:

- problematikave teknike në sistem;
- problematikave administrative të institucioneve;
- mungesës së trajnimit të plotë të personelit për trajtimin e aplikimeve;
- përfundimit të kontratave të mirëmbajtes së sistemeve të brendshme të institucioneve;
- largimit dhe lëvizjes së punonjësve në institucionet publike.

[56] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

[57] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Objektivi është realizuar në masë të konsiderueshme, por jo plotësisht. Ko ka ardhur si pasojë e:

- Problematikave teknike.
- Problematikave mbi trajnimin e personelit mbi trajtimin e aplikimeve.
- Largimi dhe lëvizja e punonjësve nga institucionet publike..

Objektivi Specifik 4.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik synohet forcimi i aksesit të publikut në informacion dhe përmirësimi i dialogut ndërmjet administratës publike, qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto ndërhyrje synojnë të kontribuojnë në konsolidimin e një administrate publike më të hapur, transparente dhe llogaridhënëse, e cila garanton ofrimin e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe transparente, si dhe nxit një dialog të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës me publikun. Në këtë kuadër, objektivi synon gjithashtu forcimin e partneritetit ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies publike, si dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve të administratës publike për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim, të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 4.3 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 3 (gjashtë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 4.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.	
Masa 4.3.1	Miratimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
Aktiviteti 4.3.1.b	Hartimi i 3 akteve nënligjore në zbatim të ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.
Masa 4.3.2	Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të institucioneve të administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore.

Aktiviteti 4.3.2.b	Zhvillimi i trajnimeve të dedikuara për koordinatorët e informimit.
Aktiviteti 4.3.2.c	Ndjekja e trajnimit të certifikuar "Për të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura" nga Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues, të zhvilluar nga ASPA dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Aktiviteti 4.3.2.d	Rritje e angazhimit proaktiv të institucioneve publike në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura.
Masa 4.3.4	Nxitja e partneritetit dhe dialogut të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile si monitorues të pavarur të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.
Aktiviteti 4.3.4.a	Forcimi i partneritetit të institucioneve publike me OSHC-të në drejtim të llogaridhënies dhe transparencës.
Masa 4.3.5	Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet.
Aktiviteti 4.3.5.a	Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 4.3. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

- **Rritje e kapaciteteve profesionale për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit**

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të institucioneve të administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik Gjatë periudhës janar–qershor 2026 u zhvilluan dy aktivitete ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në fushën e së drejtës për informim, të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), në vijim të bashkëpunimit me projektin TAIEX, zhvilloi një vizitë studimore në Slloveni në datat 26–27 shkurt, me fokus zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik". Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me praktikat e institucioneve sllovene, Zyrës së Komisionerit për Informimin në Slloveni dhe Ministrisë për Administratën Publike, në implementimin e legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërinstitucionale në këtë

fushë. Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit përfituan njohuri në fushën e të dhënave të hapura dhe diskutuan me ekspertët sllovenë përafrimin e praktikave shqiptare me standardet evropiane.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe harmonizimit të praktikave me standardet evropiane, në përputhje edhe me kërkesat e Udhërrëfyesit të PAR, Zyra e Komisionerit mori pjesë në seminarin evropian mbi të drejtën e informimit, të zhvilluar në Tallinn, Estoni (1-2 qershor 2026). Seminari shërbeu për shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet autoriteteve evropiane lidhur me balancimin e së drejtës për informim me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Zhvillimi i trajnimeve të dedikuara për koordinatorët e informimit

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), u zhvilluan dy programe trajnimi me certifikim, me pjesëmarrjen e 78 pjesëmarrësve, prej të cilëve 66 ishin koordinatorë për të drejtën e informimit. Trajnimet përfshinë:

- 1 trajnim në klasë për modulin "*E drejta e informimit*", në të cilin kanë marrë pjesë 27 pjesëmarrës: 24 nga pushteti qendror, 3 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sa i përket koordinatorëve për të drejtën e informimit, 27 pjesëmarrës u identifikuan si të përfshirë drejtpërdrejt në këtë rol.
- 1 kurs online për modulin "*E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale*", në të cilin kanë marrë pjesë 51 pjesëmarrës: 32 nga pushteti qendror, 5 nga institucionet e pavarura, 5 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe 9 nga organizata ose kompani private. Sa i përket koordinatorëve për të drejtën e informimit, 39 pjesëmarrës u identifikuan si të përfshirë drejtpërdrejt në këtë rol.

Në këto trajnime koordinatorët e të drejtës për informim morën njohuri të thelluara për ndryshimet ligjore në fushën e të drejtës për informim, si dhe për miratimin e Konventës 205 të Këshillit Evropian "Mbi aksesin në dokumente zyrtare" e njohur si Konventa Tromsø. Gjithashtu u njohën dhe me raste praktike nga zbatimit i legjislacionit për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi në Tiranë një aktivitet trajnues me përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, në kuadër të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me programin "Bashki të Forta" (Helvetas) dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Në këtë takim, përfaqësuesit e organeve të sektorit publik, koordinatorë për të drejtën e informimit/persona kontakti, sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistë IT, përfituan njohuri të zgjeruara mbi rëndësinë e rritjes së rolit të Këshillave Bashkiakë.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe zbatimit të ligjit nr. 33/2022 "*Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik*", i cili përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës, aksesit dhe ripërdorimit të informacionit publik. U theksua se njësitë e

vetëqeverisjes vendore kanë një rol të veçantë në këtë drejtim, duke qenë niveli më i afërt me qytetarin dhe administrues të të dhënave me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme.

Në kuadër të këtij projekti, u hartuan gjithashtu dokumentet kërkimore "*Transparenca e Këshillave Bashkiakë*" dhe "*Udhëzues për Monitorimin e Transparencës së Këshillave Bashkiakë*". Udhëzuesi, i miratuar nga Zyra e Komisionerit pas konsultimeve vendore të zhvilluara në Shkodër, Gjirokastër dhe Tiranë, u publikua dhe iu shpërnda të 61 këshillave bashkiakë për shqyrtim dhe zbatim të rekomandimeve të tij.

- **Zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit**

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, gjatë periudhës janar-qershor 2026, Zyra e Komisionerit miratoi "*Planin e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes për Transparencën Proaktive për vitin 2026*". Gjatë periudhës së raportimit u zhvilluan 20 hetime administrative pranë autoriteteve publike, prej të cilave 8 në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 12 në institucionet e administratës qendrore dhe institucionet e varësisë, me fokus publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës. Në përfundim të hetimeve administrative, 12 prej tyre kanë përmbushur detyrimin për publikimin dhe përditësimin e programit të transparencës. Ndërkaq, 1 (një) autoritet publik nuk e ka përditësuar programin e transparencës edhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore. Për këtë të fundit, Zyra e Komisionerit ka dhënë vendim me sanksion gjobë. Ndërkohë, 7 hetimet e tjera janë ende në proces.

Gjithashtu, në vazhdën e vitit të kaluar ku në fokus ishin institucione shëndetësore edhe gjatë vitit 2026, Zyra e Komisionerit ka miratuar 14 rekomandime mbi zbatimin e Programit të Transparencës nga ana e tyre. Pas rimonitorimit në përfundim të afatit rezultoi se 13 nga këto autoritete i përmbushën (plotësisht ose pjesërisht) detyrimet e lëna në rekomandim dhe vetëm 1 autoritet nuk i ka përmbushur.

Gjatë periudhës së raportimit, Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit u instalua në 20 autoritete të reja publike, duke e çuar në 292 numrin total të institucioneve që përdorin sistemin. Instalimi u shoqërua me trajnimin e koordinatorëve për përdorimin e sistemit dhe zbatimin e detyrimeve ligjore.

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026 Zyra e Komisionerit monitoroi edhe zbatimin e Ligjit nr. 119/2014 përmes raportimit vjetor të autoriteteve publike. Në kuadër të forcimit të monitorimit të zbatimit të Ligjit nr.119/2014, Komisioneri miratoi një format të ri raportimi, i cili për herë të parë kërkoi nga autoritetet publike të raportojnë edhe mbi kohën e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion.

Nga 367 autoritete publike, 355 paraqitën raportet vjetore pranë Zyrës së Komisionerit. Të dhënat e raportuara tregojnë se gjatë vitit 2025 autoritetet publike trajtuan 13,029 kërkesa për informacion, krahasuar me 11,549 në vitin 2024. Gjithashtu, u regjistrua një rritje e numrit të përgjigjeve të plota (11,017 kundrejt 9,289 në vitin 2024), ndërsa 36% e kërkesave morën përgjigje brenda 3

ditëve pune, duke reflektuar përmirësim në reagimin e autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion.

Të dhënat e raportuara tregojnë një rritje të numrit të kërkesave për informacion të trajtuara nga autoritetet publike, si edhe një rritje të numrit të përgjigjeve të plota krahasuar me vitin 2024. Gjithashtu, për herë të parë u monitorua koha e reagimit të autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion, duke krijuar një bazë më të plotë për vlerësimin e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 dhe orientimin e masave mbikëqyrëse të Komisionerit.

Masat e ndërmarra gjatë periudhës së raportimit, në vijim të reformave të ndërmarra gjatë vitit 2025, kanë kontribuar në forcimin e mekanizmave administrativë për mbrojtjen e së drejtës për informim, rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe përmirësimin e monitorimit të zbatimit të Ligjit nr. 119/2014.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka intensifikuar aktivitetet mbikëqyrëse dhe mbështetëse për zbatimin e Ligjit nr. 33/2022. Në kuadër të planit vjetor të punës, ajo ka filluar monitorimin online të organeve të sektorit publik përgjegjëse për publikimin e kategorisë së të dhënave me vlerë të madhe në fushën e mjedisit dhe vëzhgimit të tokës, mbi angazhimin e tyre në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022 "*Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik*". Për këtë qëllim është hartuar dhe miratuar "*Manuali i monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike*", duke vendosur një metodologji të unifikuar për vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 u monitoruan 5 organe të sektorit publik, për të cilat u hartuan rekomandime individuale me qëllim përmirësimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore lidhur me publikimin e të dhënave në formate të hapura dhe të ripërdorshme.

- **Krijimi i platformës unike digjitale "Transparent Albania"**

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) vijoi drejtimin dhe koordinimin e zbatimit dhe zhvillimit të platformës Transparent Albania, si pjesë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030 (SNRAP). Paralelisht, zhvillimi i platformës ndiqet edhe në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Agjendës së Reformave të Shqipërisë, përmes angazhimit për "*Rritjen e transparencës përmes krijimit të një platforme me të dhëna të hapura mbi buxhetin kombëtar dhe vendor dhe shpenzimet publike, në partneritet me shoqërinë civile*".

Që në konceptimin e saj, Transparent Albania nuk është parashikuar si një platformë që do të lançohej vetëm një herë, por si një instrument që do të përditësohet dhe zhvillohet vazhdimisht. Në këtë kuadër, qëndrueshmëria e platformës mbështetet në tri nivele të ndërlidhura: në nivelin e politikave, institucional dhe teknik. Në nivelin e politikave, krahas përfshirjes së saj në SNRAP 2025-2030 dhe ndjekjes së angazhimit përkatës në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së për

Ballkanin Perëndimor dhe Agjendës së Reformave, platforma është pjesë edhe e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2026-2030.

Në nivel institucional, funksionon Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur për këtë proces, ku MAPA koordinon zbatimin, ndërsa Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) kanë përgjegjësi të qarta për të dhënat zyrtare dhe administrimin teknologjik. Ministritë e tjera janë pjesë e procesit për të garantuar transferimin dhe përdorimin e duhur të të dhënave, angazhimin e stafeve dhe të koordinatorëve për të drejtën e informimit, si dhe propozimin e informacioneve apo risive të reja për platformën. MAPA ka koordinuar procesin përmes takimeve të rregullta me Ministrinë e Financave, AKSHI-n dhe ekipet teknike përgjegjëse. Këto takime kanë mundësuar ndjekjen në kohë të detyrave, trajtimin e çështjeve teknike dhe operacionale dhe dakordësimin mbi prioritetet e zbatimit.

Në nivel teknik, platforma është zhvilluar përmes kapaciteteve të brendshme të administratës publike. Ekipet që njohin sistemin dhe burimet e të dhënave kanë në këtë mënyrë mundësi ta mirëmbajnë, përditësojnë dhe përmirësojnë atë në vazhdimësi, pa krijuar varësi afatgjatë nga ofrues të jashtëm.

Një nga arritjet kryesore të periudhës së raportimit ishte integrimi i të dhënave të buxheteve vendore për të 61 bashkitë. Secila prej 61 bashkive ka tashmë një hapësirë të dedikuar në platformë, ku përdoruesit mund të aksesojnë informacion të strukturuar mbi shpenzimet, projektet dhe alokimet buxhetore. Ky sistem i centralizuar lehtëson kontrollin publik, mundëson krahasimin ndërmjet bashkive dhe ndihmon qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, studiuesit, gazetarët dhe institucionet mbikëqyrëse të evidentojnë parregullsi ose rreziqe të mundshme në përdorimin e fondeve publike.

Gjatë periudhës së raportimit është vijuar gjithashtu përditësimi dhe vizualizimi i të dhënave financiare. Platforma përditësohet çdo muaj me informacion mbi të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe mbi projektet e financuara. Informacioni paraqitet edhe përmes vizualizimeve mbi shpenzimet kapitale dhe ecurinë e tyre në kohë, krahasimin ndërmjet financimit të brendshëm dhe të huaj, si dhe shpërndarjen e fondeve sipas ministrive.

Njëkohësisht, është mundësuar funksionaliteti i zbërthimit të të dhënave në disa nivele. Duke nisur nga një shifër e përgjithshme e buxhetit kombëtar, përdoruesi mund të kalojë te të dhënat sipas sektorëve, ministrive, programeve dhe projekteve individuale. Ky funksionalitet rrit transparencën dhe gjurmueshmërinë e shpenzimeve publike, duke treguar se si alokohen dhe përdoren fondet në nivele të ndryshme të qeverisjes. Gjithashtu, janë shtuar filtra të avancuar sipas vitit, fjalëve kyçe dhe sektorëve, të cilët e bëjnë më të lehtë dhe më të shpejtë gjetjen e informacionit specifik.

Platforma u mundëson gjithashtu përdoruesve të gjenerojnë raporte drejtpërdrejt dhe të eksportojnë të dhënat në formatet “Excel” dhe “PDF”. Ky funksionalitet lehtëson analizimin dhe ripërdorimin e informacionit, veçanërisht nga studiuesit, gazetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet mbikëqyrëse.

Përmirësime janë realizuar edhe në seksionin “Buxheti i Qytetarit”, përmes shpjegimeve më të thjeshta, grafikëve vizualë, të dhënave të strukturuara dhe një fjalori të dedikuar fiskal. Këto ndryshime e bëjnë informacionin buxhetor dhe ekonomik më të kuptueshëm për përdoruesit që nuk kanë njohuri të specializuara dhe ndihmojnë platformën t’i përgjigjet më drejtpërdrejt pyetjes “Ku shkojnë taksat e mia?”.

Në përgjigje të sugjerimeve të organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, janë integruar funksionalitete që përmirësojnë përdorimin e platformës nga personat me aftësi të kufizuara dhe përdoruesit me nevoja të ndryshme aksesueshmërie. Një video prezantuese është integruar gjithashtu në platformë për t’u shpjeguar përdoruesve qëllimin e saj, informacionin që ofron dhe mënyrën e përdorimit të funksionaliteteve kryesore.

Një tjetër drejtim i punës gjatë periudhës së raportimit ka qenë forcimi i transparencës institucionale dhe i së drejtës së informimit. Në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në platformë është integruar lista e plotë e 358 koordinatorëve për të drejtën e informimit. Kjo e forcon rolin e Transparent Albania si një pikë e vetme aksesi në informacionin zyrtar publik dhe u mundëson qytetarëve të identifikojnë koordinatorët përgjegjës në institucionet publike, të gjurmojnë kërkesat e tyre dhe t’i kontaktojnë drejtpërdrejt ata.

Për të forcuar komunikimin e drejtpërdrejtë me përdoruesit, është krijuar një seksion i ri për komente dhe sugjerime. Përmes këtij seksioni, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të komentojnë mbi cilësinë e të dhënave, të raportojnë probleme teknike, të kërkojnë informacion buxhetor, të paraqesin pyetje dhe të propozojnë përmirësime. Është krijuar gjithashtu adresa e dedikuar info@transparentalbania.com, e cila do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit. Në këtë mënyrë, platforma po shndërrohet gradualisht nga një instrument informimi i njëanshëm në një kanal komunikimi të dyanshëm me përdoruesit.

Procesi i informimit dhe konsultimit me organizatat e shoqërisë civile, gazetarët, studiuesit, akademinë dhe universitetet do të vijojë gjatë muajit shtator 2026, në mënyrë që pjesëmarrësit të testojnë një version më të plotë të platformës dhe të ofrojnë rekomandime të bazuara në përvojën konkrete të përdorimit.

Gjatë periudhës së raportimit, platforma Transparent Albania arriti gjithashtu në fazën finale të ReSPA Awards for Public Administration, një iniciativë rajonale që vlerëson dhe promovon projektet më inovative, digjitale dhe efikase të institucioneve shtetërore në Ballkanin Perëndimor dhe vendet fqinje, me qëllim përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Rezultatet e konkurrimit pritet të shpallen në tetor 2026.

Angazhimet e parashikuara në vijim

Në kuadër të zbatimit në vijim të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike, faza e ardhshme e zhvillimit të platformës do të fokusohet në konsolidimin e funksionaliteteve ekzistuese

dhe në sigurimin e evidencave më të forta mbi përdorimin dhe ndikimin e saj në transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe llogaridhënien publike.

Në këtë fazë, do të forcohet analiza e përdorimit të platformës, për të krijuar një bazë më të plotë të dhënash mbi profilin dhe sjelljen e përdoruesve, informacionin që kërkohet dhe të dhënat që gjenerojnë më shumë interes, si dhe vështirësitë e hasura gjatë përdorimit. Kjo analizë do të shërbejë për përcaktimin dhe përmirësimin e treguesve të performancës dhe për vlerësimin më të strukturuar të kontributit të platformës në informimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset publike.

Paralelisht, do të vijojë përmirësimi i dizajnit dhe përvojës së përdoruesit, përmes modernizimit të ndërfaqes, thjeshtimit të navigimit dhe testimit të aksesueshmërisë. Do të finalizohet gjithashtu paneli i ri në faqen kryesore, i cili do të paraqesë në mënyrë më të qartë dhe të aksesueshme treguesit kryesorë makrofiskalë, përfshirë shpenzimet sipas sektorëve, buxhetin vjetor, deficitin fiskal, borxhin publik dhe rritjen ekonomike.

Në fazën vijuese të zbatimit të Strategjisë, fokusi do të zhvendoset më tej drejt vlerësimit të ndikimit dhe përdorimit të evidencave të gjeneruara për zhvillimin e vazhdueshëm të platformës. Në këtë kuadër, do të thellohet angazhimi me organizatat e shoqërisë civile, universitetet, studiuesit, gazetarët dhe kategori të tjera përdoruesish, përmes konsultimeve dhe testimeve praktike. Rezultatet do të përdoren për të orientuar zhvillimin e përmbajtjes dhe funksionaliteteve të reja, si dhe për të përshtatur treguesit e performancës me nevojat dhe përvojën reale të përdoruesve, duke forcuar gradualisht rolin e platformës si instrument në mbështetje të objektivave të reformës së administratës publike. Platforma Transparent Albania

- **Forcimi i partneritetit të institucioneve publike me OSHC-të në drejtim të llogaridhënies dhe transparencës**

Në qendër të këtij procesi është hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2026-2030, i cili do të përcaktojë reformat dhe angazhimet konkrete në fushën e transparencës, pjesëmarrjes qytetare, llogaridhënies, luftës kundër korrupsionit dhe përdorimit të teknologjisë për përmirësimin e qeverisjes.

Procesi udhëhiqet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të OGP-së, me mbështetjen teknike të Sekretariatit Teknik pranë Kryeministrisë. Shoqëria civile është përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në bashkëkrijimin e Planit, duke kontribuar në identifikimin e prioriteteve dhe në përmirësimin e cilësisë, besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së angazhimeve të propozuara.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë përfshirë në mënyrë aktive në hartimin dhe konsultimin e Planit Kombëtar të Veprimit të OGP-së dhe parashikohen shprehimisht si pjesëmarrëse në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. Plani i Veprimit parashikon përfshirjen e OSHC-ve përmes:

- Komitetit Shumëpalësh, i cili shqyrton propozimet, monitoron procesin e OGP-së dhe mbështet dialogun e vazhdueshëm ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.
- Kontributit të OSHC-ve në Raportin e Vetëvlerësimit të Shqipërisë (publikuar per 2025-2025) për zbatimin e Planit të Veprimit të OGP-së, i cili pritet të përgatitet gjatë viteve të ardhshme.
- Analizave të pavarura, vlerësimeve të integritetit, analizave mbi kapjen e politikëbërjes, dokumenteve të qëndrimit dhe raporteve periodike të monitorimit, që do të përgatiten nga organizatat e shoqërisë civile ose koalicionet e tyre.
- Pjesëmarrjes së OSHC-ve në monitorimin e prokurimit publik, vendimmarrjes publike, të drejtës së informimit dhe zbatimit të masave të integritetit.
- Mekanizmave të konsultimit dhe monitorimit të krijuar në kuadër të angazhimit për pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Arritjet kryesore

Gjatë periudhës së raportimit është avancuar procesi i bashkëkrijimit dhe hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2026-2030, në përputhje me parimet e transparencës, gjithëpërfshirjes, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies. Procesi është zhvilluar përmes një kombinimi të konsultimeve institucionale, dialogut me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve dhe mekanizmave të strukturuar të bashkëkrijimit.

Gjatë periudhës shtator 2025-prill 2026 janë zhvilluar takime informuese, aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, konsultime institucionale dhe procese të strukturuara angazhimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Një rol qendror në këtë proces ka pasur Forumi Shumëpalësh, si mekanizëm i dialogut ndërmjet institucioneve publike, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar tri mbledhje të Forumit, përkatësisht më 19 shtator 2025 me 22 pjesëmarrës, më 23 dhjetor 2025 me 41 pjesëmarrës dhe më 3 mars 2026 me 35 pjesëmarrës. Në total, 98 pjesëmarrës janë përfshirë në këto mbledhje, të cilat kanë shërbyer për diskutimin e prioriteteve dhe ndjekjen e ecurisë së procesit të bashkëkrijimit.

Procesi është mbështetur paralelisht nga aktivitete të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe shoqërisë civile. Ndërkohë, janë zhvilluar tri trajnime dhe seminare mbi procesin e bashkëkrijimit dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2026-2030, me gjithsej 91 pjesëmarrës. Më 29 janar 2026 u zhvillua trajnimi "Co-Creation Process and the OGP National Action Plan 2026-2030", me 34 pjesëmarrës, ndërsa një aktivitet i dytë me të njëjtin fokus u organizua më 5 shkurt 2026, me 29 pjesëmarrës. Më 10 shkurt 2026 u zhvillua gjithashtu trajnimi online "Co-Creation for Civil Society", me 28 pjesëmarrës, i dedikuar posaçërisht për forcimin e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e bashkëkrijimit.

Në vijim të këtij procesi, konsultimet janë zhvilluar edhe drejtpërdrejt nga institucionet publike pjesëmarrëse, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Agjencinë

Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe ministri të tjera të linjës. Ndër aktivitetet e zhvilluara, Ministria e Drejtësisë organizoi më 17 shkurt 2026 një konsultim me 39 pjesëmarrës, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit zhvilloi dy aktivitete, më 5 mars me 18 pjesëmarrës dhe më 17 mars me 11 pjesëmarrës. Qendra Kombëtare e Biznesit zhvilloi dy aktivitete konsultimi, më 13 mars me 9 pjesëmarrës dhe më 31 mars me 7 pjesëmarrës.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjerimit territorial të procesit dhe përfshirjes së aktorëve jashtë Tiranës. Në këtë kuadër, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile zhvilloi konsultime në Peshkopi më 27 mars 2026, me 12 pjesëmarrës, në Berat më 30 mars 2026, me 18 pjesëmarrës, si dhe në Tiranë më 2 prill 2026, me 18 pjesëmarrës. Shtrirja e konsultimeve në Berat dhe Peshkopi ka mundësuar një përfshirje më të gjerë territoriale të organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve vendorë në procesin e hartimit të Planit.

Krahas konsultimeve të përgjithshme, janë organizuar edhe konsultime tematike me grupe të veçanta, përfshirë të rinjtë dhe organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, duke mbështetur një proces më gjithëpërfshirës dhe duke mundësuar reflektimin e perspektivave dhe nevojave të grupeve të ndryshme në angazhimet që po hartohen. Gjithashtu, nëntë institucione kanë përdorur anketime dhe pyetësorë të strukturuar për të mbledhur në mënyrë më sistematike mendime dhe propozime nga organizatat e shoqërisë civile.

Në tërësi, rreth 25 ministri, institucione të pavarura dhe agjenci publike janë angazhuar në proces dhe kanë marrë përgjegjësinë për zhvillimin e propozimeve përkatëse të angazhimeve që do të bëhen pjesë e Planit të përgjithshëm Kombëtar të Veprimit. Institucionet e angazhuara përfshijnë Ministrinë e Arsimit; Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit; Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit; Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Ministrinë e Drejtësisë; Ministrinë e Mbrojtjes; Ministrinë e Financave; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrinë e Mjedisit; Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin; Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Komisionin e Prokurimit Publik; Qendrën Kombëtare të Biznesit; Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile; Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA; Agjencinë e Prokurimit Publik; Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit; si dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Këto institucione janë angazhuar në konsultime të strukturuara me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët përkatës të interesit, me synim garantimin e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës. Secili institucion ka përgjegjësinë për zhvillimin dhe hartimin e propozimeve të veta për angazhime, të cilat do të konsolidohen më pas në Planin Kombëtar të Veprimit të OGP-së 2026-2030. Përfshirja e vazhdueshme e shoqërisë civile gjatë procesit ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe realizueshmërisë së angazhimeve, si dhe në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies gjatë gjithë procesit të bashkëkrijimit.

Për të garantuar transparencën, vizibilitetin dhe aksesin e lehtë në të gjithë informacionin ligjor, institucional dhe procedural që lidhet me procesin e bashkëkrijimit të OGP-së, administrohet dhe përditësohet rregullisht një faqe zyrtare e dedikuar. Ajo shërben si pika qendrore publike e referimit për organizatat e shoqërisë civile dhe për të gjithë aktorët e interesuar që dëshirojnë të marrin pjesë në proces ose të ndjekin ecurinë e tij. Informacioni publikohet në mënyrë të strukturuar dhe lehtësisht të aksesueshme dhe përfshin kuadrin ligjor dhe institucional të procesit të OGP-së, përshkrimin e hollësishëm të metodologjisë dhe fazave të bashkëkrijimit, thirrjet zyrtare për pjesëmarrje dhe konsultim, njoftimet për takime, seminare dhe dialogë publikë, dokumentacionin dhe përditësimet mbi aktivitetet e vazhdueshme të angazhimit, si dhe pikat përkatëse të kontaktit dhe udhëzimet për pjesëmarrje. Faqja e dedikuar e procesit të bashkëkrijimit mund të aksesohet në faqen zyrtare të OGP Albania. Përmes saj, organizatat e shoqërisë civile kanë akses të vazhdueshëm dhe të barabartë në informacion dhe në mundësitë e angazhimit, duke garantuar transparencën e procesit dhe duke lehtësuar pjesëmarrjen e hapur në dialogun mbi politikat dhe në aktivitetet e bashkëkrijimit.

Angazhimet në vijim

Në fazën e ardhshme, puna do të përqendrohet në përmbylljen e procesit të bashkëkrijimit dhe konsolidimin e angazhimeve të hartuara nga institucionet pjesëmarrëse. Projektplani i rishikuar do të publikohet për konsultim publik formal gjatë muajit shtator 2026, me qëllim marrjen e komenteve dhe rekomandimeve përfundimtare nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të interesuar.

Paralelisht, do të vijojë dialogu i strukturuar ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile përmes Forumit Shumëpalësh dhe mekanizmave të tjerë të bashkëpunimit, duke ruajtur qasjen pjesëmarrëse të ndjekur gjatë procesit të bashkëkrijimit. Rezultatet e konsultimit publik dhe të dialogut me aktorët e interesuar do të reflektohen në procesin e finalizimit të Planit të ri Kombëtar të Veprimit të OGP-së 2026-2030.

Në fazën vijuese, pas përfundimit të konsultimit dhe konsolidimit të angazhimeve, do të procedohet me finalizimin dhe dorëzimin e Planit të ri Kombëtar të Veprimit pranë OGP-së, jo më vonë se 4 shkurt 2027, në përputhje me afatin e rishikuar të përcaktuar sipas Kuadrit të ri të Veprimit të OGP-së.

- **Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet**

Me qëllim mbështetjen dhe informimin e qytetarëve lidhur me ushtrimin e së drejtës së informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) ka hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare "*Manualin për të Drejtën e Informimit*", i cili është i aksesueshëm online, konkretisht në këtë link: https://idp.al/wp-content/uploads/2025/10/Manual-DDI-Light-2025.html

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit publikon në mënyrë periodike një buletin të dedikuar për të drejtën e informimit, i cili publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe shpërndahet nëpërmjet postës elektronike tek të interesuarit. Këto instrumente synojnë të lehtësojnë aksesin e qytetarëve dhe palëve të interesuara në informacionin dhe burimet orientuese lidhur me të drejtën e informimit. Linku: https://idp.al/newsletter/.

Qendra e Botimeve Zyrtare, përveç faqes zyrtare (qbz.gov.al), e cila është e aksesueshme nga publiku, është aktive edhe në rrjetet sociale, nëpërmjet të cilave informon publikun në mënyrë periodike për publikimet e Fletoreve Zyrtare. Këto kanale komunikimi kontribuojnë në lehtësimin e aksesit të publikut në informacionin lidhur me botimet zyrtare dhe në rritjen e informimit mbi publikimet e reja.

Për Objektivin Specifik 4.3 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar dy tregues performance, por për këtë periudhë monitorimi, është i matshëm vetëm një tregues performance, konkretisht: "*4.3.1 "Indeksi i forcimit të kapaciteteve në institucionet e administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore"*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 4.3 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
4.3.1 Indeksi i forcimit të kapaciteteve në institucionet e administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore.	N/A	100%	66 koordinatorë të trajnuar nga 25 për çdo vit të parashikuar	100%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.3[58]				100%

[58] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.3 "*Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 100%.[59]

Treguesi 4.3.1 "*Indeksi i forcimit të kapaciteteve në institucionet e administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore*" ka si qëllim të masë progresin në forcimin e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe të dhënat e hapura, përmes zhvillimit të trajnimeve të certifikuara për koordinatorët për të drejtën e informimit dhe për anëtarët e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND).

Në zbatim të parashikimeve të SNRAP KDIMDP, në bashkëpunim me ASPA, gjatë muajve janar - qershor 2026, ka zhvilluar:

- Trajnimin online me temë "*E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale*", në të cilin morën pjesë 51 përfaqësues nga institucione të ndryshme, nga të cilët 39 u identifikuan si koordinatorë.
- Trajnimin në klasë me temë "*E drejta e informimit*", në të cilin kanë marrë pjesë 27 koordinatorë për të drejtën e informimit.

Në këto trajnime 66 koordinatorët e të drejtës për informim morën njohuri të thelluara për ndryshimet ligjore në fushën e të drejtës për informim, si dhe për miratimin e Konventës 205 të Këshillit Evropian "Mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare" e njohur si Konventa Tromsø. Gjithashtu u njohën dhe me raste praktike nga zbatimit i legjislacionit për të drejtën e informimit.

Trajnimi "*E drejta për informim*", synon të forcojë njohuritë dhe aftësitë e nëpunësve publikë për zbatimin efektiv të legjislacionit mbi të drejtën e informimit, duke promovuar një administratë më transparente, llogaridhënëse dhe të orientuar drejt qytetarit. Në fokus të trajnimit janë ndryshimet dhe risitë e ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", rëndësia e menaxhimit të kërkesave për informacion, detyrimet e autoriteteve publike për sigurimin e informacionit të plotë dhe në kohë, si dhe pasojat që sjell cenimi i kësaj të drejte. Gjithashtu, trajtohen standardet ndërkombëtare për aksesin në informacion, me fokus të veçantë Konventën nr. 205 të Këshillit të Evropës (Konventa Tromso) dhe parimet që garantojnë aksesin në dokumentet zyrtare.

Objektivi kryesor i trajnimit është që pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë ndryshimet ligjore dhe të aftësohen për t'i zbatuar ato në praktikë, duke rritur cilësinë e përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion dhe duke forcuar transparencën institucionale. Trajnimi synon gjithashtu të zhvillojë njohuritë e pjesëmarrësve mbi standardet evropiane të së drejtës për informim, të forcojë kulturën

[59] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

e llogaridhënies në administratën publike dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e respektimit të së drejtës së qytetarëve për akses në informacion. Në përfundim të tij, pjesëmarrësit pritet të jenë në gjendje të analizojnë risitë e legjislacionit shqiptar për të drejtën e informimit, të zbatojnë parimet e transparencës dhe të vlerësojnë praktikat më të mira për garantimin e aksesit në informacion publik.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është arritur progres i mirë në komponentin që lidhet me trajnimin dhe certifikimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit. Ndërkohë, komponenti që lidhet me trajnimin e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues mbetet për t'u realizuar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026, sipas planifikimit të ASPA.

Objektivi specifik 4.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike në mënyrë proaktive nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik synohet forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes institucionale, me fokus të veçantë në fuqizimin e rolit të Kuvendit në ushtrimin sistematik dhe efektiv të funksionit të tij mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së Qeverisë. Në këtë kuadër, masat e parashikuara synojnë rritjen e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit parlamentar, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e zbatimit nga administrata publike të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Gjithashtu, objektivi synon forcimin e rolit mbikëqyrës të Avokatit të Popullit, duke kontribuar në rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike dhe në përmirësimin e mekanizmave të kontrollit dhe ndjekjes së rekomandimeve të adresuara ndaj administratës publike.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 4.4 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 4 (katër) masa dhe 8 (tetë) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 4.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë.	
Masa 4.4.1	Fuqizimi i rolit proaktiv të Kuvendit në ushtrimin sistematik të funksionit mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së Qeverisë.
4.4.1.a	Platforma Ndërinstitucionale virtuale e përmirësuar.
4.4.1.b	Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të organeve të pavarura.
4.4.1.c	Angazhimi i komisioneve dhe Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik për shqyrtimin e një numri sa më të lartë të raporteve të veçanta

	të institucioneve të pavarura, në të cilat rekomandimet e lëna rezultojnë të pazbatuara.
Masa 4.4.2	Zbatimi i kontrollit post-legjislativ nga Kuvendi jo vetëm mbi ligjet e përafruara me acquis-në e BE-së, por edhe mbi aktet e tjera.
4.4.2.a	Trajnimi i nëpunësve të Kuvendit për zbatimin e metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.
4.4.2.b	Zhvillimi dhe realizimi i vlerësimeve post-legjislative nga komisionet parlamentare.
Masa 4.4.3	Thellimi proaktiv i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
4.4.3.a	Përdorimi periodik nga Kuvendi i instrumentave të parashikuara nga kuadri kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrjen e institucioneve në varësi të Qeverisë.
4.4.3.b	Përgatitja e raporteve monitoruese mbi plotësimin e detyrimeve të anëtarësimit.
Masa 4.4.4	Fuqizimi i rolit mbikëqyrës së Avokatit të Popullit.
4.4.4.c	Publikimi i raportit vjetor të Avokatit të Popullit në zbatim të kuadrit ligjor të rishikuar.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 4.4. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në kuadër të fuqizimit të rolit proaktiv të Kuvendit (masa 4.4.1), janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e instrumenteve mbikëqyrëse të Kuvendit.

Platforma Ndërinstitucionale është rikonfiguruar dhe zgjeruar (aktiviteti 4.4.1.a), duke përfshirë rubrika të reja dhe informacione shtesë në bazën e të dhënave. Ndërhyrjet e kryera kanë synuar rritjen e transparencës dhe aksesueshmërisë së informacionit për publikun e gjerë, zgjerimin e numrit të institucioneve që kontribuojnë në platformë, si dhe përmirësimin e strukturës dhe dizajnit të saj, me qëllim krijimin e një ndërfaqeje më të qartë dhe më miqësore për përdoruesit.

Aktualisht, Platforma Ndërinstitucionale ndodhet në fazën e dytë të testimit të sigurisë (penetration test), i cili po kryhet nga Kuvendi, me qëllim identifikimin dhe adresimin e problematikave të mundshme të sigurisë dhe garantimin e një niveli të përshtatshëm sigurie për funksionimin e saj.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura (aktiviteti 4.4.1.b), gjatë periudhës janar-qershor 2026, **Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Kushtetuese dhe atyre të pavarur të krijuar me ligj**, ka marrë dhe përpunuar informacionin nga institucionet kushtetuese ose ato të ngritura me ligj në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Shërbimi ka përgatitur raportimin përkatës katërmujor për periudhën janar – prill 2026, mbi bazën e informacioneve të marra, në zbatim të Vendimit të Kuvendit nr. 49/2017 "*Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj*" dhe të Vendimit nr. 134/2018 "*Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik*".

Rezultatet e këtyre raportimeve janë paraqitur më poshtë:

AVOKATI I POPULLIT	
Rekomandime në total	**25**
Rekomandime të realizuara	**1**
Rekomandime në proces	**3**
Rekomandime ende brenda afatit për të kthyer përgjigje	**21**

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	
Rekomandime në total	**47**
Rekomandime të zbatuara	**15**
Rekomandime në proces	**21**
Rekomandime në proces gjyqësor	**6**
Rekomandime të pazbatuara	**4**
Rekomandime pjesërisht të zbatuara	**1**

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
Rekomandime në total	**18**
Rekomandime të realizuara	**12**
Rekomandime në proces	**1**
Rekomandime të realizuara pjesërisht	**3**
Rekomandime të parealizuara	**2**

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL	
Rekomandime në total	**34**
Rekomandime në proces	**10**
Rekomandime brenda afatit	**4**
Rekomandime të realizuara	**20**
Vendime pa rekomandime	**46**

AUTORITETI I KONKURRENCËS	
Rekomandime në total	**2**
Rekomandime në proces	**2**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Për 57 auditimet e kryera nga KLSH gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, u krye monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Nga verifikimet e kryera lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se janë dhënë gjithsej 1808 rekomandime, nga të cilat nuk janë pranuar 21 masa, ose rreth 1% dhe janë pranuar plotësisht 1787 masa, ose 99% që përfshijnë: 17 përmirësime ligjore, 1065 masa organizative, 69 masa shpërblim dëmi, 172 masa për shpenzime pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet, 9 masa administrative, 455 masa disiplinore.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga 1787 masat e pranuara: janë zbatuar plotësisht 667 masa ose 37%; pjesërisht 205 masa, ose 11%; janë në proces zbatimi 378 ose 21%; nuk janë zbatuar 537 masa, ose rreth 30%.

NËNKOMISIONI PËR AUDITIMIN E SEKTORIT PUBLIK

Në lidhje me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me Vendimin nr. 104/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë u krijua **Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik**, në përbërje të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Mbledhja e parë konstituese u zhvillua më 21 janar 2026.

Nënkomisioni, i përbërë nga 9 anëtarë të përhershëm dhe 2 anëtarë zëvendësues, ushtron kompetencat e tij në shqyrtimin e raporteve të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të tyre, si dhe auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare të KLSH-së.

Gjatë periudhës janar - qershor 2026, Nënkomisioni zhvilloi gjithsej nëntë mbledhje. Në këtë periudhë u miratua "Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Nënkomisionit", si dhe u miratuan vendimet për shpalljen dhe rishpalljen e procedurës për përzgjedhjen e audituesve të pavarur për auditimin e pasqyrave financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në kuadër të planifikimit të veprimtarisë së tij, Nënkomisioni përzgjodhi për shqyrtim dy raporte auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Raportin e Auditimit të Agjencisë Shtetërore të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Raportin e Auditimit të Performancës "Efektiviteti dhe Siguria e Barnave që Qarkullojnë në Shqipëri". Gjatë periudhës raportuese u shqyrtua raporti i auditimit mbi efektivitetin dhe sigurinë e barnave, ndërsa raporti për Agjencinë Shtetërore të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara mbetet për t'u shqyrtuar në vijim.

Në funksion të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të shqyrtuara nga legjislatura e kaluar, Nënkomisioni analizoi përgjigjet e institucioneve lidhur me auditimin e performancës "*Kujdesi ndaj të Moshuarve*" dhe auditimet e përputhshmërisë në drejtoritë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Tiranë Rurale 1 dhe 2, Durrës, Fier dhe Pogradec, të iniciuara nga Nënkomisioni i legjislaturës së kaluar. Në vijim, u zhvillua nga një seancë dëgjimore me Shërbimin Social Shtetëror për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit "*Kujdesi ndaj të Moshuarve*", dhe me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve.

Në lidhje me raportin e auditimit "Efektiviteti dhe Siguria e Barnave që Qarkullojnë në Shqipëri", Nënkomisioni zhvilloi shqyrtimin e raportit dhe më pas organizoi dy seanca dëgjimore me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për të analizuar gjetjet e auditimit, masat e ndërmarra dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Në drejtim të institucionalizimit të kontrollit post-legjislativ (masa 4.4.2), gjatë periudhës janar – qershor 2026, nuk janë zhvilluar trajnime të nëpunësve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.

Ndërsa në kuadër të **aktivitetit 4.4.2.b** "*Zhvillimi dhe realizimi i vlerësimeve post-legjislative nga komisionet parlamentare*", është miratuar raporti për kontrollin post-legjislativ për Ligjin Nr. 61/2012 "*Për akcizat në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe rekomandimet i janë dërguar institucioneve përgjegjëse.

Po ashtu, janë hedhur në faqen zyrtare të Kuvendit për konsultim me publikun projektraportet për PLS për Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Progresi i aktiviteteve në **zbatim të masës 4.4.3 "*Thellimi proaktiv i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*"**, paraqitet si më poshtë:

Në zbatim të **aktivitetit 4.4.3.a** "*Përdorimi periodik nga Kuvendi i instrumenteve të parashikuara nga kuadri kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrjen e institucioneve në varësi të Qeverisë",* gjatë periudhës janar-qershor 2026:

- Është zhvilluar vetëm 1 mocion me debat, më datë 14 maj 2026 mbi bazën e kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
- Deputetët paraqitën 237 pyetje me shkrim drejtuar Këshillit të Ministrave, ministrave dhe institucioneve të tyre të varësisë, institucioneve të pavarura, etj.
- Komisionet e përhershme parlamentare organizuan 17 vizita monitoruese, në institucionet e ekzekutivit dhe në institucionet kushtetuese/institucionet e krijuara me ligj.
- Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme ka zhvilluar gjatë periudhës janar – qershor 2026, 11 seanca dëgjimore si pjesë të funksionit mbikëqyrës për 3 grupkapituj dhe 18 kapituj negociues.
- Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian ka zhvilluar nga 1 janar – 30 qershor 2026, 6 takime ku janë diskutuar tema të ndryshme si: progresi i negociatave për anëtarësim në BE, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, roli i Parlamentit dhe i KKIE-së në procesin e anëtarësimit, etj.

Me miratimin me konsensus të ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit, në datë 21.05.2026, me fokus ndër të tjera, përmirësimin e procedurave të kontrollit parlamentar, u konfirmua Komisioni i përhershëm parlamentar "*Për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale*", si një zhvillim i rëndësishëm institucional në drejtim të forcimit të funksionit mbikëqyrës të parlamentit. Gjatë periudhës janar - qershor 2026, veprimtaria e Komisionit është karakterizuar nga një intensitet i lartë dhe një orientim i qartë drejt forcimit të dimensionit mbikëqyrës. Komisioni ka zhvilluar 24 mbledhje dhe tre vizita monitoruese në institucionet publike.

Në zbatim të **aktivitetit 4.4.3.b** "*Përgatitja e raporteve monitoruese mbi plotësimin e detyrimeve të anëtarësimit*", në periudhën janar-qershor 2026, Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përgatitur 3 raporte monitorimi për Komisionin për Evropën dhe Punët e Jashtme për:

1. Shqyrtimin e ndryshimeve në pozicionin negociues për Grupkapitullin II "*Tregu i brendshëm*";
2. Shqyrtimin e ndryshimeve në pozicionin negociues për Grupkapitullin III "*Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse*";
3. Mbikëqyrjen e ecurisë së negociatave të anëtarësimit për vitin 2025 dhe katërmujorin e parë të vitit 2026.

Në zbatim të **masës 4.4.4 "*Fuqizimi i rolit mbikëqyrës së Avokatit të Popullit*"** Për herë të parë, raporti vjetor i Avokatit të Popullit është publikuar përpara dërgimit të tij në Kuvend, në përputhje

me ndryshimet ligjore të miratuara në dhjetor të vitit 2025. Raporti u konsultua me Organizata të Shoqërisë Civile dhe partnerë të tjerë institucionalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2025 është publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

Për Objektivin Specifik 4.4 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar 5 tregues performance, por për këtë periudhë monitorimi, janë të matshëm dy tregues performance, konkretisht:

- 4.4.4 *"Numri i vlerësimeve post-legjislative për ligjet më të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian".*
- 4.4.5 "*Indeksi i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 4.4 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
4.4.4 Numri i vlerësimeve post-legjislative për ligjet më të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian	1 analizë post-legjislative	3 analiza post-legjislative	0.75%	25%
4.4.5 Indeksi i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.	0%	5%	3%	100%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.4[60]				63%

[60] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 4.4 "*Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike në mënyrë proaktive nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 63%.[61]

Treguesi 4.4.4 "*Numri i vlerësimeve post-legjislative për ligjet më të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian*", ka si qëllim të masë nivelin e përmirësimit të cilësisë së hartimit dhe zbatimit të legjislacionit, përmes kryerjes së analizave post-legjislative për ligjet më të rëndësishme në procesin e anëtarësimit ne BE. Duke patur në vëmendje rëndësinë që ka procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ky tregues synon që vit pas viti të rrisë numrin e analizave/vlerësimeve post-legjislative të realizuara.

Gjatë periudhës së raportimit ka filluar hartimi i një raporti të kontrollit post-legjislativ. Megjithatë, duke qenë se vlera e treguesit të performancës është vjetore, në raportin e ardhshëm të monitorimit matja e progresit pritet të jetë më e plotë dhe më përfaqësuese e ecurisë reale të zbatimit.

Treguesi 4.4.5 "*Indeksi i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*", ka si qëllim të masë ecurinë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian përmes monitorimit të tij nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria ka bërë progres të gjerë në procesin e negociatave dhe anëtarësimit. Ky progres ka krijuar kushtet për një përshpejtim të procesit të negociatave gjatë vitit 2026. Aktualisht janë mbyllur provizorisht 3 kapituj, konkretisht:

- Kapitullit 25 "Shkenca dhe Kërkimi";
- Kapitullit 26 "Arsimi dhe Kultura";
- Kapitullit 30 "Marrëdhëniet me Jashtë".

QËLLIMI I POLITIKËS V - ADMINISTRATA E GJELBËR

Qëllimi i Politikës V, synon ndërtimin e një administrate publike që zbaton dhe promovon praktika të qëndrueshme mjedisore, duke synuar reduktimin e ndikimeve negative në mjedis dhe integrimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në veprimtarinë institucionale. Kjo politikë përfshin ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike lidhur me konceptin dhe praktikat e administratës së gjelbër, si dhe nxitjen e zhvillimit të një administrate publike që vepron në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit, eficiencës së burimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm.


[61] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë realizuar masat dhe aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6M e I-rë të 2026	Masa dhe aktivitete plotësisht të zbatuara[62]	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të zbatuara[63]	Masa dhe aktivitete të pazbatuara[64]
Qëllimi i Politikës V	Masa	7	1	1	5
	Aktivitete	9	2	0	7

Rezulton se, nga 7 masa dhe 9 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2025-2027 për Qëllimin e Politikës V "Administrata e gjelbër", gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2026, janë zbatuar plotësisht 1 masë dhe 2 aktivitete, pjesërisht 1 masë dhe 0 aktivitete, ndërsa 5 masa dhe 7 aktivitete rezultojnë të pazbatuara.

Ecuria e realizimit të masave dhe aktiviteteve të paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



[62] Masë apo aktivitet "*plotësisht i zbatuar*" është ai aktivitet i cili është realizuar në masën 100%.
[63] Masë apo aktivitet "*pjesërisht i zbatuar*" është ai aktivitet për të cilin është bërë një farë progresi.
[64] Masë apo aktivitet "*i pazbatuar*" është ai aktivitet për të cilin nuk ka asnjë progres ose i cili nuk është raportuar nga strukturat përgjegjëse.

Qëllimi i Politikës V, përfshin gjithsej 5 tregues performance, nga të cilët, referuar Aneksit 2 të SNRAP 2025-2030 "Pasaporta e Treguesve të Performancës", 4 tregues janë të matshëm për këtë periudhë monitorimi.

Për treguesit e performancës të QP V, në tabelën e mëposhtme paraqitet realizueshmëria e tyre.

Qëllimi i Politikës V	Totali i Treguesve e performancës	Totali i Treguesve e Performancës të matur për periudhën janar-qershor 2026	Realizimi i Treguesve të Performancës		
			Vlera e synuar është realizuar plotësisht.[65]	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht.[66]	Vlera e synuar nuk është e realizuar.[67]
	5	4	1	0	3

Nga 4 treguesit e performancës të matur për periudhën e raportimit për Qëllimin e Politikës V "Administrata e gjelbër", vlera e synuar është arritur plotësisht për 1 tregues, ndërsa për 3 tregues të tjerë është nuk është realizuar.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar nivelin e progresit, në përqindje, për secilin objektiv specifik të Qëllimit të Politikës V, bazuar në ecurinë e treguesve të performancës dhe nivelin e realizimit të masave përkatëse.

Objektivi Specifik (OS)	**Shkalla e realizimit të OS sipas masave.[68]**	**Shkalla realizimit sipas treguesve të performancës.[69]**
OS 5.1: Përmirësimi i performancës mjedisore të institucioneve publike në përputhje me standardet e Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit (SEMA)	0%	0%
OS 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike	0%	0%

[65] Që është realizuar në shkallën 100 për qind.
[66] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 99% për qind.
[67] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.
[68] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{\text{2 Masa}} \text{ x } 100\%$
[69] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\%$
Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

OS 5.3: Transformimi i kapitalit njerëzor të sektorit publik për tranzicionin ekologjik	50%	0%
5.4: Përshpejtimi i prokurimit të gjelbër publik dhe zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese	50%	100%
Zbatueshmëria e Qëllimit të Politikës V	25%	25%

Nga analiza e mësipërme rezulton se niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës V, i vlerësuar mbi bazën e performancës së treguesve përkatës, është 25%.

Në vijim paraqitet analiza e masave të monitoruara gjatë periudhës raportuese, së bashku me ecurinë e treguesve të performancës përkatës, në funksion të vlerësimit të progresit në zbatimin e Objektivave Specifikë të Qëllimit të Politikës V.

Objektivi Specifik 5.1: Përmirësimi i performancës mjedisore të institucioneve publike në përputhje me standardet e Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit (SEMA)

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik synohet forcimi i rolit të administratës publike në promovimin dhe zbatimin e praktikave që kontribuojnë në reduktimin e emetimeve të karbonit, mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe eficient të burimeve natyrore. Në këtë kuadër, masat e parashikuara synojnë integrimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në funksionimin dhe veprimtarinë e institucioneve publike, duke nxitur praktika të administratës së gjelbër dhe duke rritur kapacitetin e institucioneve për të udhëhequr dhe mbështetur përpjekjet për një zhvillim më të qëndrueshëm. Një administratë publike e fortë, efektive, përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse përbën një faktor të rëndësishëm për krijimin e kushteve që individët, organizatat dhe bizneset të kontribuojnë në mënyrë aktive në mbrojtjen e mjedisit dhe avancimin e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Për arritjen e këtij qëllimi, në kuadër të këtij Objektivi Specifik janë parashikuar një sërë masash që synojnë forcimin e angazhimit të administratës publike në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe reduktimin e ndikimit të veprimtarisë institucionale në mjedis.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 5.1 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 3 (tre) masa dhe 4 (katër) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 5.1: Përmirësimi i performancës mjedisore të institucioneve publike në përputhje me standardet e Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit (SEMA).	
Masa 5.1.1	Plotësimi i kuadrit ligjor dhe krijimi i kushteve për zbatimin e skemës se Ekomenaxhimit dhe Auditimit (SEMA).
Aktiviteti 5.1.1.a	Miratimi i ndryshimeve të VKM nr. 633, datë 15.7.2015 "Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit".
Masa 5.1.2	Përdorimi efiçent i burimeve natyrore në institucionet e administratës publike.
Aktiviteti 5.1.2.a	Reduktimi i konsumit energjetik dhe ujit nga institucionet publike.
Aktiviteti 5.1.2.b	Raportimi i të dhënave mbi konsumin e burimeve natyrore nga institucionet publike.
Masa 5.1.3	Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës mjedisore të institucioneve publike në përputhje me standardet e Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit (EMAS).
Aktiviteti 5.1.3.a	Kryeja nga ana e institucioneve te administratës publike të një analize mjedisore të të gjitha aspekteve mjedisore të organizatës, në përputhje me SEMA.

Përsa i përket plotësimit të kuadrit ligjor dhe krijimit të kushteve për zbatimin e skemës se Ekomenaxhimit dhe Auditimit (SEMA) **(masa 5.1.1)**, aktualisht janë në proces draftimi disa projektvendime të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 57/2025, datë 16.10.2025 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*" dhe ligjit nr. 74/2025, datë 4.12.2025 "*Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje*".

Këto projektvendime synojnë transpozimin e plotë të direktivave të Bashkimit Europian të fushës së mbetjeve, duke sjellë një qasje të re që kalon nga ekonomia lineare drejt ekonomisë qarkulluese. Ky proces përbën një hap të rëndësishëm në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030.

Për sa i përket aktiviteteve që lidhen me përdorimin eficient të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike **(masa 5.1.2)**, masa ndodhet në fazën fillestare të zbatimit dhe kërkon zhvillimin e mekanizmave operacionalë për monitorimin dhe raportimin e konsumit në nivel institucional.

MIE dhe AEE do të vijojnë punën për hartimin e qasjes metodologjike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, koordinimin me institucionet publike, si dhe identifikimin e ndërhyrjeve prioritare për reduktimin e konsumit dhe rritjen e eficiencës në përdorimin e burimeve natyrore.

Për sa i përket implementimit **të masës 5.1.3**, gjatë periudhës raportuese nuk janë realizuar aktivitetet e parashikuara në kuadër të kësaj mase, përfshirë kryerjen e analizës mjedisore të të gjitha aspekteve mjedisore të organizatës, në përputhje me SEMA/EMAS.

Masa nuk është aktualisht e zbatueshme, pasi kuadri ligjor në fuqi për lejet e mjedisit, si dhe Direktiva 2010/75/BE, rregullojnë parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga instalimet dhe veprimtaritë që i nënshtrohen lejes së mjedisit dhe nuk përcaktojnë detyrime të përgjithshme për institucionet publike për zbatimin e SEMA/EMAS apo kryerjen e analizave mjedisore në përputhje me këto skema.

Për zbatimin e kësaj mase nevojitet përcaktimi i një baze të posaçme ligjore, si dhe hartimi i kritereve, metodologjisë dhe procedurave për kryerjen dhe verifikimin e analizës mjedisore dhe përcaktimi i institucioneve që do t'i nënshtrohen këtij procesi.

Për Objektivin Specifik 5.1 në "Pasaportën e Indikatorëve" janë përcaktuar dy tregues performance. Për këtë periudhë monitorimi, është i matshëm vetëm një tregues performance, konkretisht: "*5.1.1 "Ulja e konsumit të burimeve natyrore (energjisë dhe ujit) nga institucionet qendrore"*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 5.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
5.1.1 Ulja e konsumit të burimeve natyrore (energjisë dhe ujit) nga institucionet qendrore.	N/A	Trend zbritës	Nuk është ende e disponueshme	0%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.1[70]				0%

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.1 "*Përmirësimi i performancës mjedisore të institucioneve publike në përputhje me standardet e Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit*

[70] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$.

(SEMA)", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 0%.[71]

Treguesi 5.1.1 "*Indeksi i përmirësimit të standardit të Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar*" ka si qëllim të masë nivelin e uljes së konsumit të burimeve natyrore nga institucionet qendrore të administratës publike. Performanca e këtij treguesi do të matet nëpërmjet konsumit të energjisë dhe të ujit të harxhuar për një vit nga institucionet qendrore dhe varësitë e tyre.

Gjatë vitit 2025, ky tregues ka qenë në "fazë fillestare", ku fokusi ka qenë në saktësimin e metodës së matjes dhe identifikimin e burimeve të mundshme të të dhënave, pa arritur ende në raportim të konsoliduar për nivelin e konsumit nga institucionet qendrore. Aktualisht, treguesi ndodhet në një fazë orientuese dhe pritet të konsolidohet si instrument monitorimi në periudhat pasuese të zbatimit të Planit të Veprimit 2025–2027.

Në perspektivë, treguesi 5.1.1 pritet të konsolidohet si instrument monitorimi në vitet në vijim përmes:

- Përcaktimit të vlerës së vitit bazë të standardizuar;
- Krijimit të një sistemi të unifikuar raportimi për institucionet qendrore;
- Rritjes së kapaciteteve institucionale për mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- Vendosjes së objektivave konkrete për reduktimin e konsumit.

Sa më sipër, zbatimi i masave teknike kërkon identifikimin e objekteve prioritare, sigurimin e burimeve financiare të dedikuara dhe koordinimin ndërinstitucional për realizimin e ndërhyrjeve konkrete. Në këtë kuadër, në vijim duhet të identifikohen institucionet pilote, të përgatiten planet e ndërhyrjes dhe të integrohen masat përkatëse në programimin buxhetor afatmesëm.

Objektivi Specifik 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik synohet forcimi i bashkëpunimit dhe i partneriteteve ndërsektoriale për promovimin dhe zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike. Masat e parashikuara synojnë të nxisin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të administratës publike, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e njohurive, ekspertizës dhe praktikave të mira, si dhe mobilizimin e burimeve në mbështetje të një administrate më të qëndrueshme. Në këtë kuadër, forcimi i këtyre partneriteteve pritet të kontribuojë në përshpejtimin e integrimit të praktikave të gjelbra në proceset

[71] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

administrative dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së ofrimit të shërbimeve publike.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 5.2 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 1 (masë) masa dhe 1 (aktivitet) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike.	
Masa 5.2.2	Rritja e bashkëpunimit me administratat në rajon dhe Bashkimin Evropian për ndarjen e praktikave dhe përmirësimin e proceseve të gjelbra administrative.
Aktiviteti 5.2.2.a	Organizimi i shkëmbimeve me administratat homologe në rajon dhe në vendet e BE-së mbi praktikat e gjelbra në sektorin publik.

Në kuadër të organizimit të shkëmbimeve me administratat homologe në rajon dhe në vendet e BE-së mbi praktikat e gjelbra në sektorin publik, është hapur thirrja për hartimin e kurrikulës dhe zhvillimin e trajnimit me tematikë: "*Harmonizimi Ligjor, Përafrimi me Acquis të BE-së dhe Zbatimi i Detyrimeve të Grupkapitullit IV 'Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme'*".

Për Objektivin Specifik 5.2 në "Pasaportën e Indikatorëve" është përcaktuar një tregues performance, konkretisht: "*5.2.1 "Rritja e kapaciteteve institucionale mbi zbatimin e nismave të gjelbra'*"".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 5.2 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	**Vlera bazë 2024**	**Vlera e synuar për 2026**	**Vlera e arritur për periudhën raportuese**	**Niveli i realizimit të treguesit**
5.2.1 Rritja e kapaciteteve institucionale mbi zbatimin e nismave të gjelbra.	n/a	100%	0%	0%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.2[72]				0%

[72] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë. Për treguesit për të cilët niveli i realizimit ka tejkaluar 100%, në llogaritjen e nivelit të

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.2 "*Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar–qershor 2026 është 0%.[73]

Treguesi 5.2.1 "*Rritja e kapaciteteve institucionale mbi zbatimin e nismave të gjelbra*" synon të masë nivelin e rritjes së kapaciteteve analitike në institucionet qendrore lidhur me zbatimin e nismave të gjelbra. Për këtë qëllim, ASPA në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucione të tjera të administratës publike do të përgatisin kurrikula, manuale dhe materiale trajnimi për nëpunësit publikë.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është evidentuar progres në lidhje me këtë tregues. Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve institucionale do të vijojnë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026.

Objektivi Specifik 5.3: Transformimi i kapitalit njerëzor të sektorit publik për tranzicionin ekologjik

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik synohet forcimi i kapaciteteve të administratës publike për integrimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe praktikave të gjelbra në politikat, proceset dhe veprimtarinë institucionale. Masat e parashikuara synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe të njohurive të punonjësve të administratës publike mbi praktikat e administratës së gjelbër, si dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale për planifikimin dhe zbatimin e masave që lidhen me eficiencën e përdorimit të burimeve, reduktimin e ndikimit në mjedis dhe promovimin e qëndrueshmërisë. Në këtë kuadër, forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale pritet të kontribuojë në konsolidimin e praktikave të gjelbra dhe në përmirësimin e performancës mjedisore të administratës publike.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 5.3, të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 2 (dy) masa dhe 2 (dy) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

---

përgjithshëm të realizimit është marrë në konsideratë vlera 100% si niveli maksimal i realizimit për secilin tregues. Kjo qasje metodologjike siguron që tejkalimi i objektivit të një treguesi të mos kompensojë mosrealizimin ose realizimin e pjesshëm të treguesve të tjerë. Në këtë mënyrë, niveli i përgjithshëm i realizimit pasqyron në mënyrë më të saktë shkallën reale të përmbushjes së objektivave, duke garantuar që një tregues i realizuar, për shembull, në masën 150%, të mos ndikojë në mënyrë disproporcionale në rezultatin e përgjithshëm kur tregues të tjerë nuk janë realizuar në masën 100%.

[73] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Objektivi Specifik 5.3: Transformimi i kapitalit njerëzor të sektorit publik për tranzicionin ekologjik.	
Masa 5.3.1	Integrimi i aftësive të gjelbra në trajnimet dhe rekrutimin në administratën publike.
Aktiviteti 5.3.1.a	Organizimi i trajnimeve të dedikuara të punonjësve të administratës publike mbi tranzicionin ekologjik.
Masa 5.3.2	Fuqizimi i lidershipit të mesëm dhe të lartë për tranzicionin ekologjik.
Aktiviteti 5.3.2.b	Organizimi i trajnimeve të dedikuara të drejtuesve të mesëm dhe të lartë për tranzicionin ekologjik.

Analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse evidenton arritjet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2026, si dhe kontributin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në funksion të zbatimit të Objektivit Specifik 5.3. Progresi i realizuar, bazuar në informacionin e raportuar për periudhën e monitorimit, paraqitet në vijim.

Në kuadër të **masës 5.3.1 dhe aktivitetit 5.3.1.a**, në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të projektit "*EU for Circular Economy and Livable Cities Albania*", ASPA ka hartuar kurrikulat "*Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve" dhe "Ekonomia Qarkulluese*", të cilat shërbejnë si bazë për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe sesioneve informuese në këto fusha.

Në vijim të hartimit të tyre, janë zhvilluar trajnime pilot për testimin dhe validimin e kurrikulave, si dhe janë organizuar workshop-e tematike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Përsa i përket **aktiviteti 5.3.2.b, në zbatim të masës 5.3.2,** në lidhje me organizimin e trajnimeve të dedikuara për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë mbi tranzicionin ekologjik, procesi i hartimit dhe finalizimit të kurrikulave të trajnimit ende nuk ka përfunduar. Organizimi i trajnimeve do të vijojë pas përfundimit dhe miratimit të kurrikulave përkatëse.

Për Objektivin Specifik 2.1 në "Pasaportën e Indikatorëve" është përcaktuar një tregues performance, konkretisht: "*5.3.1 "Numri i drejtuesve të mesëm dhe të lartë të trajnuar për tranzicionin ekologjik"*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 5.3 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
5.3.1 Numri i drejtuesve të mesëm dhe të lartë të trajnuar për tranzicionin ekologjik.	N/A	70%	0%	0%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.3[74]				0%

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.3 "*Transformimi i kapitalit njerëzor të sektorit publik për tranzicionin ekologjik*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 0%.[75]

Treguesi 5.3.1 "*Numri i drejtuesve të mesëm dhe të lartë të trajnuar për tranzicionin ekologjik*" synon të masë nivelin e rritjes së informacionit të drejtuesve të mesëm dhe të lartë të trajnuar për tranzicionin ekologjik.

Për këtë qëllim, ASPA në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucione të tjera të administratës publike duhet përgatisin një plan trajnimesh për nëpunësit publikë.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është evidentuar progres në lidhje me këtë tregues. Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve drejtuesve të mesëm dhe të lartë të trajnuar për tranzicionin ekologjik do të vijojnë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026.

Objektivi Specifik 5.4: Përshpejtimi i prokurimit të gjelbër publik dhe zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese

Nëpërmjet këtij Objektivi Specifik, synohet forcimi i rolit të administratës publike në promovimin e prokurimit të gjelbër dhe zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese në veprimtarinë e sektorit publik. Në këtë kuadër, masat e parashikuara synojnë rritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin e prokurimeve të gjelbra dhe përdorimin qarkullues të materialeve, forcimin e kuadrit nënligjor për etiketimin e produkteve me ndikim në energji etj. Këto ndërhyrje synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e performancës mjedisore të administratës publike dhe në orientimin

[74] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$.

[75] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

gradual të konsumit dhe proceseve administrative drejt modeleve më të qëndrueshme dhe më eficientë në përdorimin e burimeve.

Për periudhën janar-qershor 2026, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Objektivit Specifik 5.4 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, janë monitoruar gjithsej 1 (një) masa dhe 2 (dy) aktivitete, të cilat paraqiten si më poshtë:

Objektivi Specifik 5.4: Përshpejtimi i prokurimit të gjelbër publik dhe zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese.	
Masa 5.4.1	Integrimi i kritereve mjedisore në mënyrë të qendrueshme në prokurimet publike.
Aktiviteti 5.4.1.a	Përfshirja në Raportin Vjetor të APP të informacionit lidhur me zbatimin e kritereve mjedisore/eficencën e energjisë në procedurat e prokurimit publik.
Aktiviteti 5.4.1.c	Miratimi i kuadrit nënligjor për etiketimin e produkteve me ndikim në energji.

Për këtë periudhë raportimi, për këtë objektiv specifik është në zbatim vetëm një masë, konkretisht **masa 5.4.1**. Për sa i përket integrimit të kritereve mjedisore në mënyrë të qendrueshme në prokurimet publike konstatohet se ka ardhur në rritje numri i procedurave ku përdoren kriteret e gjelbra nga ana e Autoriteteve Kontraktore. Në rritjen e numrit të procedurave ka ndikuar edhe nxjerrja e akteve nënligjore në formën e udhërrëfyesve, ku përmendim ndër të tjera:

- Udhërrëfyesin "*Mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në procedurat e prokurimit publik*", që mund të aksesohet në këtë link: https://app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udherrefyes/;
- Udhërrëfyesin "*Mbi përdorimin nga autoritetet/entet kontraktore të kriterit të vlerësimit "Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto*"", që mund të aksesohet në këtë link: https://app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udherrefyes/ .

Gjithashtu përmendim trajnimet e zhvilluara me asistencën e Bankës Botërore, por edhe ato që zhvillon ASPA, kryesisht i kurrikulës bazë, ku përmenden përdorimi i këtyre kritereve si edhe aktet nënligjore përkatëse.

Konkretisht, për periudhën janar-qershor 2026 nga procedurat e asistuara nga APP, rezulton se në 92 procedura, autoritetet kontraktore kanë përdorur ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto (MEAT), të cilat rezultojnë me rritje krahasuar me 84 procedura që kanë përdorur ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto për periudhën janar-dhjetor 2025.

APP në analizat vjetore që harton çdo fillim viti, lidhur me mirëfunksionimin e sistemit të prokurimit elektronik, jep informacion edhe në lidhje me përdorimin e kritereve të gjelbërta nga autoritetet kontraktore në procedurat e prokurimit. Të dhënat mbi vitin 2026 do të publikohen në

analizën vjetore për 2026, e cila do publikohet në fillim të vitit 2027 në faqen zyrtare të APP, në këtë link: https://app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/.

Për Objektivin Specifik 5.4 në "Pasaportën e Indikatorëve" është përcaktuar një tregues performance, konkretisht: "*5.4.1 "Niveli i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi përdorimin qarkullues të materialeve në veprimtarinë e sektorit publik"*".

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit për Objektivin Specifik 5.4 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Treguesit e performancës	Vlera bazë 2024	Vlera e synuar për 2026	Vlera e arritur për periudhën raportuese	Niveli i realizimit të treguesit
5.4.1 Niveli i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi përdorimin qarkullues të materialeve në veprimtarinë e sektorit publik.	0%	100%	100%	100%
Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.4[76]				100%

Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 5.4 "*Niveli i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi përdorimin qarkullues të materialeve në veprimtarinë e sektorit publik*", i vlerësuar në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026 është 100%.[77]

Treguesi 5.4.1 "*Niveli i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi përdorimin qarkullues të materialeve në veprimtarinë e sektorit publik*" ka si qëllim të masë nivelin e aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi përdorimin qarkullues të materialeve në veprimtarinë e sektorit publik si: promovimi i praktikave të rritjes së ripërdorimit, riciklimit dhe reduktimit (parimi 3R), duke përfshirë administratën publike dhe aktorë të tjerë interesi.

[76] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$. Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë. Për treguesit për të cilët niveli i realizimit ka tejkaluar 100%, në llogaritjen e nivelit të përgjithshëm të realizimit është marrë në konsideratë vlera 100% si niveli maksimal i realizimit për secilin tregues. Kjo qasje metodologjike siguron që tejkalimi i objektivit të një treguesi të mos kompensojë mosrealizimin ose realizimin e pjesshëm të treguesve të tjerë. Në këtë mënyrë, niveli i përgjithshëm i realizimit pasqyron në mënyrë më të saktë shkallën reale të përmbushjes së objektivave, duke garantuar që një tregues i realizuar, për shembull, në masën 150%, të mos ndikojë në mënyrë disproporcionale në rezultatin e përgjithshëm kur tregues të tjerë nuk janë realizuar në masën 100%.

[77] Për detaje mbi metodologjinë, burimin e të dhënave dhe mënyrën e llogaritjes, referojuni Aneksit 2 të Raportit të Monitorimit.

Në kuadër të përmbushjes së prioriteteve kombëtare dhe të objektivave të Bashkimit Europian për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese dhe ekonomisë së gjelbër, gjatë periudhës janar-qershor 2026, janë zhvilluar aktivitete të shumta ndërgjegjësuese dhe informuese në institucione arsimore, universitete, biznese dhe sipërmarrje mikro e të vogla.

Këto aktivitete kanë synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit, ripërdorimin e materialeve dhe mbështetjen e praktikave të ekonomisë qarkulluese në sektorin publik dhe privat.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), institucion në varësi të Ministrisë së Mjedisit, ka realizuar gjithsej 396 aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese. Nga këto aktivitete, 275 aktivitete janë zhvilluar në universitete publike dhe private, shkolla publike dhe jo-publike. Gjithashtu, janë zhvilluar 121 aktivitete në biznese, si: në sipërmarrje mikro, sipërmarrje të vogla dhe operatorë ekonomikë të sektorit të riciklimit.

Në kuadër të aktiviteteve janë shpërndarë dhe prezantuar:

- Broshura informuese mbi ekonominë qarkulluese;
- Udhëzues praktikë për riciklimin dhe ndarjen e mbetjeve;
- Materiale edukative për ekonominë e gjelbër;
- Postera sensibilizues për përdorimin e qëndrueshëm të materialeve;
- Prezantime multimediale dhe video ndërgjegjësuese;
- Manuale për reduktimin e mbetjeve në institucione publike;
- Udhëzues mbi prokurimin e gjelbër publik;
- Praktika të mira europiane në ekonominë qarkulluese;
- Paketa edukative për nxënësit dhe studentët;
- Materiale informuese për sipërmarrjet mbi standardet mjedisore të BE-së.

Gjithashtu, në datat 16-19 shkurt 2026, është zhvilluar trajnimi për pilotimin e kurrikulave "*Ekonomia Qarkulluese*" dhe "*Menaxhimi i integruar i mbetjeve*". Përfaqësuesit e Drejtorisë së Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kanë marrë pjesë në trajnim dhe janë certifikuar nga ASPA. Aktiviteti kontribuon në ngritjen e kapaciteteve profesionale për ekonominë qarkulluese dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në rezultatet e paraqitura nëpërmjet indikatorëve, në tabelën e mëposhtme **paraqitet e përmbledhur realizueshmëria e objektivave specifikë të Strategjisë**, **sipas shkallës së realizimit të indikatorëve**, për periudhën janar-qershor 2026.

Qëllimi i Politikës	Objektivi Specifik (OS)	Përqindja e realizimit të OS sipas treguesve të performancës.[78]	Shkalla e realizimit të OS sipas treguesve të performancës
Qëllimi i Politikës I	Objektivi Specifik 1.3	80%	Mirë
	Objektivi Specifik 1.3	61%	Mirë
	Objektivi Specifik 1.3	98%	Shumë mirë
Qëllimi i Politikës II	Objektivi Specifik 2.1	50%	Mjaftueshëm
	Objektivi Specifik 2.2	96%	Shumë mirë
	Objektivi Specifik 2.3	94%	Shumë mirë
	Objektivi Specifik 2.4	Nuk matet.[79]	N/A
Qëllimi i Politikës III	Objektivi Specifik 3.1	Nuk matet.	N/A
	Objektivi Specifik 3.2	Nuk matet.	N/A
Qëllimi i Politikës IV	Objektivi Specifik 4.1	Nuk matet.	N/A
	Objektivi Specifik 4.2	81%	Mirë
	Objektivi Specifik 4.3	100%	Shumë mirë
	Objektivi Specifik 4.4	63%	Mirë
Qëllimi i Politikës V	Objektivi Specifik 5.1	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 5.2	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 5.3	0%	Dobët
	Objektivi Specifik 5.4	100%	Shumë mirë

[78] Përllogaritur sipas formulës NR $= \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}}$ x 100% . Për treguesit e performancës është llogaritur një mesatare e ponderuar e realizueshmërisë.

[79] Treguesit e performancës për OS 2.4, OS 3.1, OS 3.2 dhe OS 4.1 nuk janë të matshme për këtë periudhë raportimi.

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se, progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave në bazë të realizimit të treguesve të performancës, për periudhën janar-qershor 2026, paraqitet si më poshtë:

Qëllimi i Politikës I - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	80%	Mirë
Qëllimi i Politikës II - Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	80%	Mirë
Qëllimi i Politikës III - Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi	E pamatshme për këtë periudhë raportimi.	N/A
Qëllimi i Politikës IV - Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës	81%	Mirë
Qëllimi i Politikës V - Administrata e gjelbër	25%	Dobët
Qëllimi Strategjik sipas TP	**67%**	**Mirë**

Sa më sipër realizimi i qëllimit strategjik bazuar në zbatueshmërinë e treguesve të performacës është 67%.

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit për periudhën 1 janar-30 qershor 2026, zbatimi i SNRAP 2025-2030 paraqet progres të qëndrueshëm, duke reflektuar angazhim institucional dhe koordinim ndërinstitucional në zbatimin e reformave. Megjithatë, mbeten disa aspekte që kërkojnë vëmendje dhe adresim të mëtejshëm për forcimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së reformave. Ky proces duhet parë edhe në kontekstin e vitit të parë të zbatimit të strategjisë, i cili ka shërbyer kryesisht për konsolidimin e bazave dhe krijimin e kushteve për avancimin e mëtejshëm të reformës.

Mbështetur në rezultatet e monitorimit për periudhën janar-qershor 2026, fushat me performancë më të ulët dhe problematika në zbatim lidhen me masa dhe aktivitete të shtrira në disa prej Qëllimeve të Politikës. Në veçanti, vëmendje e mëtejshme kërkojnë masat dhe aktivitetet me nivel të ulët ose të pjesshëm realizimi, të cilat ndikojnë në përmbushjen e objektivave specifikë përkatës.

Objektivat specifikë me nivel më të ulët realizimi, bazuar në ecurinë e masave përkatëse, janë objektivat specifikë 2.1 dhe 2.2 në Qëllimin e Politikës II, objektivat specifikë 4.1 dhe 4.2 në Qëllimin e Politikës IV, si dhe objektivat specifikë 5.1, 5.2, 5.3 dhe 5.4 në Qëllimin e Politikës V.

Mbështetur në rezultatet e monitorimit sipas treguesve të performancës, rezulton se objektivi specifik (OS) 2.1 në Qëllimin e Politikës I, OS 4.4 në Qëllimin e Politikës IV, si dhe OS 5.1, 5.2 dhe 5.3 në Qëllimin e Politikës V paraqesin nivel të ulët zbatimi.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezulton se çështje që përbëjnë sfida, mangësi dhe shkaktarë të joefikasitetit janë si më poshtë:

Për Qëllimin e Politikës I:

Mbetet sfidë përmirësimi dhe funksionalizimi i plotë i sistemit IPSIS, me qëllim mbështetjen e proceseve të planifikimit, monitorimit dhe raportimit të politikave publike. Në këtë drejtim, evidentohen disa çështje që kërkojnë adresim:

- Përmirësimi i sistemit IPSIS, pasi problematikat në funksionimin e tij kufizojnë mbledhjen, përpunimin dhe administrimin elektronik të të dhënave.
- Digjitalizimi i procesit të raportimit të progresit, i cili aktualisht realizohet kryesisht në mënyrë manuale, duke ndikuar në fragmentimin e të dhënave dhe vështirësuar konsolidimin e informacionit.
- Harmonizimi i strukturës së dokumenteve strategjike me formatin e IPSIS, pasi disa dokumente, paraqiten me struktura dhe formate të ndryshme nga ato të parashikuara në sistem.
- Përfundimi i riorganizimit të GMIP-ve, pasi vonesat në këtë proces ndikojnë në efektivitetin e koordinimit ndërinstitucional përgjatë ciklit të planifikimit dhe monitorimit të politikave.

Një sfidë mbetet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional dhe respektimi i afateve në procesin e programimit rregullator. Vonesat në zbatimin e udhëzimeve dhe në hartimin e projektakteve nga disa institucione propozuese ndikojnë në ecurinë e procesit dhe përmbushjen e afateve të planifikuara.

Për adresimin e këtyre sfidave kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i koordinimit ndërinstitucional dhe i udhëzimeve për procesin e programimit rregullator, vijimi i raportimit periodik gjatë vitit me pika të ndërmjetme monitorimi për aktet që rrezikojnë të mos realizohen, si dhe organizimi i takimeve të strukturuara koordinuese.

Gjithashtu, nevojitet përshpejtimi i mëtejshëm i punës për sigurimin e një procesi më efikas dhe të qëndrueshëm të planifikimit për integrimin evropian. Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë ka miratimi në baza periodike i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, si dhe përfundimi i kuadrit

rregullator për përgatitjen e versionit kombëtar të acquis-së së Bashkimit Evropian. Këto procese kërkojnë koordinim të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe respektimin e afateve të përcaktuara.

Kapacitetet institucionale dhe profesionale të strukturave negociuese vijojnë të kërkojnë forcim, veçanërisht për përballimin e kërkesave komplekse dhe në rritje të procesit të integrimit evropian. Në këtë drejtim, nevojitet vijimi i programeve të trajnimit për administratën publike, përfshirja e strukturave përgjegjëse në programe të ngritjes së kapaciteteve, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, me mbështetjen e ASPA-s.

Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë përshpejtimit të procesit të finalizimit dhe miratimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027. Në këtë drejtim, rëndësi ka identifikimi i plotë i masave mbi bazën e planeve të punës dhe dokumenteve negociuese, forcimi i koordinimit ndërinstitucional për përfundimin e inputeve nga institucionet përgjegjëse, si dhe evidentimi i plotë i acquis-it në kuadër të hapjes së të gjithë grupkapitujve.

SASPAC duhet të vijojë punën për rivitalizimin dhe riorganizimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), në bashkëpunim me projektin EUSFAM, me synim forcimin e rolit të tyre si platforma qendrore për koordinimin e politikave kombëtare dhe harmonizimin e mbështetjes së donatorëve në Shqipëri. Rishikimi i Urdhrit nr. 90/2023 të Këshillit të Ministrave, "*Për funksionimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP)*", nuk ka përfunduar ende. Procesi ndodhet në fazën e analizës, e cila duhet të përmbyllet për të vijuar më tej me rishikimin dhe përditësimin e urdhrit, në përputhje me modelin e rishikuar të funksionimit të GMIP-ve.

Për Qëllimin e Politikës II:

Për këtë shtyllë, vijon të kërkojë vëmendje përmbyllja e procesit të miratimit të projektligjit "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, 'Për nëpunësin civil', të ndryshuar*", si dhe hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij. Në këtë drejtim, rëndësi ka monitorimi i vazhdueshëm i procesit legjislativ, konsultimi me partnerët ndërkombëtarë dhe shfrytëzimi i ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance".

Në kuadër të rritjes së transparencës së pagave për nëpunësit publikë, përfshirë edhe informacionin e përcjellë në njoftimet për vendet vakante, duhet të vijojë puna për operacionalizimin e modelit të miratuar për publikimin e këtyre vendeve. Publikimi i vendeve vakante sipas modelit të përgatitur nuk është realizuar ende, për shkak të nevojës për kohë shtesë për përfundimin e hapave të nevojshëm operacionalë.

Pas miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hartimit dhe miratimit të metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike. Metodologjia do të shërbejë për klasifikimin e pozicioneve të punës në kategorinë dhe klasën përkatëse dhe do të miratohet nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në zbatim të

ndryshimeve të reja ligjore. Për rrjedhojë, vijimi i këtij procesi është i kushtëzuar nga miratimi i ndryshimeve në ligjin për nëpunësin civil.

Një tjetër fushë që kërkon përshpejtim lidhet me hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit për zhvillimin e aftësive të lidershipit dhe menaxhimit për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë. Në funksion të këtij procesi, janë zhvilluar diskutime dhe komunikime të vazhdueshme me palët e përfshira, si dhe janë eksploruar mundësi bashkëpunimi me palë të treta për hartimin dhe zbatimin e programit.

Një aspekt që kërkon avancim të mëtejshëm lidhet me shtrirjen e funksionalitetit të gjenerimit automatik të listëpagesave në sistemin arsimor, shëndetësor dhe në pushtetin vendor. Në këtë drejtim, vijon procesi i hedhjes dhe përditësimit të të dhënave të punonjësve në sistemin HRMIS, si një hap i nevojshëm për zgjerimin e funksionalitetit.

Për Qëllimin e Politikës III:

Vëmendje e mëtejshme kërkon zbatimi i masave të planifikuara për zhvillimin e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale, për shkak të kohës së nevojshme për finalizimin e dokumentacionit teknik dhe procedurave përgatitore. Në këtë drejtim, janë miratuar marrëveshjet e huasë dhe grantit për projektin "Smart Labs", janë ngritur grupet e punës dhe dokumentet ToR janë në fazë finalizimi.

Duhet të vijojë puna për riorganizimin e portalit e-Albania sipas modelit "life events". Pavarësisht progresit të bërë, Grupi i Punës për "Ngjarjet e Jetës" vijon angazhimin për përfundimin e procesit. Në këtë kuadër, ndryshimet përkatëse në "Urdhër" janë finalizuar dhe është zhvilluar një takim koordinues me Grupin e Punës, gjatë të cilit draft-urdhri është rishikuar dhe diskutuar me të gjitha palët përkatëse të interesit.

Në kuadër të përmirësimit të aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, nevojitet vijimi dhe përshpejtimi i punës për ngritjen e platformës së asistentit virtual dhe sistemit Helpdesk. Aktualisht, procesi ndodhet në fazën e hartimit të Termave të Referencës (ToR), ndaj kërkohet vijimi i hapave përgatitorë dhe finalizimi i tyre për të mundësuar avancimin e mëtejshëm të procesit.

Për Qëllimin e Politikës IV:

Një tjetër çështje që kërkon vëmendje lidhet me përmbylljen e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 90/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", të ndryshuar. Në këtë drejtim, kërkohet ndjekja periodike e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve, përfshirja e tyre në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, si dhe përdorimi i ekspertizës teknike të projektit "EU for Good Governance", me synim përshpejtimin e procesit dhe sigurimin e përfundimit të tij brenda afateve të planifikuara.

Në kuadër të forcimit të llogaridhënies dhe menaxhimit të performancës, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë pilotimit të kornizës së llogaridhënies dhe përcaktimit të objektivave dhe indikatorëve në pesë sisteme ministrore. Ky proces nuk ka filluar ende, pasi paraprihet nga hartimi dhe miratimi i kornizës së llogaridhënies, nëpërmjet miratimit të projektvendimit përkatës. Për rrjedhojë, përfundimi i këtij kuadri rregullator përbën një parakusht për nisjen e pilotimit në pesë sistemet ministrore.

Vëmendje e mëtejshme kërkon përmbyllja e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 33/2022, "*Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik*". Në këtë drejtim, nevojitet qartësimi i përgjegjësive institucionale, forcimi i koordinimit ndërinstitucional, finalizimi dhe konsultimi i akteve të mbetura, si dhe ndjekja e procedurave për miratimin e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Funksionimi i sistemit SQDNE vijon të shoqërohet me disa problematika teknike dhe administrative, të cilat ndikojnë në trajtimin në kohë dhe efektiv të aplikimeve. Ndër problematikat kryesore evidentohen çështjet teknike të sistemit, problematikat administrative të institucioneve, mungesa e trajnimit të plotë të personelit, përfundimi i kontratave të mirëmbajtjes së sistemeve të brendshme, si dhe largimi apo lëvizja e punonjësve në institucionet publike. Adresimi i tyre kërkon forcimin e mbështetjes teknike, sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të sistemeve dhe zhvillimin e trajnimeve të përsëritura për personelin përgjegjës.

Një tjetër çështje që kërkon vëmendje lidhet me zhvillimin e trajnimit të nëpunësve të Kuvendit për zbatimin e metodologjisë së kontrollit post-legjislativ. Në këtë drejtim, nevojitet planifikimi dhe zhvillimi në kohë i trajnimit, me synim forcimin e kapaciteteve të nëpunësve dhe zbatimin efektiv të metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.

Për Qëllimin e Politikës V:

Për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të Qëllimit të Politikës V, kërkon vëmendje të shtuar mungesa e një qasjeje të unifikuar ndërmjet institucioneve në prioritizimin e objektivave të administratës së gjelbër. Në këtë drejtim, nevojitet forcimi i koordinimit ndërinstitucional, harmonizimi i prioriteteve dhe përcaktimi më i qartë i përgjegjësive të institucioneve, me synim sigurimin e një qasjeje të qëndrueshme dhe të koordinuar në zbatimin e masave për "administratën e gjelbër".

Një çështje që kërkon vëmendje të mëtejshme në kuadër të Qëllimit të Politikës V, lidhet me plotësimin e kuadrit ligjor dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e Skemës së Ekomenaxhimit dhe Auditimit (SEMA). Përfundimi i kuadrit rregullator dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm institucionalë do të mundësonin avancimin drejt zbatimit efektiv të skemës dhe konsolidimin gradual të praktikave të administratës së gjelbër.

Përsa më sipër duhet vijuar me hartimin dhe miratimin e ndryshimeve të VKM nr. 633, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për dhënien e skemave të*

ekomenaxhimit dhe auditimit". Përfundimi i këtij procesi është i rëndësishëm për krijimin e kuadrit të nevojshëm për zbatimin e masave të administratës së gjelbër.

Mbetet sfidë avancimi i aktiviteteve që lidhen me përdorimin efiçent të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike, të cilat ndodhen ende në fazat fillestare të zbatimit. Në këtë drejtim, kërkohet zhvillimi i mekanizmave operacionalë për monitorimin dhe raportimin e konsumit në nivel institucional, hartimi i një qasjeje metodologjike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, forcimi i koordinimit me institucionet publike, si dhe identifikimi i ndërhyrjeve prioritare për reduktimin e konsumit dhe përdorimin më eficient të burimeve.

Vëmendje e mëtejshme kërkon përmbyllja e procesit të miratimit të kurrikulave dhe organizimi i trajnimeve të dedikuara për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë mbi tranzicionin ekologjik. Përshpejtimi i këtyre proceseve është i nevojshëm për zhvillimin e kapaciteteve drejtuese dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi integrimin e parimeve të tranzicionit ekologjik në administratën publike.

Nga monitorimi dhe analiza e kryer rezulton se, strukturat implementuese të përfshira në Planin e Veprimit, duhet të jenë me të përgjegjshme mbi rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin në kohë të masave të planifikuara.

Duke u mbështetur në këtë dokument strategjik, institucionet sipas detyrimeve të përcaktuara, duhet koordinojnë planet e punës duke siguruar përparim të koordinuar drejt një qëllimi të përbashkët me rëndësi për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

3.3 Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjikë sektorialë dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të sistemit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës, të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për realizimin objektivave strategjikë.

Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim. Raporti i monitorimit janar-qershor 2026, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese.

Institucionet kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet për të zbatuar masat, kryer aktivitetet në funksion të tyre, në përputhje me buxhetet e parashikuara në Planin e Veprimit,

mbështetjet e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas, si dhe kanë vënë në përdorim burimet e tyre njerëzore dhe kapacitetet teknike profesionale të brendshme.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezulton se:

- mungesa e burimeve njerëzore specifike;
- mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar;
- vonesa në miratimin e akteve të tjera;
- vonesa në zbatimin e projekteve;
- mosraportimi nga institucionet përgjegjëse duke ndikuar në kryerjen e një analizë e saktë të zbatueshmërisë së Planit të Veprimit,

janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim e plotë të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të Planit të Veprimit dhe arritjes së treguesve të performancës janë:

Për Qëllimin e Politikës I:

- Finalizimi i përditësimit të GMIP-ve dhe integrimi i indikatorëve të performancës në të gjitha institucionet;
- Vijimi i trajnimeve të avancuara për përdorimin e RIA dhe forcimi i kapaciteteve analitike të stafit që merret me këto procese;
- Përmirësimi i funksionimit të IPSIS/SIPI për monitorim dhe raportim të integruar të politikave;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të strukturave negociuese për menaxhimin efektiv të kërkesave komplekse të procesit të integrimit evropian

Për Qëllimin e Politikës II:

- Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nëligjore për shërbimin civil;
- Vijimi i zhvillimit profesional të nëpunësve dhe forcimin e kapaciteteve të njësive të burimeve njerëzore;
- Forcimi i përdorimit të HRMIS për automatizimin e proceseve dhe menaxhimin efikas të të dhënave.

Për Qëllimin e Politikës III:

- Vijimi i forcimit të aftësive digjitale të punonjësve të administratës publike;
- Vijimi i përpjekjeve për rritjen e aksesit të qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet online, me fokus të veçantë tek grupet vulnerabël;
- Vijimi i punës për hartimin e Termave të Referencës (ToR) për ngritjen e platformës së asistentit virtual dhe sistemit helpdesk.

Për Qëllimin e Politikës IV:

- Zhvillimi i mëtejshëm i platformave të transparencës dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e konsultimit publik;
- Miratimi i akteve nënligjore për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i funksionimit të SQDNE.
- Forcimimi i kapaciteteve profesionale të nëpunësve të Kuvendit për zbatimin e metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.

Për Qëllimin e Politikës V:

- Vijimi i zbatimit të masave për "administratën e gjelbër" në përputhje me Planin e Veprimit;
- Zbatimi i masave prioritare për përdorimin efiçent të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike.
- Forcimi i kapaciteteve profesionale përmes hartimit dhe miratimit të kurrikulave dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara mbi tranzicionin ekologjik;
- Vijimi i përafrimit me direktivat e Bashkimit Evropian dhe zhvillimi i mëtejshëm i një modeli të ekonomisë qarkulluese në administratë.

PJESA IV – RISQET DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

Në këtë kapitull përcakohen parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në raportin e monitorimit, metodën që përdoret për identifikimin, analizën, vlerësimin, trajtimin, raportimin e risqeve kryesore që rrezikojnë realizimin e objektivave, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

4.1 Vleresimi i riskut duke përdorur treguesit

Gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të Strategjisë janë evidentuar disa faktorë që mund të ndikojnë në realizimin në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të masave dhe aktiviteteve të planifikuara. Këta faktorë lidhen kryesisht me:

- Vonesat në zbatimin e aktiviteteve;
- Mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale;
- Koordinimit ndërinstitucional jo i mjaftueshëm;
- Burime financiare të kufizuara;
- Cilësia e të dhënave të raportuara;
- Faktorë të tjerë të jashtëm.

Në këtë drejtim, kërkohet ndjekje e vazhdueshme e progresit të masave, forcim i mekanizmave të koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe identifikimi dhe ndërmarrja në kohë e masave korrigjuese për adresimin e problematikave të evidentuara dhe minimizimin e ndikimit të tyre në realizimin e objektivave strategjikë.

Vlerësimi i riskut është kryer për objektivat tek të cilët është identifikuar risk i ulët, i mesëm ose i lartë referuar masave përkatëse dhe treguesve dhe në përputhje me analizën e riskut të përcjellë prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të saj, të vlerësimit që vetë stafi i ka bërë riskut në përputhje me të dhënat e mbledhura.

Në vijim, analiza e riskut përfshin: analizën e risqeve, nivelin e riskut, dhe hapat e mëtejshëm të mundshëm për të adresuar këto risqe dhe për të zbatuar me sukses masat dhe përmbushur indikatorët, sipas tabelës së mëposhtme.

Rreziku	Niveli	Masat lehtësuese
Vonesa në përmirësimin dhe rishikimin e Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar (IPSIS), duke ndikuar në forcimin e monitorimit, raportimit dhe përdorimit të të dhënave në procesin e planifikimit të integruar.	I lartë	- Hartimi i një plani pune që përcakton hapa të detajuar, me afate për t'u respektuar. - Përfundimi i procesit të rishikimit dhe vlerësimit të funksionaliteteve aktuale të sistemit. - Testimi dhe vënia në funksion e përmirësimeve të sistemit
Kapacitete të pamjaftueshme institucionale dhe profesionale të strukturave negociuese për të menaxhuar në mënyrë efektive kërkesat komplekse të procesit të integrimit evropian.	I mesëm	- Planifikim më i strukturuar i trajnimeve sipas nevojave specifike të strukturave negociuese dhe kapitujve përkatës të acquis.
Vonesa në miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027.	I mesëm	- Përshpejtimi i procesit të finalizimit dhe konsolidimit të draft-PKIE-së. - Forcimi i koordinimit ndërinstitucional për përfundimin e inputeve nga institucionet përgjegjëse. - Identifikim i plotë të acquis-it në kuadër të hapjes së të gjithë grupkapitujve.
Mosrealizimi në kohë dhe me cilësi i përditësimit të legjislacionit dhe plotësimi i fushave përkatëse.	I ulët	- Rritja e përgjegjshmërise lidhur me procesin e përditesimit. - Komunikim dhe bashkepunim me institucionet që sjellin akte me gabime për korigjimin e tyre. - Komunikim me AKSHI-n për problematikat e sistemit gjetë procesit të publikimit të akteve.
Vonesë në miratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.	I mesëm	- Monitorim i vazhdueshëm i procesit legjislativ. - Konsultim i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë. - Mbështetje nga ekspertiza teknike e projektit “EU for Good Governance”.
Vonesa në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.	I mesëm	- Ndjekja periodike e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve. - Përfshirja e akteve në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve. - Mbështetje nga ekspertiza teknike e projektit “EU for Good Governance”.

Vonesa në publikimin e vendeve vakante sipas modelit të miratuar.	I ulët	- Përfundimi i hapave të nevojshëm për operacionalizimin e modelit të miratuar; - Komunikimi dhe orientimi i njësive të burimeve njerëzore mbi përdorimin e modelit; - Fillimi i publikimit të vendeve vakante sipas modelit të miratuar.
Vonesa në hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit për zhvillimin e aftësive të lidershipit dhe menaxhimit për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë.	I mesëm	- Finalizimi i diskutimeve me palët e përfshira dhe identifikimi i alternativave të bashkëpunimit për hartimin dhe zbatimin e programit. - Finalizimi i paketës së trajnimit. - Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme.
Vonesa në implementimin dhe shtrirjen e funksionalitetit të gjenerimit automatik të listës së pagave në sistemin arsimor, sistemin shëndetësor dhe pushtetin vendor.	I mesëm	- Përfundimi dhe përditësimi i të dhënave të stafit të administratës nga 13 ZVAP-et që ende nuk e kanë përmbyllur procesin. - Forcimi i kapaciteteve të stafit përgjegjës përmes trajnimeve dhe asistencës teknike. - Përfundimi i fazës pilot në sistemin shëndetësor dhe pushtetin vendor. - Përcaktimi i afateve të qarta për kalimin nga faza pilot në përdorimin e zgjeruar të platformës. - Monitorimi periodik i progresit të implementimit në të tre sistemet dhe raportimi i problematikave që mund të ndikojnë në afatet e parashikuara.
Vonesa në zbatimin e disa masave të planifikuara për zhvillimin e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale, si rezultat i kohës së nevojshme për finalizimin e dokumentacionit teknik dhe procedurave përgatitore.	I mesëm	- Përfundimi i Termave të Referencës. - Nisja në kohë e procedurave të prokurimit. - Monitorim periodik i ecurisë së projekteve. - Koordinim ndërinstitucional për respektimin e afateve.
Vonesa në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 90/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", të ndryshuar.	I mesëm	- Ndjekja periodike e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve. - Përfshirja e akteve në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve. - Mbështetje nga ekspertiza teknike e projektit "EU for Good Governance".

Pamjaftueshmëria e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kornizës së llogaridhënies.	I mesëm	- Plotësimi i kuadrit rregullator për zbatimin e kornizës së llogaridhënies, duke përcaktuar rregulla të hollësishme dhe të qarta për përmbajtjen dhe procedurën për hartimin dhe miratimin e planit të performancës, observacionit, raportit të performancës dhe deklaratës së performancës, formatet e tyre, si dhe rregulla të hollësishme për sistemin e brendshëm të performancës; - Mbështetja metodologjike dhe orientimi i institucioneve nga DAP gjatë pilotimit të kornizës së llogaridhënies; - Hartimi dhe zbatimi i një plani trajnimi për forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kornizës së llogaridhënies.
Varësia nga funksionimi i sistemeve elektronike.	I lartë	- Monitorimi periodik i funksionimit të sistemeve elektronike dhe identifikimi në kohë i problematikave teknike. - Forcimi i koordinimit me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve. - Dokumentimi dhe monitorimi i incidenteve teknike, me qëllim reduktimin e ndikimit të tyre në proces.
Lëvizjet e shpeshta të stafit në administratën publike.	I mesëm	- Sigurimi i transferimit të njohurive dhe dokumentimit të proceseve gjatë ndryshimit të stafit. - Organizimi i trajnimeve dhe orientimit për punonjësit e rinj të angazhuar në proces.
Vonesa në zhvillimin e trajnimit të nëpunësve të Kuvendit për zbatimin e metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.	I ulët	- Përcaktimi i nevojave për trajnim dhe i grupit të nëpunësve që do të trajnohen. - Planifikimi dhe organizimi i trajnimit për zbatimin praktik të metodologjisë së kontrollit post-legjislativ.
Vonesa në hartimin dhe miratimin e ndryshimeve të VKM nr. 633, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për*	I mesëm	- Përfundimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit".

dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit".		- Fillimi i procesit të hartimit të ndryshimeve në VKM nr. 633 pas miratimit të bazës ligjore.
Mungesa ose pamjaftueshmëria e burimeve financiare për zbatimin e masave konkrete të administratës së gjelbër.	I lartë	- Integrim më i plotë në PBA dhe identifikim burimesh shtesë financimi.
Mungesa e një qasjeje të unifikuar në prioritizimin e objektivave të administratës së gjelbër ndërmjet institucioneve.	I lartë	- Forcim i koordinimit ndërinstitucional dhe orientim përmes planeve vjetore të punës.
Vonesa në organizimin e trajnimeve të dedikuara për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë për tranzicionin ekologjik.	I mesëm	- Përfundimi dhe miratimi i kurrikulave të trajnimit për tranzicionin ekologjik. - Planifikimi dhe organizimi i trajnimeve menjëherë pas finalizimit të kurrikulave. - Monitorimi i pjesëmarrjes dhe vlerësimi i rezultateve të trajnimeve për të matur përmirësimin e kapaciteteve të drejtuesve.

Në raportet e ardhshme të monitorimit do të vijojë analiza e treguesve për çdo objektiv për të parë ecurinë e tyre. Në këtë kuadër, nevojitet të merren parasysh rekomandimet e mëposhtme:

- Duhet kushtuar vëmendje realizimit të masave dhe aktiviteteve të lidhura me objektivat respektive specifikë, të cilat kanë shfaqur një nivel të ulët zbatimi gjatë periudhës janar-qershor 2026;
- Tejkalimi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse është problematikë e cila ndikon drejtpërsëdrejti në hartimin e raportit të monitorimit. Për këtë arsye, rekomandohet dërgimi i kontributeve brenda afateve të përcaktuara, si dhe në përputhje me formatet e kërkuara;
- Metodologjia e monitorimit sipas IPSIS, kërkon përmirësimin e kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.

4.2 Hapat e radhës

Në vijim të gjetjeve dhe rekomandimeve të evidentuara gjatë procesit të monitorimit, hapat e radhës do të fokusohen në përshpejtimin e masave të mbetura, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe sigurimin e vijimësisë së ndërhyrjeve të planifikuara. Në këtë kuadër, rëndësi

të veçantë do t'i kushtohet masave me nivel më të ulët zbatimi, përmbushjes së aktiviteteve brenda afateve të përcaktuara, si dhe konsolidimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit.

Në vijim, puna do të orientohet drejt përmbylljes së proceseve rregullatore dhe institucionale të nisura, avancimit të aktiviteteve që ndodhen në faza përgatitore dhe operacionalizimit të masave që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme. Paralelisht, do të vijojë forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i cilësisë të të dhënave të raportuara, si dhe përdorimi më efektiv i mekanizmave të monitorimit për identifikimin në kohë të vonesave dhe marrjen e masave korrigjuese.

Një tjetër prioritet do të jetë sigurimi i një qasjeje më të integruar në zbatimin e Strategjisë, përmes bashkërendimit të institucioneve përgjegjëse, qartësimit të përgjegjësive dhe ndjekjes periodike të masave me risk më të lartë për mosrealizim. Këto hapa synojnë të mbështesin përshpejtimin e zbatimit të SNRAP 2025–2030 dhe të krijojnë kushtet për një realizim më të qëndrueshëm dhe efektiv të objektivave strategjikë në periudhën në vijim.

Përsa i përket Qëllimitt e Politikës I "Zhvillimi dhe koordinimi i politikave", fokusi do të jetë në përmirësimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemit IPSIS, me synim forcimin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit të politikave mbi bazën e të dhënave të integruara. Një prioritet i rëndësishëm do të jetë përfundimi i procesit të riorganizimit të GMIP-ve dhe forcimi i rolit të tyre në koordinimin ndërinstitucional. Paralelisht, do të vijojë puna për rritjen progresive të kapaciteteve analitike dhe negociuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht në funksion të procesit të integrimit evropian. Gjithashtu, vëmendje do t'i kushtohet përmirësimit të cilësisë së proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) dhe konsultimit publik, me synim rritjen e bazueshmërisë në evidencë, cilësisë së politikave dhe përfshirjes së palëve të interesuara në procesin e politikëbërjes.

Në lidhje me Qëllimin e Politikës II "Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore" fokusi do të jetë në përfundimin e procesit të miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, si bazë për konsolidimin e mëtejshëm të reformës në shërbimin civil. Paralelisht, do të vijojë puna për funksionalizimin e plotë dhe përdorimin e qëndrueshëm të sistemit HRMIS, si dhe për forcimin e kapaciteteve profesionale të nëpunësve dhe të kapaciteteve institucionale e analitike. Një tjetër fokus do të jetë përmirësimi i mekanizmave për mbajtjen dhe motivimin e stafit, krahas sigurimit të zbatimit efektiv dhe të qëndrueshëm të modeleve të trajnimit dhe zhvillimit profesional, me synim rritjen e profesionalizmit dhe performancës së administratës publike.

Në lidhje me Qëllimin e Politikës III "Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi", në vijim, fokusi do të jetë në përfundimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemeve kryesore digjitale, duke siguruar qëndrueshmërinë dhe përdorimin efektiv të tyre në ofrimin e shërbimeve publike. Një prioritet do të jetë zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të përdoruesve dhe zgjerimi i aksesit në shërbimet digjitale, duke i përshtatur ato me nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Paralelisht, do të vijojë forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe integrimit të sistemeve, me synim rritjen e ndërveprimit dhe eficiencës së shërbimeve. Në këtë kuadër, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet

garantimit të standardeve të sigurisë kibernetike dhe përmirësimit të vazhdueshëm të aksesueshmërisë së shërbimeve digjitale për të gjithë përdoruesit, përfshirë grupet me nevoja të veçanta.

Në lidhje me Qëllimin e Politikës IV "Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja", fokusi do të jetë në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 90/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", të ndryshuar, si dhe në monitorimin e vazhdueshëm të procesit. Paralelisht, do të vijojë forcimi i kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional, si dhe garantimi i funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve elektronike që mbështesin proceset administrative dhe të monitorimit. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të efektivitetit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, krahas vijimit të masave për rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në informacionin publik. Këto ndërhyrje synojnë forcimin e llogaridhënies institucionale dhe rritjen e efektivitetit të administratës publike.

Në lidhje me Qëllimin e Politikës V "Administrata e gjelbër", në vijim, fokusi do të jetë në krijimin e kushteve të nevojshme për avancimin e zbatimit të masave në kuadër të "administratës së gjelbër", përmes sigurimit të burimeve financiare dhe integrimit të masave përkatëse në Programin Buxhetor Afatmesëm, si dhe identifikimit të burimeve shtesë të financimit. Një tjetër prioritet do të jetë forcimi i koordinimit ndërinstitucional, konsolidimi i strukturave teknike koordinuese dhe zhvillimi i mekanizmave të rregullt të bashkërendimit. Paralelisht, do të vijojë puna për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në kuadër të administratës së gjelbër, si dhe për forcimin e kapaciteteve profesionale përmes hartimit dhe miratimit të kurrikulave dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara mbi tranzicionin ekologjik. Këto hapa synojnë të krijojnë një bazë më të qëndrueshme institucionale, financiare dhe profesionale për zbatimin gradual dhe efektiv të administratës së gjelbër.